


KUJDES ME BIBLËN!

Sinclair B Ferguson



KUJDES ME BIBLËN!

Udhëzues për përdorimin e Biblës

Sinclair B. Ferguson

KUJDES ME BIBLËN!

Origjinali: Handle with care
Autori: Sinclair Ferguson
Përktheu: Florenc Mene
Boton: Misioni Ungjillor
29 Bridge Street
Penybryn
Wrexham
LL13 7HP
Britania e Madhe

Të gjitha citimet e Biblës janë marrë nga versioni Lajmi i Mirë (LIM).

© Sinclair B. Ferguson. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet apo përhapet në asnjë lloj forme apo mjeti, elektronik apo mekanik, duke përfshirë edhe fotokopjimin, inçizimin, apo ndonjë sistem për magazinimin dhe rinxjerrjen e informacionit, pa lejen me shkrim nga botuesi.

Shtypur:
Vernon Publishing
Tirana, Albania, 2000
Printuar pë herë të dytë: 1500 kopje

Hyrje

Kohët e fundit, midis studiuesve dhe shkrimtarëve të krishterë ka patur një debat. Ai është bërë i njohur (pas titullit të publikimit amerikan i cili sinjalizoi raundin e parë të diskutimit) si ‘beteja për Biblën’. Në të vërtetë, ky nuk është një debat i ri. Shumë prej argumenteve të tij janë dëgjuar dhe përdorur që më parë. Por, deri tani, kjo është një betejë e zhvilluar nga studiuesit, dhe jo nga të krishterët e thjeshtë. Nuk është qëllimi i këtij libri të diskutojë atë betejë!

Në vend të kësaj, këto faqe janë shkruar mbi bindjen se po luftohet një tjetër ‘betejë për Biblën’. Kjo betejë tjetër luftohet ditë për ditë në jetën e çdo të krishteri. Është beteja e leximit, kuptimit, dhe vënies në praktikë të mesazhit të Biblës. Në fakt, në shumë mënyra kjo është një betejë shumë më e gjerë se tjetra, sepse ajo përfshin të krishterët e shumë sfoneve dhe pikëpamjeve të ndryshme. Ajo të përfshin ty dhe mua. Dhe sigurisht, kjo është një betejë e lashtë.

Disa prej atyre që argumentojnë për pagabueshmërinë e fjalës së Perëndisë vënë në dukje prototipin e debatit të tyre, i cili mund të gjendet në kapitujt e parë të librit të Zanafillës. Atje, Satani tha: ‘Me siguri Perëndia nuk tha kështu!’ ‘Pse, me të vërtetë i besoni fjalës së Perëndisë?’

Por veprimi në atë konfliktin e parë nuk kufizohej vetëm në autoritetin e fjalës së Perëndisë. Në një mënyrë të hollë, ai ishte edhe rreth asaj se çfarë kishte thënë Perëndia, se si duhej të interpretohej ajo (‘Ju nuk keni për të “vdekur” në atë kuptim’ tha Satani), dhe nëse do t’i bindej asaj apo jo. Pikërisht, kjo është beteja të cilën duhet ta luftojnë dita-ditës shumica prej nesh që janë të krishterë të zakonshëm. Duhet që të lëshojmë vend në jetën tonë për të dëgjuar se çfarë po thotë Perëndia nëpërmjet fjalës së Tij; nuk është gjithmonë e lehtë që ta kuptojmë në mënyrë të drejtë atë që shkruhet në Shkrim; gjithmonë përballemi me sfidën se si ta interpretojmë për situatën tonë mësimin e dhënë

njerëzve kaq shumë kohë më parë. Dhe pastaj, është dhe çështja e fundit: si mund ta ndjek këtë mësim me një bindje praktike në vetë jetën time?

Kjo është beteja në të cilën duhet të rrëfej se e gjej veten duke luftuar. Ajo është pjesë e betejës në jetën e krishterë në përgjithësi, dhe kështu unë parashikoj se do të vazhdoj të luftoj deri në fund të jetës sime. Jo gjithmonë kam dalë me sukses në të: në të vërtetë, në njëfarë mënyre shoh se lufta bëhet më e ashpër tani që jam më i rritur.

Biblën kam filluar ta lexoj që kur kam qenë i vogël. Që kur isha nëntë vjeç unë fillova të ndjek Lidhjen e Shkrimit (Scripture Union) dhe fillova të lexoj përditë nga një pjesë të fjalës së Perëndisë, duke u lutur që Ai të m'i hapte sytë për të zbuluar gjërat e mrekullueshme në të. Mendoj se e gjeja më të lehtë atëherë për të bërë kohë, dhe për të marrë kohë për të lexuar dhe përvetësuar përbrenda mesazhin e fjalës së Perëndisë. Shpesh kam menduar se jam ushqyer me kapitalin që kam qenë i mundur ta investoj atëherë. Tani, jeta është e mbushur me detyra dhe përgjegjësi; koha duket të zhduket me një shpejtësi alarmante. Gjithnjë e më tepër e shoh se koha duhet *shfrytëzuar* (Ef. 5:16). Por kjo është e vërtetë për shumicën prej nesh. Është kjo përvojë e ndarë midis nesh e cila u bë një nga motivimet e mia kryesore për shkrimin e këtij libri. Shpresoj se ai nuk do t'ju inkurajojë vetëm që ju të kushtoni më shumë kohë dhe energji në studimin e fjalës së Perëndisë, por edhe për t'ju shpëtuar nga shumë qorrsoakë në të cilët vërdallosen shpesh lexuesit e Biblës.

Përkrah shumë librave të vyer që po shkruhen sot për autoritetin dhe frymëzimin e Biblës, ka vend edhe për një libër tjetër që është ndoshta pak më shumë praktik. Unë mendoj kështu këtë për këtë arsye: tjetër është të thuash se Bibla është fjala e e pagabueshme e Perëndisë, dhe tjetër është të jetosh nën dritën e këtij besimi; ta kuptosh Biblën siç duhet në mendje dhe t'i bindesh asaj plotësisht në jetë. Është tmerrësisht e mundur që të pretendosh me zë të lartë për autoritetin e Shkrimit, por të jetosh

një jetë dhe të shfaqësh një shpirt që tregojnë pak për hirin e asaj Frymë që është Autori i Shkrimit.

Është e mundur që dy njerëz të bien dakord që Shkrimi është fjala e pagabueshme e Perëndisë, dhe megjithatë, ngaqë njëri (ose të dy) e interpretojnë Shkrimin në mënyrë të gabuar, të lexojnë praktikisht dy libra të ndryshëm. Por nëse nuk e trajtojmë siç duhet fjalën e Perëndisë, dhe nuk e kuptojmë dhe nuk e zbatojmë siç duhet, rrëfimi ynë i pagabueshmërisë së saj nuk ka për të ndikuar me të vërtetë në jetën tonë. Ngaqë Bibla na thotë “Kujdes me mua” siç na thotë dhe “Besomë plotësisht”, unë jam përpjekur të shkruaj një hyrje për Biblën në kapitujt që vijnë, e cila do t’u vijë në ndihmë atyre që kanë filluar ta lexojnë vetë Biblën dhe t’i shpëtojë ata prej disa grackave; dhe e cila gjithashtu do të veprojë, siç shpresoj, edhe si një gardh dhe rrjetë sigurie për ata që kanë shkuar më tej në rrugë, duke i mbajtur ata në rrugën mbi të cilën shkëlqen si një dritë e lavdishme Fjala e Perëndisë.

I jam mirënjohës Toni Kollins-it (Tony Collins), dikur i shtëpisë botuese Hodder & Stoughton, për shtysën që më dha për të shkruar këtë libër. Forma që ka marrë tani ishte sugjerim i tij dhe unë e kam vlerësuar interesin e tij në zhvillimin e librit. I jam gjithashtu mirënjohës shokut tim shumë të mirë Rev. Uilliam Dunlop i kishës së Sh. Xhorxh-Tron (St. George’s-Tron Church) në Glasgou për leximin dhe diskutimin e dorëshkrimit tim me mua. Është e panevojshme të thuhet se asnjë prej këtyre dy shokëve të mi nuk mund të mbahet përgjegjës për përmbajtjen! Si gjithmonë, dua t’i shpreh vlerësimin tim familjes sime për inkurajimin e tyre dhe miqësinë e dashur që e bën të mundur shkruajtjen e një libri!

SINCLAIR B. FERGUSON

Glasgou

Tetor 1981

Përmbajtja

Një: T'i Besojmë Biblës

1. Pse e kemi Biblën?	11
2. Si u Mblodh Bibla?	22
3. A është kjo Fjala e Perëndisë?	33

Dy: Si ta Përdorim Biblën

4. Bëje Vetë	43
5. Për Shembull	59

Tre: Të Jetojmë me anë të Biblës

6. Cila është Dobia?	72
7. Fara ka Nevojë për Tokë	83
8. Nga Përvoja Ime	95

NJË

T'i Besojmë Biblës

1 Pse e kemi Biblën?

Në Dhiatën e Re, shprehja ‘është shkruar’ ose një frazë e ngjashme me të shfaqet në rreth nëntëdhjetë raste. Kaq shumë jemi mësuar me ekzistencën e librit të quajtur “Bibël”, dhe kaq shumë na është bërë shprehi ta mendojmë atë si një pjesë të pandarë të jetës së krishterë - duke e lexuar privatisht, duke e dëgjuar tek lexohet dhe predikohet për të në publik - saqë rrallë, për të mos thënë kurrë, ndalemi për të bërë pyetjen: Pse e kemi Biblën?

Në vetvete, kjo është një pyetje me gamë mjaft të gjerë, ndoshta dhe hutuese për ata të krishterë që e kanë përdorur Biblën që kur mësuat të lexojnë. Sepse krishtërimi është fe libri. Bindjet tona, mënyra e jetesës dhe përvoja jonë e përditshme si të krishterë janë të mbrujtura dhe të drejtuara thellësisht prej përmbajtjes së rreth një mijë e gjashtëqind faqeve me informacion të shtypur ngjeshur. Megjithatë, shumë rrallë të krishterët ndalen për të pyetur: Po pse e kemi këtë Bibël tek e fundit?

Për shumë shekuj Bibla nuk është përdorur në mënyrën që shumë të krishterë e përdorin sot, për studim biblik personal dhe përkushtues. Deri pas Reformimit dhe zhvillimit të shtypshkronjës në shekullin XVI, shumë pak njerëz të zakonshëm ishin në gjendje të siguronin një kopje të Dhiatës së Re. Për pjesën më të gjatë të historisë së kishës së krishterë, leximi i përditshëm i Biblës ka qenë luks i disave dhe aspak privilegji i masave.

Atëherë, pse e kemi Biblën, dhe pse besimi i krishterë është i ndërthurur ngushtë me përmbajtjen e saj?

Zbulesa

Përgjigjja është se Perëndia komunikon me njerëzit, u zbulohet dhe i sjell ata në bashkësi me Të përmes Biblës. Me pak fjalë, është Bibla ajo përmes së cilës Perëndia e bën të njohur veten e Tij.

Ne zbulojmë se jeta shikohet nga një këndvështrim i ri përmes studimit të mësimave dhe të vërtetave shpirtërore të mëdha të shpalosura prej Shkrimit të Shenjtë. Njohja dhe të kuptuarit më mirë e Perëndisë në këtë mënyrë, na ndihmon. Në këtë mënyrë shohim dorën e Tij në jetën tonë, ndërsa më parë nuk arrinim t'i kuptonim provat që kalonim; dhe ne e duam më shumë Atë tani, sepse e ndiejmë se e njohim më mirë. Ja pse është Bibla. Nëse ajo nuk e ka arritur ende këtë rezultat, atëherë ende nuk kemi filluar ta përdorim si duhet.

Por, Bibla është më shumë se kaq. Sepse në të vërtetë, Bibla është më shumë se vetëzbulesa e Perëndisë për ne. Ajo është ilaçi hyjnor, receta hyjnore për sëmundjen shpirtërore. Nëse njerëzit nuk do ta kishin zhvilluar sëmundjen shpirtërore, ndoshta nuk do ta kishim fare Biblën. Pa dyshim se edhe nëse do ta kishim, ajo do të tregonte një histori shumë të ndryshme prej asaj që tregon.

Atëherë, si është i sëmurë shpirtërisht njeriu? Apostulli Pal e shpjegon gjendjen me këto fjalë:

(Njerëzit)... mbysin të vërtetën në padrejtësi, meqenëse ajo që mund të njihet prej Perëndisë është bërë e dukshme në ta, sepse Perëndia ua ka shfaqur atyre. Në fakt cilësutë e tij të padukshme, fuqia e tij e përjetshme dhe hyjnia e tij, duke qenë të dukshme nëpërmjet veprave të tij që nga krijimi i botës, shihen qartë, me qëllim që ata të jenë të pafalshëm. Sepse, megjithëse e njohën Perëndinë, nuk e përlëvduan as e falënderuan si Perëndi, përkundrazi u bënë të pamend në arsyetimet e tyre dhe zemra e tyre pa gjykim u errësua. Duke e deklaruar veten të urtë, u bënë të marrë, dhe e shndërruan lavdinë e Perëndisë të pakalbshëm në një shëmbëllim të ngjashëm me atë të një njeriu të kalbshëm, të shpendëve, të kafshëve katërkëmbëshe dhe të rrëshqanorëve.

(Rom. 1:18-23)

Kur Perëndia e krijoi njeriun në shëmbëllimin e Tij (Zan. 1:26-7), i dha gëzimin e njohjes dhe shërbimit ndaj Tij. Ai shfaqti natyrën e Tij në gjërat që kishte krijuar. Në këtë univers të mrekullueshëm Ai i dha njeriut një lloj pikturë të dukshme të vetë cilësive dhe aftësive të padukshme të Tij.

Është e pamundur për ne që ta sjellim ndër mend se si ka qenë kjo gjë. Ndoshta kur vështrojmë një perëndim madhështor të diellit, ose ndiejmë madhësinë e një kafshe të fuqishme të vendeve të egra, ose

veshtrojmë lart në gjerësinë e madhe të hapësirës së spërkatur me yje, ose mrekullohemi përbri djepit të një fëmiye që po fle dhe ndiejmë se na merret fryma me madhëshinë e gjithë këtyre gjërave, ne prekim përvijimin e asaj se ç'do të thotë ta njihje Perëndinë nëpërmjet krijimit të Tij. Por, më pas zgjohemi gjithmonë me ashpërsi; kujtojmë frikërat, mëkatet, trishtimet tona dhe të ardhmen e sigurt se të gjitha këto kënaqësi do të priten në mes nga vdekja. Por, në fillim, kur u krijua njeriu, në njohurinë e tij për Perëndinë nuk binin hije të tilla. Dëshmia e Psalmi 19 rikap thelbin e kësaj fryme:

*Qiejtë tregojnë lavdinë e Perëndisë
dhe kupa qiellore shpall veprën e duarve të tij.
Një ditë i flet ditës tjetër
dhe një natë ia tregon tjetrës.
Nuk kanë gojë, as fjalë;
[ku] zëri i tyre nuk dëgjohet;
por harmonia e tyre përhapet mbi gjithë dheun
dhe mesazhi i tyre arrin deri në skajin e botës.*

(Psalmi 19:1-4)

E gjithë kjo mund të jetë akoma e vërtetë (dhe sipas dëshmisë së Biblës, është). Por, pa dyshim kjo nuk është mënyra se si njerëzit e shohin jetën. Njerëzit e vënë në dyshim mirësinë e Perëndisë, madje hedhin poshtë edhe vetë ekzistencën e Tij. Ata thonë se nuk shohin asnjë garanci për prezencën e Tij, asnjë argument të sigurt për ekzistencën e Tij. Çdo gjë që rrethon shqyrtimin e fakteve, thonë ata, është në errësirë. Nuk ka asnjë dritë në univers që na udhëheq të Perëndia. Dhe kështu, i kthejnë kurrizin.

Kjo nuk e çudit aspak një studiues të Biblës. Por ai e kupton se thelbi i çështjes është shumë i ndryshëm. Errësira, thotë Pali, nuk është jashtë, por brenda. Nuk është për t'u çuditur që njerëzit nuk e zbulojnë Perëndinë, pasi ata janë bërë të kotë në mendimet e tyre, dhe mendjet e tyre janë errësuar. Tragjedia është se errësira është brenda, jo jashtë! Fuqia e mrekullueshme e Perëndisë, dhe natyra e Tij si një Perëndi i gjallë dhe i dashur mund të shihen ende në gjërat që ka bërë. Madje edhe reliktet e zvetënuara të krijimit fillestar mbajnë ende shenjat e dorës së dashur të Krijuesit.

Kjo është pika therëse e jetës sonë. Krijimi na thërret në harmoni: Perëndia, Krijuesi e do dhe e përmban krijimin e Tij. Por, njerëzit janë verbuar ndaj zbulesës së tij, janë ftohur ndaj dashurisë së Tij, janë

ngurtësuar ndaj vullnetit të Tij. Nga natyra e tyre ata nuk e njohin Perëndinë.

Pak njerëz kanë dhënë më shumë mendim për këtë, ose janë shprehur më qartë për këtë sesa francezi Zhan Calvin. Ja çfarë shkroi ai:

Është, pra, e kotë që kaq shumë llamba që digjen ndriçojnë mbi ne në artin e gjithësisë për të shfaqur lavdinë e Autorit të saj. Megjithëse na lajnë plotësisht me rrezatimin e tyre, prapëseprapë, ato kurrë nuk mund të na udhëheqin vetë në rrugën e drejtë. Pa dyshim që ato lëshojnë disa shkëndija, por përpara se drita e tyre e plotë të shkëlqejë, ato shuhen. Për këtë arsye, apostulli... ka për qëllim të thotë... se në këto shfaqje shpaloset hyjnueshmëria e padukshme e Zotit, por se ne nuk kemi sy për ta parë këtë në qoftë se nuk ndriçohen nga zbulesa e brendshme e Perëndisë nëpërmjet besimit.

(*Instituetet*, I:v:14)

Perëndia ka vepruar kështu. Ai ka parë paaftësinë natyrale të njerëzve për ta njohur dhe dashur Atë, për ta kuptuar dhe t'i shërbyer Atij, dhe ka ardhur në ndihmë të tyre. Këtë e ka bërë përmes një vargu veprash të fuqishme, me qëllim që t'i kthejë njerëzit në njohurinë e Tij. Por që as kjo të mos keqkuptohet apo shtrembërohet, Ai na e ka dhënë vetë shpjegimin për këto ngjarje. Ai na tregon se çfarë duhet të presim në jetët tona kur i besojmë Atij, duke na treguar se si ka punuar në jetët e njerëzve si ne gjatë shekujve të historisë biblike.

Letra drejtuar Hebrenjve, e cila në thelb është një libër që shpjegon rrugën që mund të na sjellë te njohuria e Perëndisë nëpërmjet Jezu Krishtit, hapet me një përmbledhje të asaj që ka bërë Perëndia për shërimin e gjendjes së njerëzve larg atij: ***Perëndia, mbasi u foli së lashti shumë herë dhe në shumë mënyra etërve me anë të profetëve, së fundi, këto ditë na ka folur me anë të Birit.*** (Heb. 1:1,2)

Zbulesa që Perëndia i ka bërë vetes së Tij ka disa veçori të rëndësishme. E para, është historike: Perëndia ka ndërhyrë në historinë e kombeve me qëllim që të tregojë fuqinë dhe dashurinë e Tij. E dyta, është fjalore: Perëndia ka dhënë një interpretim dhe shpjegim të qartë të veprave të Tij përmes atyre që shkruan faqet e Shkrimit. Pastaj, është grumbullore: Perëndia e dha zbulesën e Tij në mënyra të ndryshme dhe kohë të ndryshme. Dhe së fundi, qendra e saj është Krishti: kjo zbulesë e arriti

plotësimin e saj kur Perëndia u foli njerëzve fjalën e Tij të fundit në ardhjen e Birit të Tij, Jezu Krishtit.

Perëndia ka folur në kohë dhe mënyra të ndryshme. Shkrimi është regjistrimi i kësaj zbuluese. Në njëfarë mënyre mund të kishte qenë e mundur që jeta e krishterë të jetohej pa të. Një brez mund t'ia kishte kaluar brezit tjetër historinë e Jezusit dhe apostujve. Por Perëndia është shqetësuar për ruajtjen për ne të së vërtetës së shpëtimit të Tij. Kështu që na ka dhënë Biblën. Ai e di se kujtesa e njerëzve është e shkurtër, gjuhët e tyre të gjata dhe zemrat e tyre plot mashtrim. Bibla ruan në një formë të besueshme për ne atë që do të ishte ngatërruar gjatë shekujve. Mirë e ka shkrimtari hollandez Herman Bavinck kur thotë:

Fjala e shkruar... nuk humbet në ajër por vazhdon të jetojë; ajo nuk është, si traditat gojore, e prirur të falsifikohet;... ajo nuk është e kufizuar në ata pak veta që e dëgjojnë atë, por është e tillë, që, përkundrazi, mund të përhapet në gjithë popujt dhe në gjithë vendet. Shkrimi e bën të përhershme fjalën e folur, e mbron atë ndaj falsifikimit, dhe e shpërndan atë gjatë e gjerë.

(Besimi Ynë I Arsyeshem 'Our Reasonable Faith' fq. 96)

Kjo na kujton se Bibla nuk është shkruar kryesisht për studiuesit; ajo nuk u dha nga Perëndia për të qenë një libër mësimor në kolegjet. Përkundrazi, ai është libri baritor i Perëndisë, dhe ka një qëllim ungjillizues dhe ndërtues - jo thjesht të na mbushë kokën me informacion, por të na mbushë zemrën me njohuri për Perëndinë dhe dashuri për Të.

Kur e kuptojmë këtë, zbulojmë efektin që kjo gjë ka në shpirtin tonë kur lexojmë apo dëgjojmë fjalën e Perëndisë. Nuk duhet ta lejojmë kurrë vetveten që të largohet prej kësaj sigurie, se ajo që po lexojmë është një mesazh të cilin Perëndia e ka dhënë në mënyrë të veçantë dhe e ka ruajtur në formë të shkruar. Përmes saj Ai na tregon se sa shumë na do, dhe se si do të punojë Ai në jetën tonë për të na ndihmuar që ne ta njohim dhe t'i shërbejmë atij. Nëse e kuptojmë këtë, atëherë ne do të jemi të gatshëm që të punojmë me këmbëngulje për të kuptuar Shkrimin kur na kërkohet kjo gjë; do të jemi të gëzuar të marrim çfarëdolloj hapash të nevojshëm për t'u bërë të njohur sa më mirë me mendjen dhe vullnetin e Perëndisë në Bibël. Atëherë, ne kemi për të filluar të kuptojmë se vargjet e Shkrimit, rëndësinë e të cilave ne nuk e kuptonim më përpara, janë bërë plot kuptim dhe bekim në jetën tonë.

Deri tani, kemi thënë se Bibla është regjistrimi dhe interpretimi i zbulesës së Perëndisë në histori. Vetë Biblën mund ta mendojmë si zbulesë. Por ka edhe dy ide të tjera të cilat duhet t'i rrokim për të arritur të kuptojmë se çfarë është Bibla dhe pse Perëndia na e ka dhënë atë pikërisht kështu siç na e ka dhënë. Sepse vetë Bibla deklaron se është një libër si hyjnor ashtu edhe njerëzor. Ajo është e frymëzuar nga Perëndia, dhe megjithatë në faqet e saj ai ia përshtat veten e tij të kuptuarit të njeriut.

Frymëzimi

Themi se Bibla është e 'frymëzuar'. Por çfarë kuptojmë ne kur themi se besojmë se Bibla është 'e frymëzuar nga Perëndia'? Madje, nuk është një gjë e ashpër të themi se hera-herës të krishterët kanë ide shumë të turbullta për frymëzimin - dhe madje jobiblike!

Kur themi se Shkrimi është 'i frymëzuar', ne **nuk** kuptojmë se është 'frymëzues'. Shpesh, ai është. Por ka shumë vargje që nuk duken të jenë shumë frymëzuese.

Merrni si shembull kapitullin e parë të Ungjillit sipas Mateut. Si do të reagonit nëse dikush do të përpiquej të predikonte mbi gjenealogjinë e gjatë të Jezusit me të cilën hapet Ungjilli? Si do ta prisnit predikimin, nëse ajo listë e gjatë emrash do të zgjidhej si lexim nga Bibla? Unë mendoj se do të ishte shumë e saktë të thuash se reagimi i zakonshëm do të ishte: 'E di që na mërzite shumë sot?!' Kështu, nga një pikëvështrim, Bibla nuk është gjithnjë libër frymëzues (mendo për pjesë të tëra nga Levitiku, apo disa nga ligjëratat qortuese në librat e profetëve).

Por, pa dyshim që nuk duhet ta teprojmë kur themi këtë gjë. Sepse, kurdoherë që fillojmë të shohim kuptimin e vërtetë, arsyen se përse shkrimtari përfshiu ato që shkroi në librin e tij, ne në fakt **zbulojmë** se edhe vargje të tilla të errëta mund të jenë frymëzuese. Kur arrijmë të kuptojmë mesazhin që rrjedh përmes gjenealogjisë së Jezusit, se 'Perëndia po plotëson qëllimin e tij vit pas viti', atëherë zbulojmë se sa drithëruese është e gjithë kjo. Megjithatë, kur Pali i shkruajti Timoteut dhe tha se i gjithë Shkrimi është i frymëzuar prej Perëndisë, ai donte të thoshte diçka të ndryshme nga fjala 'frymëzues'.

Çfarë është frymëzimi? Dr. Benxhamin B. Uorfild (Benjamin B. Earfield), i cili dha mësim në Seminarin Princeton në Sh.B.A., ka qenë eksperti i madh mbi subjektin e frymëzimit biblik në shekullin e njëzetë. Ia vlen të citojmë një deklaratë mahnitëse që shkroi ai:

Është shumë e dëshirueshme që ne ta çlirojmë veten tonë që nga fillimi prej ndikimeve që dalin nga përdorimi i tanishëm i termit ‘frymëzim’. *Ky term nuk është një term biblik, dhe nënkuptimet e tij etimologjike nuk janë në përputhje të plotë me konceptin biblik të mënyrave të dhënies së Shkrimit nga veprimi hyjnor. (Shkronjat e pjerrëta janë prej autorit.)*

(Frymëzimi dhe Autoriteti i Biblës fq.153)

Çfarë donte të thoshte Uorfildi? Meqenëse ishte një nga mbrojtësit më të vendosur të pagabueshmërisë së Biblës, duket një gjë e habitshme që ai mohoi se ajo ishte ‘e frymëzuar’! Por, ai donte të thoshte këtë: ne nuk duhet ta mendojmë Shkrimin si një objekt në të cilin Perëndia fryn, por si diçka të cilën e ka ‘frymënxjerrë’ vetë Perëndia. Pra, nuk është se Perëndia i shtoi diçka fjalës që kishin shkruar njerëzit, por që Perëndia është vetë origjina, burimi i asaj që u shkrua. Si rrjedhim, në Dhiatën e Re ka vende të ndryshme ku, kur citohet Dhiata e Vjetër, fjalët ‘Perëndia’ dhe ‘Shkrimi’ shihen të ndërkëmbyeshme. Nëse Shkrimi thotë diçka, atëherë (meqenëse Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia) ne mund të themi: Perëndia e ka thënë atë (shih Gal. 3:8; Rom. 9:17 ku ‘Shkrimi’ është në të vërtetë i njëvlershëm me ‘Perëndia’; dhe Mat. 19:4,5 [ku citohet Zan. 2:24]; Heb. 3:7 [që citon Ps. 95:7]; Vep. 4:24,25 [që citon Ps. 2:1] ku ‘Shkrimi thotë’ konsiderohet i njëjtë me ‘Perëndia thotë’).

Dy gjëra përfshihen në frymëzimin e Biblës. E para, Fryma e Shenjtë punoi përmes njerëzve që shkruan librat e Biblës, dhe këtë gjë e bëri në një mënyrë të tillë që fjala e Perëndisë të komunikohet në atë që shkruan ata. Pa dyshim që shkrimtarët ishin në kontroll të plotë të vetvetes kur ndodhi kjo gjë. Por në të njëjtën kohë ata ishin nën kontrollin e Frymës së Shenjtë.

Ne nuk e përjetojmë fuqinë e Frymës së Shenjtë në të njëjtën mënyrë. Por, ndoshta, fuqinë e Tij e përjetojmë në mënyra paralele. Ne mund të veprojmë duke patur kontroll të plotë të vetvetes, ndërsa ecim në Frymë; por, duke shikuar në të kaluarën, zbulojmë se nëpërmjet veprimeve tona janë plotësuar qëllimet e Tij të përkryera. Në fakt, në ato raste kur jemi më të ndërgjegjshëm për praninë e Frymës në jetën tonë, jo vetëm që nuk mendojmë se e kemi humbur kontrollin, por, përkundrazi, ndihemi më shumë **ne** se kurrë ndonjëherë! Prandaj Pjetri thotë se shkruesit e Biblës shkruan **të shtyrë nga Fryma e Shenjtë** (2 Pjet. 1:21).

Pikërisht këtë premtoi Jezusi kur foli me dishepujt e tij në Dhomën e Sipërme. Ne ngutemi së tepërmi që të aplikojmë për veten tonë gjithçka

që ai u tha atëherë dishepujve (një gabim i zakonshëm në studimin tonë biblik, siç do ta shohim më vonë). Por disa prej premtimeve që dha ai atëherë ishin të caktuara në veçanti për apostujt:

Por Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t'ju mësojë çdo gjë dhe do t'ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë.

(Gjoni 14:26)

Por, kur të vijë ai, Fryma e së vërtetës, ai do t'ju prijë në çdo të vërtetë, sepse ai nuk do të flasë nga vetja, por do të thotë gjithë ato gjëra që ka dëgjuar dhe do t'ju kumtojë gjërat që do vijnë.

(Gjoni 16:13)

Ky është premtimi që Jezusi u dha atyre se do të kishte një Dhiatë të Re, dhe se ata do të ishin përgjegjës për shkrimin e saj, nëpërmjet ndikimit të Frymës së Shenjtë.

Së dyti, Perëndia mbizotëroi në jetët e njerëzve që shkruan Biblën. Pikërisht, ashtu siç na përgatit ne për shërbimin e tij, ashtu ai përgatiti përmes epokave njerëz të cilët do të ishin të përshtatshëm për të shkruajtur ato lloje librash të cilët tani përbëjnë Biblën. Përsëri, B. B. Uorfild e ka përshkruar siç duhet domethënien e kësaj:

Kur Perëndia dëshiroi që t'u jepte njerëzve të tij një varg letrash si të Palit, ai përgatiti një Pal që t'i shkruante ato, dhe Pali të cilit ai ia ngarkoi këtë detyrë ishte një Pal i cili do t'i shkruante këto letra në mënyrë të vetvetishme.

(Frymëzimi dhe Autoriteti i Biblës fq.155)

Kur, në një moshë të re, Uorfildi shprehu këtë pikëpamje, u akuzua nga disa të krishterë sikur po mohonte frymëzimin e Biblës! E njëjta gjë do të ndodhte ndoshta dhe sot. Megjithatë ky dyshim është shumë kuptimplotë pasi i ka rrënjët në idenë e gabuar se meqë Bibla është e frymëzuar, ajo nuk mund të jetë në të vërtetë njerëzore, dhe si rrjedhim shkruesit në të vërtetë nuk luajtën asnjë rol të vetëdijshëm në shkrimin e saj. Është mëse e domosdoshme që të kuptojmë gabimin e kësaj pikëpamjeje. Në themel ajo është produkti i të besuarit në një Perëndi i cili nuk ulet në nivelin tonë, por, që gjithmonë qëndron mënjanë. Zotra të tillë janë zotrat e mitologjisë greke dhe herezisë së

shekullit të parë, por jo Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezu Krisht. Derisa ne të kuptojmë mrekullinë e Perëndisë që u foli njerëzve, dhe e bëri këtë gjë nëpërmjet tyre, nuk do të mësojmë kurrë ta duam Biblën dhe Perëndinë që na e dha atë. Dhe kjo është pikërisht pika së cilës duhet t'i kthehemi tani.

Përshtatja

Nëse duam ta mendojmë për Biblën siç duhet dhe të dëgjojmë zërin e Perëndisë në të, nevojitet të pranojmë faktin se Bibla është e frymëzuar nga Perëndia. Por për të kuptuar siç duhet mesazhin e saj, duhet që të pranojmë gjithashtu dhe faktin binjak me të parin, që Perëndia ia ka përshtatur urtësinë e Tij të pafundme nivelit tonë të përjetimit duke na e dhënë Biblën nëpërmjet njerëzve.

Karakteristikat njerëzore të Biblës janë mjaft të dukshme. Tek e fundit, ajo është një vepër e përbërë e shkruar nga njerëz të ndryshëm në kohë të ndryshme. Personaliteti, sfondi, preokupimet dhe dhuntitë e tyre shkëlqejnë përmes gjithë asaj që shkruajtën. Përveç kësaj, librat e Biblës u hartuan në mënyra shumë të ndryshme.

Si i shkroi Moisiu librat e parë të Biblës? Ja një sugjerim nga i ndieri E. J. Jang (Young),

Është plotësisht e mundur që në përpilimin e Pentateukut [pesë librat e parë të Dhiatës së Vjetër - *shën. për.*], Moisiu të ketë patur fragmente dokumentesh ekzistuese të shkruara më parë... (të cilat) në *raste të caktuara*, mund të shpëgojnë përdorimin e emrave hyjnorë në Zanafillë.

(*Një Hyrje në Dhiatën e Vjetër* fq.153)

Libri i Psalmeve, siç kuptohet qartë, u zhvillua brenda një periudhe të gjatë kohore, dhe pasqyron, ndoshta më tepër se çdo libër tjetër i Dhiatës së Vjetër, përjetimet dhe emocionet e zakonshme njerëzore të cilat, nën mbikëqyrjen e dashur të Perëndisë, kontribuan në vlerën shpirtërore të Shkrimit.

Ungjilli sipas Llukës është një dokument interesant, pasi autori i tij faktikisht na tregon se si e përpiloi atë. Si një student i sotshëm kur shkruan një tezë, ai përshkruan metodën dhe qëllimet e tij:

Mbasi shumë veta ndërmorën të renditin tregimin e ngjarjeve që ndodhën në mesin tonë, ashtu si na i përcollën ata që ishin bërë nga fillimi dëshmitarë okularë dhe shërbyes të fjalës, m'u duk e mirë edhe mua, pasi i hetova të gjitha gjërat me kujdes që nga fillimi, të t'i shkruaj sipas radhës, fort i nderuari Teofil, që ti të njohësh vërtetësinë e gjërave që të kanë mësuar.

(Lluka 1:1-4)

Bibla është një libër njerëzor prej kreut në fund! Po nuk e kuptuam këtë kemi për ta humbur mesazhin e saj.

Disa javë para se të shkruaja këtë libër, dëgjova në radio një diskutim midis dy njerëzve me aftësi të konsiderueshme intelektuale që mjerisht po ilustronte këtë pikë. Ata po qaheshin së bashku për zhdukjen në ritje të Versionit të Autorizuar (Authorised Version, një ndër përkthimet më të vjetra të Biblës në anglisht). Pse? Sepse asnjë version tjetër nuk krahasohej me dinjitetin e gjuhës së tij. Në versionet e tjera gjuha ishte tepër e rëndomtë! Pikëpamja e tyre për qëllimin e gjuhës së Biblës është pikërisht e kundërta e qëllimit të Perëndisë. Ai donte të ulej në nivelin e njeriut dhe të plotësonte nevojat e Tij; kurse ata donin që Bibla të hiqej nga përjetimi dhe gjuha e zakonshme njerëzore. Por, të bësh këtë do të thotë të mbyllësh sytë para mrekullisë së Shkrimit - se Perëndia ka denjuar t'u flase krijesave të tij rebele dhe t'u tregojë atyre veten e Tij si Shpëtimtar. Augustini shkroi kështu:

Shkrimi vepron si të thuash, si me hapat e një nëne që përkulet për fëmijën e saj, për të mos na lënë pas në dobësinë tonë.

Perëndia flet nëpërmjet një njeriu, në një mënyrë njerëzore, sepse në të folurit në këtë mënyrë ai na kërkon.

Ndikimi i kësaj është i dyfishtë. E para është influenza që kjo gjë ka në mënyrën se si ne e studiojmë Biblën. Nëse ajo është jo vetëm hyjnore por edhe njerëzore, atëherë ne nuk kemi për ta studiuar atë sikur të kishte rënë nga qielli. Bibla është shumë e ndryshme nga lloji i librit që pretendohet të jetë Kur'ani. Është e nevojshme që të shqyrtojmë kohët, rrethanat dhe përjetimet pas shkrimit të saj. Nevojitet që të zbulojmë se çfarë kishte në mendje shkrimtari kur ai shkroi, dhe çfarë besonte ai se po u thoshte bashkëkohësve të tij. E gjithë kjo do të na ndihmojë që ne të zbulojmë se çfarë po na thotë Perëndia sot. Në qoftë se këtë lloj studimi

nuk e marrim seriozisht, nuk duhet që të na çudisë nëse përfundojmë duke e përdorur fjalën e Perëndisë në jetën tonë në një mënyrë të ndryshme nga ajo që dëshiron Ai.

Ndikimi i dytë i njohjes së elementit njerëzor në Bibël është: kjo do të na ndihmojë të çmojmë faktin se është e pashmangshme që rreth natyrës dhe mesazhit të Biblës të ketë pyetje dhe probleme që ne nuk mund t'i zgjidhim. Ngaqë duke na dhënë Biblën Perëndia ka depërtuar në historinë, është e mundur që të arrijmë në përfundimin se misteret e Biblës janë aq të shumta sa dhe ato për t'u përpjekur të kuptohet personi dhe veprat e Zotit Jezus. Por këto janë mistere që duhet të na bëjnë të mrekullohemi dhe adhurojmë - që Perëndia erdhi tek ne, edhe pse jemi burra dhe gra besimpakë; po, dhe gjithashtu, kuptimpakë.

Zoti ka folur. Ai ka zbritur në nivelin tonë si një atë që flet me fëmijët e tij, dhe e ka përlulur veten. Prandaj, dhe ne, kur të hapim faqet e Shkrimit duhet që ta përlulim veten tonë nëse duam të takohemi me këtë Zot të mëshirshëm dhe komunikues. Sepse, me të vërtetë, nuk kemi për ta njohur Zotin në fjalën e Tij nëse nuk jemi të gatshëm të bëhemi si Ai nëpërmjet studimit të faqeve të saj.

2 Si u Mblodh Bibla

Kapitullin e parë e filluam duke bërë pyetjen e thjeshtë por themelore: Pse e kemi Biblën? Jemi mësuar kaq shumë me ekzistencën e saj saqë rrallë, për të mos thënë kurrë, ndalemi për ta bërë këtë pyetje.

Porka dhe një pyetje tjetër themelore që duhet të bëjmë. Si u mblodh Bibla - këta gjashtëdhjetë e gjashtë libra të ndryshëm të shkruar gjatë një periudhe shumëshekullore - në një vëllim të vetëm?

A të dhanë, kur ke qenë i ri, një kartë të vogël me një pikturë të një rafti librash të ndarë në një sërë seksionesh, ku secili përmban libra të ndryshëm të Biblës? A ishin këto seksione të titulluara ‘historia’, ‘poezia’, ‘biografia’ e kështu me radhë? Kjo kishte për qëllim të na mësonte se Bibla nuk është një libër i vetëm, por një përmbledhje librash, një librari e së vërtetës së Perëndisë e përpiluar gjatë shumë viteve, që përmban lloje të ndryshme literature. Por nga e dimë ne se cilët libra duhet të jenë në librari? Si e gjetën vendin e tyre gjashtëdhjetë e gjashtë librat që kemi? Si mund të jemi të sigurt se kemi librat e duhur? A mund t’i shtojmë libra të tjerë Biblës? Dhe, tek e fundit, ç’rëndësi praktike ka kjo?

Tridhjetë e nëntë Nenet e Anglikanizmit, dhe *Rrëfimi i Besimit i Uestminsterit* (1643) i Presbiterianizmit na tregojnë të dyja se gjashtëdhjetë e gjashtë librat që kemi në Bibël formojnë ‘Kanunin’ e Dhiatës së Vjetër dhe të Re. ‘Kanun’ është një fjalë greke. Ajo do të thotë stap, apo shkop i drejtë. Ajo filloi të përdorej, natyrisht, si një fjalë për masë, apo rregull, dhe kështu për një rregull veprimi. Ajo përdoret në Dhiatën e Re në këtë kuptim (2 Kor. 10:13,15,16), dhe më qartë në fjalët mbyllëse të Palit drejtuar Galatasve: ***Dhe të gjithë ata që do të ecin sipas kësaj rregulle paçin paqe dhe mëshirë, e ashtu qoftë edhe për Izraelin e Perëndisë*** (Gal. 6:16). Gjatë shekujve të parë të jetës së kishës, ajo filloi të përdorej për përmbajtjen e Dhiatës së Re: së bashku ato formuan ‘rregullën e besimit dhe jetës’ me të cilën e gjithë kisha dhe të krishterët personalisht qeverisnin jetën e tyre.

Por si erdhën në ekzistencë Dhiata e Vjetër dhe e Re?

Kanuni i Dhiatës së Vjetër

Moisiu u urdhërua të shkruante në një formë të qëndrueshme zbulësën që Perëndia i dha atij: *Atëherë Moisiu erdhi dhe i tregoi popullit tërë fjalët e Zotit dhe tërë ligjet. Dhe gjithë populli u përgjigj me një zë dhe tha: “Ne do të bëjmë tërë gjërat që Zoti ka thënë”. Dhe Moisiu i shkroi tërë fjalët e Zotit.* (Eksodi 24:3,4)

Kur Ligji i Përtërirë regjistron fazën përfundimtare të jetës së Moisiut, ai na tregon për rregullimet që ai bëri për udhëheqësinë e ardhshme të popullit të Perëndisë. Ai i foli Jozueut në një mbledhje të madhe publike, ia caktoi ofiqit të udhëheqësit, dhe e siguroi për ndihmën e Perëndisë. Por bëri dhe një garanci tjetër për popullin:

Kështu Moisiu e shkroi këtë ligj dhe ia dorëzoi priftërinjve, bijve të Levit, që mbajnë arkën e besëlidhjes të Zotit dhe të gjithë pleqve të Izraelit. Pastaj Moisiu i urdhëroi ata, duke thënë: “Në fund të çdo shtatë vjetëve, në kohën e caktuar si vit i faljes, në festën e Kasolleve, kur tërë Izraeli do të vijë të paraqitet përpara Zotit, Perëndisë tënd, në vendin që ai ka zgjedhur, do të lexosh këtë ligj para tërë Izraelit, në veshët e tërë izraelitëve. Do të mbledhësh popullin, burra, gra, fëmijë dhe të huajin që ndodhet brenda portave të tua, që të dëgjojnë dhe të mësojnë të kenë frikë nga Zoti, Perëndia juaj, dhe të kenë kujdes të zbatojnë në praktikë tërë fjalët e këtij ligji, kështu që bijtë e tyre që akoma nuk e njohin, të dëgjojnë Zotin, Perëndinë tuaj, dhe të kenë frikë prej tij, për të gjithë kohën që do të jetojnë në vendin që ju po hyni ta pushtoni, duke kaluar Jordanin.”

(Ligji i Përtërirë 31:9-13)

Në të vërtetë, megjithëse Perëndia caktoi një udhëheqës dhe i dha njerëzve një Shkrim, ai e bëri të qartë se ky i fundit ushtron gjithnjë autoritet mbi të parin. Fjala e tij për Jozueun në fillim të shërbimit të tij ishte:

Vetëm tregohu i fortë dhe shumë trim, duke u përpyetur të veprosh simbas tërë ligjit që Moisiu, shërbëtori im, të ka urdhëruar; mos u shmang prej tij as djathtas, as majtas, që të kesh mbarësi kudo që të shkosh. Ky libër i ligjit mos u ndaftë kurrë nga goja jote,

por mendohu për të ditë e natë, duke kërkuar të veprosh simbas të gjitha atyre që janë shkruar, sepse atëherë do të kesh sukses në veprimet e tua, atëherë do të përparosh.

(Jozueu 1:7,8)

Fjala e Perëndisë, në formë të shkruar, si Shkrim, u bë rregulla me të cilën Jozueu dhe i gjithë populli i Perëndisë duhej të qeverisnin jetën e tyre. Ajo duhet të ishte Bibla për ta.

Gjatë leximit të mëtejshëm të fazeve të Dhiatës së Vjetër zbulojmë se e gjithë jeta e Izraelit përcaktohet nga besnikëria, ose jobesnikëria e tyre ndaj kësaj urdhërese të Zotit. E gjithë historia interpretohet prej këtij parimi; i gjithë adhurimi është një pasqyrim i tij. Çelësi për të kuptuar mesazhin e profetëve është se ata janë njerëz të dërguar nga Perëndia për të theksuar dështimin e popullit për të ecur sipas fjalës së Perëndisë; ata i paralajmërojnë ata se gjykimet që premtoi Ai për të pabesët janë shfaqur tashmë në horizontin e historisë. I njëjti Perëndi i cili foli duke dhënë Ligjin po flet përsëri nëpërmjet profetëve. Ai i thërret njerëzit që t'i kthehen besnikërisë ndaj detyrimeve të tyre të besëlidhjes dhe bindjes ndaj Ligjit. Si rrjedhim, njerëzit besimtarë të kohës së Dhiatës së Vjetër e panë se e njëjta fjalë e Perëndisë që dëgjohej në shkrimet e Ligjit dëgjohej edhe në predikimet e profetëve.

Çifutët vlerësuan diçka që shpesh u shpëton lexuesve joçifutë të Biblës. Librat e tillë si Jozueu, Samueli, Mbretërit dhe Kronikat ata i përfshinë në *Profetët*. Hebrenjtë e kuptuan se parimet që përshkruheshin kaq qartë në predikimin e profetëve ishin po kaq fuqimisht të pranishme në mënyrën me të cilën 'librat historikë' të Dhiatës së Vjetër e regjistruan historinë kombëtare. Ata u shkruan nga pikëvështrimi i Ligjit të Perëndisë. Shfaqja e profetëve të tillë si Elija dhe Eliseu në kronikat e marrëdhënieve të Perëndisë me popullin e tij ishte thjesht maja e aisbergut. Perëndia po e gjykonte gjithnjë popullin e Tij nën dritën e Ligjit, madje edhe kur nuk dërgonte asnjë lajmëtar për t'i kujtuar ata se kishin ngritur krye kundër Tij.

Kështu, shohim tashmë se në 'kanun', Shkrimet që Perëndia po i jepte popullit të tij, kishte dy ndarje. Ishte Ligji, dhe pastaj duke u zhvilluar prej tij, Profetët. Këtyre iu shtuan ato që u bënë të njohura si 'Poezia'; libra si Psalmet dhe Fjalët e Urta, libri i Jobit, Ruthi, Kantiku i Kantikëve, Vajtimet, Predikuesi dhe Esteri. Ka një mister të madh për mënyrën me të cilën këta libra në veçanti arritën të konsideroheshin si Shkrime. Pesë librat e fundit (të njohur si Pesë Rrotullat) kanë qenë të lidhur për shumë

shekuj me Festimet e mëdha çifute. Për një kohë të gjatë ata u lexuan publikisht në raste të tilla, dhe u përdorën si shembuj të rrugëve të Perëndisë me njerëzit. Ata ishin protrete grafike të parimeve të shtjelluara në Ligj dhe të theksuara në Profetët.

Mund të mos jemi në gjendje t'u përgjigjemi të gjitha pyetjeve rreth mënyrës se si u bënë pjesë e Biblës këta libra. Ajo që është megjithatë e qartë, është se me kalimin e kohës populli i Perëndisë e kuptoi se ata i transmetonin njerëzimit zërin e vërtetë të Perëndisë. Me gjithë ndryshimet e tyre në autorësi, stil, lloj literature dhe kohë, ata i bashkonte një fill bashkues. Kjo filloi të njihej nga zemra e dëgjuesit besnik: zëri i Perëndisë foli me një autoritet të palëkundur; të njëjtat parime që ai u kishte dhënë në mënyrë dramatike njerëzve në Sinai shfaqeshin dhe ilustroheshin në këtë librari shkrimesh të ndryshme.

Gjatë shekullit të parë pas Krishtit, Rabinët çifutë u takuan në Xhamnia dhe diskutuan përmbajtjen e Shkrimeve të Dhiatës së Vjetër. Ata nuk po kërkonin dhe aq të formulonin kanunin e Dhiatës së Vjetër, sesa të diskutonin nëse librat që përgjithësisht njiheshin si Shkrime të Dhiatës së Vjetër ishin në fakt librat të cilët duhet të njiheshin si të tillë apo jo. Shumë kohë më vonë, gjatë Reformacionit Protestant, kur mësimi i pranuar për një kohë të gjatë i Kishës Romake mbi kanunin e Shkrimit u vu në dyshim, pati një diskutim të mëtejshëm për të.

Megjithatë, për shumicën e të krishterëve është e mjaftueshme të dihet se Dhiata e Vjetër që kemi është, me aq sa mund të themi me siguri, e njëjta Dhiatë e Vjetër që përdori vetë Jezusi. Ai citoi lirshëm pjesë të ndryshme të Dhiatës së Vjetër si fjala e Perëndisë apo Shkrimi. Është e qartë që ai e pranoi pikëpamjen e bashkëkohësve të tij se ajo ishte e gjithë-frymëzuar dhe përfundimisht e autoritetshme. Nuk ishte përmbajtja e Shkrimit (kanuni) ajo për të cilën ishin në kundërshti Jezusi dhe farisenjtë, por interpretimi i tij (dhe përfundimisht, pra, autoriteti i tij, meqë ata nuk e lejonin Shkrimin që t'u interpretohej vetë atyre). Kështu Zoti ynë foli për origjinën hyjnore të Pentateukut (p.sh., Mat. 19:4, 5); ai foli herë pas here për nevojën që profecitë të përmbusheshin; ai komentoi mbi mënyrën me të cilën shkrimi i Davidit ishte i frymëzuar nga Fryma (Marku 12:36). Kur u takua me dy dishepujt në rrugën për në Emaus ai filloi *nga Moisiu dhe nga gjithë profetët* dhe shpjegoi se fjalët e tyre ishin vetëm përgatitja e ardhjes së tij (Luka 24:27). Më vonë atë mbrëmje, Jezusi i rëngjallur tregoi më qartë:

‘Këto janë fjalët që unë ju thoja kur isha ende me ju: se duhet të përmbushen të gjitha gjërat që janë shkruar lidhur me mua në

ligjin e Moisiut, në profetët dhe në psalmet.' Atëherë ua hapi mendjen, që të kuptonin Shkrimet.

(Lluka 24:44,45)

Bibla e Jezusit dhe Dhiata jonë e Vjetër ishin të njëjta. Bibla e tij nuk ishte një libër i vetëm, por shumë rrotulla; Bibla e tij ishte e ndarë në tri ndarje të mëdha, ndryshe nga e jona. Librat kishin një renditje të ndryshme. Por përmbajtja ishte e njëjtë, dhe mbi këtë përmbajtje ai vendosi firmën e tij: 'Kjo është fjala e Zotit'. Atë që ai e mendoi si fjala e Perëndisë edhe ne mund ta quajmë me mirëbesim 'fjala e Perëndisë'.

Kanuni i Dhiatës së Re

Ndoshta keni dëgjuar të thuhet (ose e keni menduar edhe vetë), se nëse apostujt do të mund të shihnin se sa thellë studiohen shkrimet e tyre, pothuaj dy mijë vjet pas vdekjes së tyre; apo, nëse ata do të kishin mundësi të ktheheshin sot në kishë, do të mrekulloheshin kur të zbulonin se çfarë ndodhi me letrat e tyre. Ata nuk e prisnin kurrë që ne do t'u vinim kaq shumë rëndësi!

Por, kur hapim vetë Dhiatën e Re për të parë se çfarë na mëson ajo për qëndrimin e shkruësve kundrejt asaj që ata shkruan, zbulojmë se e kundërta është e vërtetë. Asgjë nuk do t'i habiste më pak apostujt sesa zbulimi se të krishterët po lexojnë akoma atë që shkruan ata. Asgjë nuk do t'i hidhëronte ata më shumë sesa kur të na shihnin se sa pak kujdes i kushtojmë shpesh mësimi të tyre. Ata e dinin se ajo që po shkruanin ishte një shtesë në fjalën e Perëndisë.

Ky mund të duket një pohim ekstrem, por nuk është i vështirë për t'u vërtetuar. Ai është një pohim kaq i rëndësishëm saqë duhet ta konsiderojmë më tej.

Kur autorët e Dhiatës së Re shkruan, ata e bënë këtë me qëllim që t'u komunikonin Ungjillin bashkëkohësve të tyre të atëhershëm. Por duke vepruar kështu, ata ishin të vetëdijshëm se ajo që shkruan ishte më shumë sesa thjesht një shprehje personale e dëshmisë së tyre për Krishtin. Ajo duhej të merrej dhe lexohej si një mësim i autoritetshëm. Kështu, për shembull, Pali u thotë të krishterëve të rinj në Thesalonik: ***Ju përbetoj për Zotin që kjo letër t'u lexohet gjithë vëllezërve të shenjtë*** (1 Thes. 5:27). Një thënie e ngjashme shfaqet në fund të Kolosianëve (4:16).

Në fund të Letrës drejtuar Romakëve ka një thënie tjetër e cila i jep peshë kësaj pikëpamjeje. Duke folur për Ungjillin e Krishtit, Pali thotë se ai *tani u shfaq e u zbulua me anë të Shkrimeve të profetëve, sipas urdhërimit të Perëndisë të përjetshëm dhe u njoh ndër të gjitha kombet, për t'i sjellë në dëgjuesën e besimit* (Rom. 16:26). Këto fjalë na kujtojnë atë që shkroi ai në Efes. 3:3-6 për zbulesën që i kishte dhënë Perëndia. Ajo zbulesë është e shkruar tani - dhe përfshihet në 'Shkrimet e profetëve'. Pali nuk mund ta kishte përdorur kurrë një shprehje të tillë, kaq të ngjashme me mënyrën me të cilën ai përshkruan shkrimet e Dhiatës së Vjetër, nëse ai nuk do ta kishte kuptuar rëndësinë e asaj që ai vetë po shkruante.

I njëjti sens i autoritetit hyjnor shfaqet nga fundi i diskutimit të tij të gjatë për vendin dhe përdorimin e dhuntive frymërore: *Në qoftë se dikush mendon se është profet ose frymëror, le të njohë se ato që po ju shkruaj janë urdhërime të Zotit. Dhe nëse dikush është i paditur le të jetë i paditur.* (1 Kor. 14:37,38) Prova e të qenit vërtet frymëror nuk është ushtrimi i dhuntive frymërore, por pranimi plot gëzim se fjala e letrës së apostullit është gjithashtu fjala e Zotit! Është e vështirë të imagjinohet ndonjë pohim më i fortë për autoritetin e qëndrueshëm të Dhiatës së Re dhe të vlefshmërisë së saj për kishën.

Pohime të ngjashme shfaqen në korrespondencën me Thesalonikun:

Prandaj dhe ne e falënderojmë pa pushim Perëndinë, se kur ju keni marrë nga ne fjalën e Perëndisë, e pritët atë jo si fjalë njerëzish, por, sikurse është me të vërtetë, si fjalë Perëndie, që vepron ndër ju që besoni.

(1 Thes. 2:13)

Dhe në qoftë se dikush nuk i bindet fjalës sonë në këtë letër, shënojeni atë dhe mos u shoqëroni me të, që ai të turpërohet.

(2 Thes. 3:14)

Kjo nuk duhet të na habisë. Ideja e një apostulli në Dhiatën e Re është e atij që është i dërguar. Ai vishet me autoritetin e atij që e dërgoi - në këtë rast, vetë Krishti. Kjo është arsyeja që Pali nganjëherë e mbron pushtetin e tij apostolik kaq fort (krahaso 1 Kor. 9:1 e sipër; Gal. 1:1,11-24). Këtë ai e bën jo ngaqë është i shqetësuar për namin e tij personal, siç

e bën të qartë (në 2 Kor. 11, 12), por sepse ai është thellësisht i shqetësuar që fjala e Zotit nëpërmjet tij të mos braktiset, injorohet apo përbuzet. Ai është po aq apostull sa dhe apostujt e tjerë. Ai e transmeton fjalën e autoritetshme të Mjeshtrit, po ashtu si ata (krah. Mat. 10:40; Gjoni 13:20; 14:26; 15:26; 16:13-15; Vep. 1:2). Prandaj dhe në Heb. 2:2 apostujt krahasohen me engjëjt të cilët ishin ndërmjetës në dhënien e ligjit në Sinai. Asgjë nuk mund ta shprehte më qartë se ajo që ata thanë ishte fjala e Perëndisë për popullin e Perëndisë. Kështu, kur u shkruajt Ungjilli sipas Gjonit, autori i tij përdori të njëjtën shprehje për librin e tij me atë që ai kishte përdorur për librat e Dhiatës së Vjetër - *janë shkruar* (Gjoni 20:31; krah. Gjoni 2:17; 6:31,45; 10:34; 12:14; 15:25).

Është ky themel që e bën të mundur që Letra e Dytë e Pjetrit të përmbajë thënien e shquar:

Dhe kini parasysh se durimi i Zotit tonë është në shërbim të shpëtimit, sikurse ju ka shkruar edhe vëllai ynë i dashur Pal, sipas dëitursë që iu dha; ashtu bën ai në të gjitha letrat e tij, ku flet për këto gjëra. Në to ka disa gjëra të vështira për t'u kuptuar, të cilat të paditurit dhe të paqëndrueshmit i shtrembërojnë, sikurse bëjnë me Shkrimet e tjera, për përhumbljen e tyre.

(2 Pjetri 3:15,16)

Pjetri i vendos letrat e Palit në të njëjtin nivel me *Shkrimet e tjera*. Shkrimet që Perëndia i ka dhënë kishës nëpërmjet apostujve duhet të konsiderohen pjesë e Shkrimit.

Apostujt vetë ishin të dijshtëm se kjo ishte arsyeja që Krishti i kishte thirrur ata në shërbimin e tyre të veçantë. Ishte kjo që i bënte ata dëshmitarë unikalë për të. Të tjerë mund të flisnin për fuqinë e tij shpëtuese; të tjerë mund të përdoreshin për ungjilltarë, pastorë dhe mësues. Por ata kishin marrë një premtim të veçantë prej Zotit Krisht, se ai do t'u dërgonte Frymën e tij për t'i aftësuar që ata të shkruanin faqet e Dhiatës së Re. Ai u dha atyre autoritetin për t'i dhënë kishës një grup literature për të gjitha kohërat si rregull të besimit dhe jetës. Ai kishte autoritetin e plotë në qiejt dhe tokën; ata duhej pra, të shkonin, në autoritetin e tij, për t'u mësuar kombeve gjithçka që ai u mësoi atyre.

Përfundimisht, pra, përmbajtja e Dhiatës së Re pasqyron mësimin e autoritetshëm të vetë Jezusit (shih Gjoni 14:25,26; 15:26,27; 16:12-15; Mat. 28:18-20).

Natyrisht, u desh pak kohë përpara se çdo i krishterë në çdo pjesë të botës së ungjillizuar të kuptonte se 27 librat e Dhiatës së Re të sotme ishin fjala e Perëndisë. Disa kisha zotëronin vetëm disa pjesë të Dhiatës së Re, dhe Letrat dhe Ungjijtë u shkruan në kohë dhe vende të ndryshme. Ishte e paevitueshme që të formoheshin versione të vogla të Dhiatës së Re, dhe të shfaqeshin kanune të ndryshme në pjesë të ndryshme të botës. Dhe kështu, në një zonë do të dilnin pyetje nëse librat që ishin pranuar në një zonë tjetër duhej apo jo të përfshiheshin në Dhiatën e tyre të Re.

Pa dyshim, këtij procesi iu desh kohë. Megjithatë që nga periudha e hershme kisha e krishterë e kuptoi se Perëndia kishte qenë duke i shtuar fjalës së Tij nëpërmjet apostujve. Shkrimet më të hershme të shekujve të dytë dhe të tretë tregojnë se pjesë të Dhiatës së Re po përdorshin si fjalë e Perëndisë. Nga fundi i shekullit të katërt ishte e pranuar gjerësisht se 27 librat që ne i quajmë tani Dhiata e Re ishin fjala e Perëndisë për epokën e re të Ungjillit.

Rëndësia

Ndoshta ju mund të pyesni se çfarë vlerë të mundshme praktike ka e gjithë kjo, sado që është interesante. Në fakt, rëndësia e saj është shumë e gjerë.

Gjashtëdhjetë e gjashtë librat e Dhiatës së Vjetër dhe të Re i janë dhënë kishës nga Zoti Jezu Krisht dhe nga apostujt si fjala e Perëndisë. E gjithë Bibla është fjala e Perëndisë. Perëndia flet përmes saj thjesht dhe qartë. Perëndia na flet neve sot vetëm nëpërmjet fjalës së tij. Vetëm ajo që gjejmë në faqet e Biblës na aftëson të themi: 'Këtë e ka thënë Perëndia.'

Pse duhet që kjo të jetë kaq e rëndësishme? Sepse njerëzit e krishterë, të cilët rrëfejnë se vetëm Bibla është rregulla e besimit dhe jetës së tyre, se vetëm Bibla është fjala e Perëndisë, shpesh nuk veprojnë në përputhje me rrëfimin e tyre. Megjithëse ata e pranojnë me gojë pikëpamjen se vetëm fjala e Perëndisë është udhëzuesi ynë, në fakt ata jetojnë sikur Perëndia të ketë mënyra të tjera 'të foluri'.

Më kujtohet shumë qartë kur udhëhiqja një mision veror me një grup të rinjsh. Vonë një mbrëmje, tre të rinj - të cilët nuk i njihnim - arritën në qendër. 'Zoti na ka thënë të qëndrojmë me ju sonte', thanë ata.

Mua m'u duk pak interesante që Zoti nuk u kishte dhënë asnjë njoftim udhëheqësve të ekipit tonë për këtë! I interesuar të zbuloja se çfarë qëndronte pas 'udhëzimit' që kishin marrë këta të panjohur, pyeta

më tej: 'Nga e dini se Zoti ju tha të rrini me ne?' Përgjigjja u dha menjëherë, 'Se na ka thënë Ai.' Kur unë pyeta më tej, përgjigjja u zgjerua në 'Ai vetëm na e tha.' 'Mirë,' thashë unë, 'Unë mendoj se nëse Zoti do të kishte planifikuar që ju të qëndroni me ne sonte ai do t'ju kishte siguruar shtrëtrë për ta bërë të mundur këtë gjë - dhe ne nuk kemi asnjë shtrat të tepërt për ju!'

Diskutimi i nxituar solli një ndryshim planesh: 'Zoti po i thotë njërit prej nesh që të qëndrojnë, dhe dy të tjerët të shkojnë' erdhi përgjigjja.

Në këtë kohë unë mendova se do të ishte një gjë e urtë ta pranoja propozimin e tyre, por në të njëjtën kohë të diskutoja me ta mënyrën me të cilën Perëndia udhëheq dhe udhëzon fëmijët e tij në jetë. Unë u përpoqa t'u sugjeroja atyre se normalisht (madje ndoshta dhe rrallë), Perëndia nuk i udhëheq fëmijët e tij nëpërmjet këtyre lloj nxitjesh të pashpjegueshme dhe të menjëhershme që kishin përjetuar këta të rinj. 'Nga e dini ju se ai që po fliste ishte Perëndia, dhe jo djalli?' pyeta unë, 'si mund të jeni të sigurt?' 'Ne *jemi* të sigurt' ishte përgjigjja.

Kur njerëzit pretendojnë të kenë një udhëzim të drejtpërdrejtë nga Perëndia veçan shkrimeve, është praktikisht e pamundur ta diskutosh çështjen me ta dhe t'i bindësh se vullneti i Perëndisë njihet me rrugë të tjera. Për më tepër, edhe ata të krishterë inteligjentë që janë të bindur se Perëndia na udhëheq gjerësisht nëpërmjet nxitjesh të brendshme, parandjenjash dhe 'ndjenjash', kundërshtojnë zakonisht që t'ia nënshtrojnë këtë lloj udhëzimi provës, dhe ta sjellin atë te guri provë i Shkrimit.

Kur arrijmë të kuptojmë domethënien e kanunit të Shkrimit - se Perëndia e ka zbuluar vullnetin e Tij në mënyrë të autoritetshme për kishën në *Bibël* - një nga bekimet që kjo sjell në jetën tonë është se çlirohemi nga varësia mundësisht shkatërruese ndaj parandjenjave dhe përshtypjeve. Çlirohemi nga mendimi 'si rrufeja në qiell të pastër' ndaj udhëzimit i cili, megjithëse me dukje shpirtërore, është më tepër e mundur të vijë nga nënvetëdija jonë, apo madje edhe nga një frymë e keqe, sesa nga Fryma e Shenjtë. Ne nuk kemi për të gjetur më udhëzim të autoritetshëm në ndjenjat tona subjektive, por në drejtimit, premtimet, shembujt dhe urdhërimet e Perëndisë në *Bibël*. Çdo mendim që do të kemi për atë që *mund* të jetë vullneti i Perëndisë do të duam ta sjellim te mesimi i Biblës, dhe ta shqyrtojmë nën dritën e saj.

Edhe kjo ka nënkuptime të gjera për kishën sot në fushën e dhuntive frymërore, apo 'frymërore' (1 Kor. 12:1). Unë kam parasysh veçanërisht përjetime të tilla si vizione, ëndrra, dhuntitë e profecive dhe të folurit në

gjuhë të panjohura. Në epokën tonë (që karakterizohet nga një reagim ndaj racionalizmit steril dhe moralit viktorian) ka një prirje pothuaj të natyrshme për t'u tërhequr në valën e entuziazmit për përjetim shpirtëror. Ishte në një situatë çuditërisht të ngjashme në kishën e Korintit që apostulli Pal (i cili dinte për këto gjëra më shumë se çdokush tjetër!) e ndjeu të nevojshme që të jepte shumë fjalë paralajmërimi. Do të bënim mirë që t'ia vinim veshin asaj që ka për të thënë ai.

Ne mund të jemi në rrezik sot që t'u ngjitem një autoritet të tillë ëndrrave, vizioneve, profecive dhe mesazheve në gjuhëra që nuk u ishte dhënë kurrë prej apostujve. Shumë të krishterë sigurisht i kanë parë këto përjetime të pandërmjetme si një prej rrugëve më kryesore në të cilat Perëndia e udhëheq popullin e Tij individualisht dhe bashkarisht.

Përsëri, mund të jetë e dobishme që ta ilustrojmë këtë pikë. Unë kam njohur njerëz që u është thënë, nëpërmjet një mesazhi të folur në gjuhë të panjohur, dhe të interpretuar, se ata duhet të fillonin të takoheshin, dhe se kjo duhej të çonte në martesë. Në mënyrë të ngjashme, janë bërë profeci për sferën e ardhshme të shërbimit, apo të çfarëdo gjëje tjetër, të një krishteri të veçantë. Ç'mund të themi për këtë? Në rastin e dy të rinjve të cilët 'u drejtuan' drejt njëri-tjetrit nga një mesazh në gjuhë të panjohura, mua më kujtohet mirë se do të kishte qenë e vështirë për Perëndinë të bashkonte dy njerëz të tjerë më pak të përshtatshëm për njëri-tjetrin! 'Ky është thjesht një gjykim njerëzor!' mund të thotë dikush. Por çfarë nëse parimet e mëdha biblike për dashurinë, njohjen dhe martesën, dhe magazina e pasur e udhëzimit për qëllimin e Perëndisë kur na bëri burrë dhe grua, na sugjeron se dy të rinj do të ishin partnerë të papërshtatshëm jete për njëri-tjetrin? Çfarë nëse, kur vendoset pranë mësimi të Biblës, mesazhi në gjuhë të duket një kontraditë? Kush ka autoritet përfundimtar?

Në të njëjtën zonë të përgjithshme të përjetimit ka një histori shumë me kripë në Veprat e Apostujve. Kur Pali ishte në Cezare, profeti Agabus (ndoshta i njëjti njeri i cili profetizoi saktësisht në Vep. 11:28) profetizoi se Pali do të burgosej në Jeruzalem (Vep. 21:11). Njerëzit iu lutën Palit që të mos shkonte në Jeruzalem. Pse atëherë ai shkoi? Sepse ai u shty nga Fryma (Vep. 20:22). Tani, është interesante të vërehet se kur Pali kishte qenë në Tiro, ai qëndroi me dishepujt për një javë: ***Të shtyrë nga Fryma, ata i thoshin Palit të mos ngjitej në Jeruzalem*** (Vep. 21:4).

Ç'kuptim ka ky rrëfim në pamje kontradiktor për atë që po thoshte Fryma? Do të thotë se, edhe në ditët e apostujve, shprehjet profetike duhej të provoheshin objektivisht për të dalluar se cili ishte vullneti i Perëndisë

dhe çfarë ishte thjesht një thënie e njeriut dhe kështu ishte e prirur të gabonte. Ku mund të gjendeshin prova të tilla? Në besnikërinë ndaj zbulesës së Perëndisë nëpërmjet apostujve.

A nuk ka kjo diçka për t'i thënë kishës sot? Jetojmë në 'një epokë të menjëhershme'. Jemi më tepër të prirur të kërkojmë një Perëndi i cili na udhëheq gjithashtu në mënyrë të menjëhershme, sesa një Perëndi i cili e ka thënë të vërtetën e tij në faqet e Shkrimit, dhe na ka ftuar për të zbuluar vullnetin e tij duke zbatuar të vërtetën e saj në jetë tonë. Pa dyshim duket sikur ka diçka më shpirtërore në udhëzimin e menjëhershëm, por kujtoni fjalët e Palit për Korintasit: ***Do të lutem me frymën, POR DO TA BËJ EDHE ME MENDJEN. Do të këndoj me frymën, POR DO TË KËNDOJ EDHE ME MENDJEN*** (1 Kor. 14:15). Ne duhet të themi: ***Do të udhëhiqem me frymën time - por do të udhëhiqem edhe me mendjen.***

Ja pra, çfarë ndodh nëse e kërkojmë vullnetin e Perëndisë në fjalën e Perëndisë. Në vend që të na i ngushtojë apo kufizojë jetën, një udhëzim i tillë e bën atë më të fortë dhe më të qëndrueshme - dhe, ndryshe nga udhëzimi i menjëhershëm, ai na e transformon karakterin. Siç kemi për ta parë, Perëndia na e ka dhënë Biblën pikërisht për të na e forcuar karakterin. Pra, në fund të fundit, kanuni ka ndikimin më praktik.

3 A është kjo Fjala e Perëndisë?

Nëse dikush do t'ju pyeste: 'Nga e di ti se Bibla është me të vërtetë fjala e Perëndisë?' si do t'i përgjigjeshit?

Mesazhi që Pali u solli Thesalonikasve u pranua *jo si fjalë njerëzish, por, sikurse është me të vërtetë, si fjalë Perëndie, që vepron ndër ju që besoni* (1 Thes. 2:13). Por nga e dinte ai këtë? Si mund ta gjejmë këtë lloj sigurie për Biblën?

Ne arrijmë në përfundimin se Dhiata e Vjetër dhe e Re përmban fjalët autentike të Perëndisë për ne pikë së pari nga pohimet që bëjnë ato, dhe së dyti nga efektet që ato prodhojnë.

Pohimet e Biblës

Bibla nuk është vetëm një përmbledhje vëllimesh, të shkruara në kohë të ndryshme dhe të mbledhura gjatë shumë shekujve, por ajo është edhe një libër i vetëm me një temë të madhe qendrore që rrjedh nëpër të. Kjo është ajo që e bën Biblën unike - nga njëra anë ajo është shumë libra, nga ana tjetër është një vepër e vetme. A ka ndonjë arsye për këtë paradoks? Pa dyshim që ka! Bibla është shkruar nga shumë njerëz në kohë të ndryshme. Por në analizën përfundimtare ajo ka vetëm një burim, dhe një autor - vetë Perëndinë.

Ky nuk është thjesht një interpretim i kishës për Biblën, por, është vetë pikëpamja e Biblës për veten. Nganjëherë sugjerohet se, meqë Shkrimi u 'përpilua' nga kisha, është e pamundur të flitet për 'pikëpamjen e Biblës për veten'. Por Bibla *flet* për veten: Ajo flet në mënyrë të vetëdijshme për natyrën e saj. Siç e kemi parë tashmë (në 2 Pjetrin) ajo e bën këtë duke patur parasysh se në ditët e apostujve vetë Bibla po rritej dhe po plotësohej.

Letra drejtuar Hebrenjve thotë kështu: *Perëndia, mbasi u foli së lashti shumë herë dhe në shumë mënyra etërve me anë të profetëve, së fundi, këto ditë na ka folur më anë të Birit.* (Heb. 1:1,2) Ja pikëpamja e

Dhiatës së Re për llojllojshmërinë e zbulesës në Dhiatën e Vjetër, si dhe theksi i fortë mbi faktin se është Perëndia ai që ka folur përmes këtyre kanaleve të ndryshme. Ngaqë autori është një, Bibla e plotë përçon një ndjenjë madhështore uniteti dhe harmonie.

Pali pozicionohet me këto fjalë: "I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia (2 Tim. 3:16). Kjo do të thotë se çdo pjesë e shkruar e cila ka karakterin e "Shkrimit" merr pjesë gjithashtu në këtë veçori të Shkrimeve të Dhiatës së Vjetër - Shkrimet e Shenjta të cilat Timoteu i njihte qysh fëmijë (2 Tim. 3:14,15) - ato ishin frymëzuar nga vetë Perëndia.

Në mënyrë të ngjashme, shkruesit e Ungjijve besuan (ashtu si dhe Gjoni) se po i shtonin asaj 'që është shkruar'. Shkruesit e Dhiatës së Re ishin plotësisht të dijshtë se po i kalonin kishës një mesazh të autoritetshëm. Zbulojmë se edhe për ta Bibla nuk ishte një seri librash të izoluar, por një përpilim literature përmes të cilit Perëndia po i jepte popullit të Tij një mesazh të madh të vetëm.

Kur Jezusi i mësoi dishepujt për Shkrimet, ai vuri *firmën* e tij mbi Dhiatën e Vjetër si fjala e Perëndisë. Për të, Shkrimi nuk mund të binte poshtë, sepse ai ishte zëdhënësi i Perëndisë. Prandaj, dhe kur dishepulli e rri mësimit të Jezusit seriozisht, shtyhet drejt përfundimit se Shkrimi është fjala e Perëndisë. Konkluzioni logjik i çdo interpretimi tjetër është se pikëvështrimi i Jezusit për Biblën (dhe si rrjedhim, dhe vetë Jezusi) është i pabesueshëm dhe i mangët.

Përveç kësaj, kur Jezusi i veçoi dishepujt e tij të veçantë për shërbimin e të qenit apostuj të tij, shtimi ndaj Shkrimevetashmë ekzistuese ishte një nga detyrat parësore që u dha atyre. Fryma e Shenjtë u ishte dhënë atyre për t'i ndihmuar që ata të shkruanin Shkrimin (krah. Gjoni 14:25,26; 16:12-15). Ata u dërguan në botë për të mësuar gjithçka që vetë Jezusi u kishte mësuar (Mat. 28:18-20). Gjithë këtë ne e kemi vënë re më lart.

Nëse ka patur një kohë të veçantë gjatë shërbimit të Zotit tonë kur kishte më shumë të ngjarë se do të dilnin në pah bindjet e tij më të thella për Biblën, ka qenë kur ai u përballua me trysinë e jashtëzakonshme të Gjetsemanit dhe Kalvarit. Por është pikërisht atëherë që ne e shohim atë ta pranojë autoritetin përfundimtar të Shkrimit në vetë jetën e tij.

Pse duhet të vdesë? **SIKURSE ËSHTË SHKRUAR PËR TË, Biri i njeriut pa tjetër shkon.** (Mat. 26:24)

Pse duhet të tradhtohet? **DUHET TË PËRMBUSHET KY SHKRIM:** "Ai që ha bukën me mua, ka ngritur thembrën kundër meje." (Gjoni 13:18)

Pse duhet të braktiset? **SEPSE ËSHTË SHKRUAR:** “*Do ta godas Bariun dhe delet do të shpërndahen.*” (Marku 14:27)

Pse duhet të urrehet aq shumë? **QË TË PËRMBUSHET FJALA E SHKRUAR NË LIGJIN E TYRE:** “*Më kanë urreyer pa shkak.*” (Gjoni 15:25)

Pse nuk e përdor pushtetin e tij për t’i shpëtuar kryqit? **PO ATËHERË, SIDO TË PËRMBUSHESHIN SHKRIMET,** *sipas të cilave duhet të ndodhte kështu?* (Mat. 26:54)

Këto fjalë pasqyrojnë bindjet më të thella të Jezusit. Dishepulli i krishterë mund të jetë i sigurt se Zoti i tij i konsideroi Shkrimet si fjala e frymëzuar dhe e pacënueshme e Perëndisë. Ajo që thoshin ato ishte ajo që tha Perëndia. Pavarësisht nga prirjet e tij personale (dhe thirrja e tij në Gjetejsemani, *Ati im, në qoftë se është e mundur, largoje prej meje këtë kupë*, tregon se ku qëndronin dëshirat e tij natyrale njerëzore), ai pa drejt Shkrimet për të zbuluar vullnetin e Perëndisë. Prandaj dhe ai iu nënshtua përlësisht atij.

Kur Krishti i takoi dy dishepujt në rrugën për në Emaus i drejtoi ata tek Shkrimi si interpretimi i autoritetshëm i Perëndisë për jetën, vdekjen dhe ringjalljen e tij. Ai nuk tha: ‘Harrojeni studimin e Biblës tani që u ngjalla!’ Përkundrazi, Jezusi theksoi autoritetin e fjalës së Perëndisë. Ai i inkurajoi ata për të kuptuar dhe besuar dëshminë e saj, ndonëse ata nuk e kishin kuptuar ende prezencën e tij. A nuk është domethënëse që *pasi* Jezusi ua shpjegoi atyre mesazhin e Biblës ata filluan ta kuptonin kush ishte ai?

Ne e dimë se Bibla është fjala e Perëndisë. Ajo pohon se është e tillë. Jezusi besonte se ajo ishte e tillë. Ne duhet të shkojmë tani një hap më tej dhe të pyesim, Çfarë efektsh prodhon Bibla të cilat na udhëheqin për të besuar dëshminë që ajo jep për veten?

Efektet e Biblës

Bibla është një libër i mrekullueshëm. Mund të ketë patur një kohë, kohët e fundit, kur libri *Mendimet e Kryetarit Mao* kishte më shumë kopje të shitura sesa *Versioni i Autorizuar* (një nga përkthimet e Biblës në gjuhën angleze). Por sa jetëshkurtër që janë best-sellerët e tjerë! Bibla i ka qëndruar dhe rezistuar provës së kohës. Një arsye është se ajo është një literaturë e madhe. Ka patur një kohë kur të krishterët i vinin shumë rëndësi kësaj:

Lexo Demostenin apo Ciceronin; lexo Platonin, Aristotelin dhe të tjerët e kësaj kategorie. Ata, e pranoj, që do t'ju joshin, gëzojnë, mallëngjejnë, magjepsin në masë të mrekullueshme. Por çohuni tani prej tyre drejt këtij leximi të shenjtë. Atëherë, pavarësisht nga vetja jote, ai do të të prekë kaq shumë, do të ta përshkojë kaq shumë zemrën, do të ngjitet kaq shumë në palcën tënde, saqë krahasuar me përshtypjen e tij të thellë, forca shprehëse e këtyre oratorëve dhe filozofëve do të zhduket pothuajse fare. Si rrjedhojë është e lehtë të shihet se Shkrimet e Shenjta, që i kalojnë kaq shumë të gjitha dhuntitë dhe hiret e përpjekjes njerëzore, lëshojnë si kundërmim diçka hyjnore.

(Zhan Kalvin, *Institutet* I.viii.1)

Për shumicën prej nesh, që nuk na duket se Aristoteli 'na magjeps', e gjithë kjo mund të na duket pak e tepruar! Por rëndësia e asaj që tha Kalvini qëndron gjithsesi. Ka diçka unikale në Bibël. Të paktë janë njerëzit që e lexojnë atë me një mendje të hapur dhe nuk e njohin madhësitinë dhe pushtetin e saj. Por, megjithatë, efektet e Biblës tek ne janë më tepër se kaq.

Kur dy dishepujt që Jezusi i takoi në rrugën për në Emaus shprehën përjetimin e tyre pas ndarjes së tij, ranë dakord për një gjë: kur Jezusi po u shpjegonte atyre mesazhin e Dhiatës së Vjetër filluan t'u digjeshin zemrat. Ata ndjenë atë që ndjeu më vonë edhe Xhon Uezli në takimin e tij me Krishtin në Aldersgate Street, Londër. Edhe atij 'iu ngroh në mënyrë të çuditshme' zemra. Është përfundimisht ky efekt i Biblës që na bind për të vërtetën dhe fuqinë e saj.

Teologët e quajnë këtë përjetim 'dëshmia e Frymës së Shenjtë'. Quhet kështu sepse kaq shpesh ajo shoqërohet me dëshminë e Frymës së ne jemi fëmijët e Perëndisë (Rom. 8:15).

Këto dy gjëra shkojnë shpesh (megjithëse jo gjithmonë) dorë më dorë - zbulimi se Bibla është fjala e gjallë e Perëndisë, dhe zbulimi se nëpërmjet besimit në Krishtin unë jam tani një fëmijë i vërtetë i Perëndisë, i lindur prej vdekjes shpirtërore në jetën e përjetshme. Abraham Kajper, një teolog i cili më vonë u bë kryeministër i Hollandës, ishte tashmë një shërbyes i ri i Fjalës kur e përjetoi këtë gjë vetë. Ai e përshkroi se çfarë ndodh:

Dalëngadalë, perdja shtyhet mënjatë. Syri kthehet drejt dritës Hyjnore që shkëlqen nga Shkrimi, dhe tani uni ynë i brendshëm

vështron superioritetin që i imponohet. Ne e shohim atë si një i lindur i verbër, i cili sapo shërohet shikon bukurinë e ngjyrave, apo si një i shurdhër, dëgjimi i të cilit sapo rimëkëmbet, kap meloditë që vijnë nga bota e tingujve, dhe gëzohet në to me gjithë shpirtin e tij.

(*Parimet e Teologjisë së Shenjtë* fq 558)

Kjo është ajo që ndodhi në Veprat e Apostujve, kur Ungjilli u përhap përtej kufijve të çifutëve.

Imagjinoni zyrtarin e lartë të mbretëreshës Kandace i cili kishte udhëtuar për në Jezuralem për të kërkuar Perëndinë, dhe po kthehej duke patur me vete një pjesë të blerë të profecisë së Isaias. Shiheni atë në karrocën e tij lëkundëse, duke e mbajtur fort rrotullën që të mos lëvizë ndërsa lexon në Isaian 53 për qengjin që shpiket në thertore, dhe megjithatë, është i plagosur, i goditur dhe i ndëshkuar për mëkatet e të tjerëve. Ky përshkrim e bën fuqimisht të mendohet; megjithatë kjo është gjithashtu e habitshme dhe misterioze. Por atëherë, një zë pranë karrocës e pyet: ***A e kupton atë që po lexon?*** Është Filip ungjilltari. Perëndia e ka dërguar atë te ky kërkues i së vërtetës. ***E si do të mundja*** përgjigjet etiopasi, ***po s'pata një që të më udhëzojë?*** (shih Vep. 8:26-40). Këtë gjë e bën Filipi, dhe njeriu bindet se rrotulla në dorën e tij është fjala e Perëndisë.

Nganjëherë Perëndia u dërgon një Filip atyre që kërkojnë ta kuptojnë fjalën e tij. Herë të tjera ua hap zemrën dhe sytë pa përdorimin e asnjë faktori njerëzor. Shumë të krishterë, kur pyeten se si u bënë të krishterë, se ku ishin kur zemrat e tyre filluan t'u digjeshin përbrenda, apo kush i ndihmoi për të filluar që të ndiqnin Krishtin, do të thonë: 'Kam qenë vetëm, duke lexuar Biblën, dhe gjithçka filloi të futej në vendin e duhur. Kuptova, dhe besova.'

Unë kam qenë duke e lexuar Biblën për disa vjet përpara se të isha në gjendje të thoja këtë. Fillova ta lexoja që kur isha në fillore, duke menduar se të lexuarit e Biblës dhe të qenit i krishterë ishin e njëjta gjë. Më kujtohet akoma habia që më dhanë fjalët e Jezusit: ***Ju hetoni Shkrimet sepse mendojnë të keni nëpërmjet tyre jetë të përjetshme; dhe ato janë këto që dëshmojnë për mua. Por ju nuk doni të vini tek unë që të keni jetën*** (Gjoni 5:39,40). Në atë kohë m'u duk sikur këto fjalë qenë folur duke synuar jetën time, dhe konfuzionin tim. Unë po i kërkoja Shkrimet, por nuk po vija për të kërkuar Krishtin. Që prej asaj kohe unë kërkoja

atë, derisa e gjeta. Tani që shoh pas mund të kuptoj se Krishti që gjeta pak kohë më vonë ishte Krishti që me kishte gjetur mua nëpërmjet fjalës së tij, kur unë po mendohesha për domethënien e Gjonit 5.

Kur ishte në Selanik, Pali e pa të ndodhte në një shkallë të gjerë këtë gjë. Reagimi ndaj shërbimit të tij të fjalës së Perëndisë ishte një pranim i zërit të Perëndisë që fliste nëpërmjet fjalëve të tij (1 Thes. 2:13). Kjo ishte një përsëritje e premtimit të Jezusit se kur ai i thërriste delet e tij ato do t'ia njihnin zërin dhe do ta ndiqnin (Gjoni 10:4,16).

I njëjti përjetim është përsëritur në jetë të panumërta, qofshin këto të shquara apo të përlura. Ja si u çlirua Augustini, në moshën tridhjetë e dy vjeçare, nga zinxhirit e mëkatit dhe ndarjes së tij nga Perëndia. Ky është një shembull tjetër i dëshmisë së Frymës së Shenjtë. Ai na bind për autoritetin e Biblës si fjala e Perëndisë nëpërmjet mënyrës që ai e përdor atë dhe efektet që prodhon prej saj:

Dërgova lart këto fjalë të trishtueshme: S a g jatë, s a g jatë, 'nesër dhe nesër?' Pse jo tani? Pse të mos jetë këtë orë fundi i papastërtisë sime?

Kështu po flisja, dhe po vajtoja në pendimin më të hidhur të zemrës sime, kur ja! Dëgjova nga shtëpia fqinje një zë, djali a vajze, nuk e di, duke kënduar dhe përsëritur vazhdimisht, 'Merr dhe lexo; Merr dhe lexo.' Menjëherë çehrija ime ndryshoi dhe fillova të mendoja shumë ngultazi, nëse fëmijët e kishin zakon të thoshin këso fjalësh në çfarëdolloj loje: dhe as nuk më kujtohej t'i kisha dëgjuar ndonjëherë të tilla. Kështu duke pushuar rrëkenë e lotëve të mia, u çova; duke e interpretuar atë si asgjë tjetër veç një urdhërimi të Perëndisë, që të hapja librin (Biblën), dhe të lexoja kapitullin e parë që do të gjeja.... Me padurim u ktheva atëherë te vendi ku ishte ulur Alipi; sepse atje e kisha vendosur vëllimin e apostullit kur isha çuar prej andej. E kapa, e hapa, dhe në qetësi lexova atë pjesë ku ranë sytë e mi që në fillim: ***Jo në orgji dhe në dehje, jo në imoralitet dhe sensualizëm, jo në grindje e në smirë. Por vishuni me Zotin Jezu Krisht dhe mos tregoni kujdes për mishin, që t'ia kënaqni lakmütë.*** (Rom. 13:13,14)

Nuk mund të lexoja më; dhe as nuk kisha nevojë për më tepër: sepse menjëherë në fund të kësaj fjalie, e gjithë errësira e dyshimit u zhduk plotësisht nga një dritë paqeje që më hyri në zemër....

Që aty shkuam tek nëna ime [e cila kishte qenë duke u lutur me zjarr për kthimin e tij për shumë vjet], dhe ia thamë. Ajo u gëzua... kërceu nga gëzimi, dhe dukej triumfuese, dhe të bekoj Ty, *që je i aftë të bësh më shumë se sa mund të kërkojmë apo mendojmë*; sepse ajo pa se Ti i kishte

dhënë asaj më shumë për mua sesa kishte qenë e aftë të lutej në rënkimet e saj të gjora dhe të mjera. Sepse Ti më ktheve tek vetja Jote....

Dhe Ti ia ktheve vajtimin në valle. (Psalmi 30:11)

(Libri i *Rrëfimeve* VIII:29-30)

Kjo është logjike, megjithëse jo sipas logjikës së kësaj bote. Në filozofinë e kësaj bote është e domosdoshme që të provohet se diçka është ashtu me anë të argumentit logjik përpara se ajo të pranohet me të vërtetë. Kjo është dhe arsyeja, që kur logjika e kësaj bote i drejtohet Biblës ajo nuk është e aftë as ta provojë dhe as ta përgënjeshtrojë se ajo është fjala e Perëndisë. Tek e fundit, nëse Bibla është fjala e Perëndisë cila do të ishte një provë e mjaftueshme se ajo është e tillë? Një teolog i madh i kishës së hershme na dha një logjikë më të mirë kur tha se ‘vetëm Perëndia është një dëshmitar i përshtatshëm për veten’ (Hilari i Puatierit, *Mbi Trininë* Libër 1:18).

Ka shumë mënyra me të cilat mund ta rekomandojmë Shkrimin. Jetët tona duhet të tregojnë shenjat e hirit të Perëndisë nëpërmjet studimit të tij. Megjithatë, ndonëse ne mund të jemi në gjendje të shpjegojmë pohimet e vetë Biblës; ndonëse mund të jemi të aftë ta mbrojmë Biblën nga sulmet (edhe pse Ç. H. Spërxhën (Spurgeon) tha se më mirë të mbronte luanin sesa Biblën!) - në fund të fundit ne e dimë se për t’u bindur me të vërtetë se Bibla është fjala e gjallë e Perëndisë të gjallë e që flet për nevojat tona më të thella, duhet që në zemrat tona të punojë Perëndia.

Ne besojmë se Bibla është fjala e Perëndisë, sepse ajo pohon se është e tillë dhe sepse Fryma e Shenjtë, kur lexojmë faqet e saj, na bind nëpërmjet efekteve të saj se ky pohim është i vërtetë. Kjo është dhe arsyeja, që kur e shohim se po sulmohet Bibla, dhe përpiqemi ta mbrojmë me gjithë fuqinë tonë, ne kemi bërë vetëm një pjesë të asaj që është e domosdoshme. Për veten tonë, ne duhet t’u kthehemi përsëri faqeve të saj për të dëgjuar ‘zërin e vogël e të qetë’ të Perëndisë në të. Për të tjerët, ne duhet t’i ftojme që ta lexojnë vetë mesazhin e saj. Vetëm nëse veprojnë kështu, dhe Fryma e Perëndisë të dëshmojë për fuqinë e saj, kanë për të parë se ajo është fjala e Perëndisë të gjallë. Kur ata dëgjojnë që Perëndia po u flet, çdo gojë duhet të heshtë, dhe e gjithë bota të bëhet e ndërgjegjshme për fajin e saj para Perëndisë (Rom. 3:19). Ai zë që bën të heshtë zërin e tyre do t’i bindë ata përfundimisht se pohimi i Biblës është i vërtetë. Ajo është fjala e Perëndisë.

1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25
26
27
28
29
30
31
32
33
34
35
36
37
38
39
40
41
42
43
44
45
46
47
48
49
50
51
52
53
54
55
56
57
58
59
60
61
62
63
64
65
66
67
68
69
70
71
72
73
74
75
76
77
78
79
80
81
82
83
84
85
86
87
88
89
90
91
92
93
94
95
96
97
98
99
100
101
102
103
104
105
106
107
108
109
110
111
112
113
114
115
116
117
118
119
120
121
122
123
124
125
126
127
128
129
130
131
132
133
134
135
136
137
138
139
140
141
142
143
144
145
146
147
148
149
150
151
152
153
154
155
156
157
158
159
160
161
162
163
164
165
166
167
168
169
170
171
172
173
174
175
176
177
178
179
180
181
182
183
184
185
186
187
188
189
190
191
192
193
194
195
196
197
198
199
200
201
202
203
204
205
206
207
208
209
210
211
212
213
214
215
216
217
218
219
220
221
222
223
224
225
226
227
228
229
230
231
232
233
234
235
236
237
238
239
240
241
242
243
244
245
246
247
248
249
250
251
252
253
254
255
256
257
258
259
260
261
262
263
264
265
266
267
268
269
270
271
272
273
274
275
276
277
278
279
280
281
282
283
284
285
286
287
288
289
290
291
292
293
294
295
296
297
298
299
300
301
302
303
304
305
306
307
308
309
310
311
312
313
314
315
316
317
318
319
320
321
322
323
324
325
326
327
328
329
330
331
332
333
334
335
336
337
338
339
340
341
342
343
344
345
346
347
348
349
350
351
352
353
354
355
356
357
358
359
360
361
362
363
364
365
366
367
368
369
370
371
372
373
374
375
376
377
378
379
380
381
382
383
384
385
386
387
388
389
390
391
392
393
394
395
396
397
398
399
400
401
402
403
404
405
406
407
408
409
410
411
412
413
414
415
416
417
418
419
420
421
422
423
424
425
426
427
428
429
430
431
432
433
434
435
436
437
438
439
440
441
442
443
444
445
446
447
448
449
450
451
452
453
454
455
456
457
458
459
460
461
462
463
464
465
466
467
468
469
470
471
472
473
474
475
476
477
478
479
480
481
482
483
484
485
486
487
488
489
490
491
492
493
494
495
496
497
498
499
500
501
502
503
504
505
506
507
508
509
510
511
512
513
514
515
516
517
518
519
520
521
522
523
524
525
526
527
528
529
530
531
532
533
534
535
536
537
538
539
540
541
542
543
544
545
546
547
548
549
550
551
552
553
554
555
556
557
558
559
560
561
562
563
564
565
566
567
568
569
570
571
572
573
574
575
576
577
578
579
580
581
582
583
584
585
586
587
588
589
590
591
592
593
594
595
596
597
598
599
600
601
602
603
604
605
606
607
608
609
610
611
612
613
614
615
616
617
618
619
620
621
622
623
624
625
626
627
628
629
630
631
632
633
634
635
636
637
638
639
640
641
642
643
644
645
646
647
648
649
650
651
652
653
654
655
656
657
658
659
660
661
662
663
664
665
666
667
668
669
670
671
672
673
674
675
676
677
678
679
680
681
682
683
684
685
686
687
688
689
690
691
692
693
694
695
696
697
698
699
700
701
702
703
704
705
706
707
708
709
710
711
712
713
714
715
716
717
718
719
720
721
722
723
724
725
726
727
728
729
730
731
732
733
734
735
736
737
738
739
740
741
742
743
744
745
746
747
748
749
750
751
752
753
754
755
756
757
758
759
760
761
762
763
764
765
766
767
768
769
770
771
772
773
774
775
776
777
778
779
780
781
782
783
784
785
786
787
788
789
790
791
792
793
794
795
796
797
798
799
800
801
802
803
804
805
806
807
808
809
810
811
812
813
814
815
816
817
818
819
820
821
822
823
824
825
826
827
828
829
830
831
832
833
834
835
836
837
838
839
840
841
842
843
844
845
846
847
848
849
850
851
852
853
854
855
856
857
858
859
860
861
862
863
864
865
866
867
868
869
870
871
872
873
874
875
876
877
878
879
880
881
882
883
884
885
886
887
888
889
890
891
892
893
894
895
896
897
898
899
900
901
902
903
904
905
906
907
908
909
910
911
912
913
914
915
916
917
918
919
920
921
922
923
924
925
926
927
928
929
930
931
932
933
934
935
936
937
938
939
940
941
942
943
944
945
946
947
948
949
950
951
952
953
954
955
956
957
958
959
960
961
962
963
964
965
966
967
968
969
970
971
972
973
974
975
976
977
978
979
980
981
982
983
984
985
986
987
988
989
990
991
992
993
994
995
996
997
998
999
1000

Dy

Si ta Përdorim Biblën

4 Bëje Vetë

Ftesa për Mitingun e të rinjve e titulloi fjalimin si 'Kordoni i Kuqerremë'. Ishte një titull që të ngjallte shumë kureshtje. Kordoni në fjalë, doli se i përkiste Rahabit, zonjës me nam të dyshimtë, që e kishte shtëpinë në Jeriko në kohën e Jozueut (Joz. 2). Ajo e përdori këtë kordon si shenjë për forcat pushtuese. Ata kishin urdhër që t'i shpëtonin ata që jetonin në shtëpinë jashtë së cilës ishte varur kordoni i kuqerremë. Kaq gjë unë e dija kur folësi paraqiti temën e fjalimit të tij. Por mesazhi kryesor i tij ishte ky: kordoni i kuqerremë ishte një pikturë e gjakut të Krishtit. Vetëm ata që mbrohen nga gjaku i Krishtit mund të shpëtohen.

Këtë rast nuk e kam harruar kurrë, dhe shpesh thellohesha mbi të gjatë adoleshencës. Pyetja që me shqetësonte ishte kjo: Nga e dinte folësi që kordoni i kuqerremë ishte një pikturë e flijimit të Krishtit? A ishte kjo ajo që Zoti po thoshte me të vërtetë në Jozueun, kapitulli dy? Atëherë unë nuk dija atë që di tani.

Që prej kohës më të hershme pas vdekjes së shkruesve të Dhiatës së Re (dhe ndoshta edhe kur ata ishin gjallë, me aq sa dimë ne) disa të krishterë të sinqertë e kanë kuptuar domethënien kryesore të kordonit të kuqerremë të Rahabit si mesazhi i kryqit të Krishtit. Letra e Parë e Klementit, e shkruar rreth fundit të shekullit të parë pas Krishtit, na thotë:

Ata [spiunët] i dhanë asaj një shenjë kështu, që ajo të varte jashtë shtëpisë së saj një kordon të kuqerremë. Dhe kështu ata treguan se shpengimi duhet të derdhet nëpërmjet gjakut të Zotit mbi të gjithë ata që besojnë dhe shpresojnë te Perëndia. Ju e shihni, o të dashur, se në këtë grua nuk kishte vetëm besim, por edhe profeci.

(Letra e Parë e Klementit, Kapitulli XII.)

Po a është kjo mënyra e duhur për të kuptuar një pasazh të Shkrimit? Ja një shembull tjetër, i dhënë nga Dr. G. Kempbell (Campbell)

Morgan:

Ai predikoi për këtë tekst: *Mefiboshethi banonte në Jeruzalem, sepse hante gjithnjë në tryezën e mbretit. Ishte sakat nga të dyja këmbët.*

Kjo është një histori e bukur për Davidin dhe dashurinë e tij për Jonathanin. Ai (predikuesi) i bëri ndarjet e tij në këtë mënyrë:

‘Vëllezër të mi, ne shohim këtu sonte, *së pari*, doktrinën e shthurjes njerëzore - Mefiboshethi ishte sakat. *Së dyti*, doktrinën e shthurjes së plotë - ai ishte sakat nga të dyja këmbët. *Së treti*, doktrinën e shpalljes së drejtësisë - ai banonte në Jeruzalem. *Së katërti*, doktrinën e birësimit - ai rrinte ulur në tryezën e mbretit. *Së pesti*, doktrinën e këmbënguljes së shenjtoreve - ai hante gjithnjë në tryezën e mbretit.’

(Predikimi faqe 115-116)

Çfarë duhet të bëjmë me këto dy ilustrime?

Atyre nuk u mungon mendjeshkathtësia! Por, interpretimi në asnjë rast nuk përcjell mesazhin e vërtetë të pasazhit. Në vend që të thonë atë që Perëndia thotë në këto pjesë të fjalës së tij, interpretime të tilla theksojnë diçka që në të vërtetë nuk ka aspak të bëjë me mesazhin e këtyre pjesëve të Shkrimit. Mund të shkojmë edhe më tej. Mund të themi se nëse aplikohen logjikisht ato lloje parimesh që shtrihen nën këto interpretime, atëherë do të jemi të aftë ta bëjmë Biblën të thotë pothuaj gjithçka që të dëshirojmë ne! Dhe vetëm aksidentalisht, kemi për të thënë ndonjëherë atë që na mëson vetë Bibla në të vërtetë!

Këto komente mund të duken shumë të ashpra. Por një moment reflektimi mbi pasazhet në fjalë do të tregojë se, megjithëse ato mund të duken të ashpra, janë megjithatë të vërteta.

Cili është rëndësia e kordonit në historinë e Rahabit? S’është asgjë më shumë sesa një kordon. Ajo nuk u shpëtua ngaqë kordoni përfaqësonte gjakun e Krishtit, por ngaqë ajo arriti të besojë në Zotin e Abrahamit, Isakut dhe Jakobit. Sikur kordoni të kishte qenë i gjelbër, apo edhe i zi, kjo nuk do të kishte ndonjë rëndësi për shpëtimin e saj. Megjithatë, ngaqë ai është i kuqerremë, me anë të lidhjes së ideve filloi të kuptohet si një simbol i vdekjes së Krishtit.

Në mënyrë të ngjashme, kur lexojmë për Mefiboshethin, kuptimi nuk është që ne të mësojmë se jeta e tij na pajis me një teologji sistematike të përmbledhur. Kuptimi është që ne të mësojmë për kujdesin dhe mëshirën e Perëndisë që rrjedh përmes shërbëtorit të tij Davidit, dhe për rëndësinë e të qëndruarit besnik ndaj premtimit dhe betimit të dhënë tjetrit.

Ka dhe shumë e shumë shembuj të tjerë të këtij lloji. Problemi që përmbajnë ata është se në ta mesazhi i Biblës del të jetë diçka që shtrihet përtej fjalëve të përdorura dhe të vërtetave që ato simbolizojnë. Ngjarjet, deklaratimet dhe fjalët dalin të kenë kuptime të dyta - dhe pikërisht këtyre kuptimeve të dyta u jepet rëndësi e dorës së parë. Nganjëherë, lidhja ndërmjet kuptimit gramatikor dhe historik të vargut, dhe interpretimi që i bëhet, bëhet tepër e çuditshme. Ajo bëhet më shumë subjektive dhe madje mistike sesa vërtet biblike. Megjithatë, mundësisht asgjë nuk është më e zakonshme se kjo në interpretimin privat apo madje dhe publik të Biblës. Prandaj dhe është shumë e rëndësishme që ne t'u vemë veshin parimeve të drejta dhe një metode të drejtë për të kuptuar Biblën.

Pali vendosi parimet e një metode të drejtë për të kuptuar dhe përdorur Biblën kur i shkroi Timoteut: ***Mundohu të dalësh përpara Perëndisë si i sprovuar, si punëtor që nuk ka pse të turpërohet, që thotë drejt fjalën e së vërtetës.*** (2 Tim. 2:15) Fjala për 'mundohu' (*spudazin*) është një fjalë shumë interesante në këtë kontekst. Kuptimi bazë i saj është 'të nxitohesh', dhe nganjëherë, në Dhiatën e Re ajo përcjell idenë e bërjes së një përpjekjeje të mundimshme. Në këtë kuptim e përdor Pali atë në 2 Tim. 4:9, 21. Në thirrjen e tij për unitet të krishterë në Efes. 4:3, ai i nxit të krishterët që 'të bëjnë çdo përpjekje' për ta ruajtur atë. Dhe si për të theksuar energjinë që duhet për të, ai vazhdon duke e përshtatur mënyrën e afrimit të Timoteut për të kuptuar Shkrimin si atë të një 'punëtori'. Ideja e 'të ndarit' apo 'të përdorurit në mënyrë të drejtë' e konfirmon këtë, sepse fjala përdoret edhe për bërjen e një rruge! Pali po përcjell një pikturë të një përpjekjeje të sforcuar të bërë me qëllim që mesazhi i Biblës të kuptohet ashtu siç duhet. Kjo është një punë e rëndë!

Mësuesi i famshëm viktorian i Biblës Alexander MacLaren (Aleksandër Mëklaren) e kishte zakon të shkonte në studim çdo mëngjes i veshur jo me pantofla të buta por me një palë çizme të rënda. Kur e pyetën për këtë, ai u përgjigj se këtë e bënte për t'i kujtuar vetes se kur studonte fjalën e Perëndisë kishte të bënte me një punë të vështirë dhe sfilitëse. Kjo nuk është pa kuptim! Dikush ka thënë, me njëfarë të drejte, se 'gjysma e teologjisë së keqe vjen si rezultat i mos djersitjes' - pra, vjen si rezultat i mosbërjes së përpjekjes, mosharxhimit të kohës, mos të ushtruarit të disiplinave të nevojshme për t'u përjekur të kuptojmë atë që thotë me të vërtetë Perëndia në faqet e Shkrimit. (Ka pa dyshim, edhe arsye të tjera për pjesën tjetër të 'një teologjie të keqe'.)

Një pjesë e mirë e vlerës së studimit tonë personal të Biblës do të varet nga kjo gjë. A jemi me të vërtetë të përgatitur për të punuar për

këtë? A jemi ne të gatshëm për të hequr qafe çdo ide të çmendur të të kuptuarit e Biblës është diçka që vjen pa përpjekje - ajo vjen vetë, siç vjen për shembull një rrufë? A jemi me të vërtetë të gatshëm për të qenë *punëtorë* në studimin tonë personal të Biblës?

Nëse po, atëherë hapi tjetër që duhet të bëjmë është të përpiqemi të vlerësojmë disa nga parimet që duhen ndjekur në leximin e Biblës.

Parime të Interpretimit

Në faqet në vazhdim, do të mbulojmë disa parime themelore dhe të rëndësishme, por në përgjithësi i pari është një parim të cilin duhet ta kemi gjithmonë në ballin e mendjes.

Leximi i Shkrimit në Mënyrë të Fjalëpërfjalshme

Shkrimi duhet të interpretohet ‘ashtu siç lexohet’. Rrëfimet e vjetra të kishës u përpoqën, me të drejtë, të theksonin se ‘kuptimit i Shkrimit është një’ (*Rrëfimi i Besimit të Uestminsterit*, I:ix). Me këtë ata kuptonin që kur zbulojmë atë çka thotë në të vërtetë një tekst apo pasazh i Biblës, ne kemi zbuluar kuptimin e tij të *vetëm*. Natyrisht që *zbatimet* e kuptimit të tij mund të jenë të ndryshme. Ne mund ta kapim kuptimin e tij më pak qartë a më qartë në lidhje me kontekstin e tij dhe me pjesë të tjera të Shkrimit. Por, çështja është se Shkrimi nuk ka kuptime ‘shpirtërore’ të veçanta të cilat mund të zgjidhen vetëm duke lënë mënjanë kuptimin e qartë historik dhe gramatik të asaj që thuhet.

Këtë pikë kemi për ta vlerësuar më mirë nëse pranojmë se kuptime dhe interpretime ‘shpirtërore’ të tilla nuk i kanë rrënjët në të menduarit biblik. Ato i përkasin botës së filozofisë dhe fesë greke. Kur lexojmë Letrat e Dhياتës së Re kuptojmë menjëherë se një nga mësimet e gënjeshtërtat që po pushtonin kishën ishte doktrina embrionale e Gnostikëve se ka ‘sekrete’ që mund t’i ‘kuptojnë’ vetëm të pranuarit. Ka interpretime që janë ‘shpirtërore’. (Në 2 Thes. 2:2, duket se disa njerëz ‘e spiritualizonin’ mësimin e Palit për ringjalljen e përgjithshme, dhe këmbëngulnin se ajo tashmë kishte ndodhur. S’ka dyshim që ka patur disa të krishterë të cilët mendonin se ishin ‘shpirtërorë’ dhe që ushqenin ide të ngjashme.)

Për këto gabime, ka patur një sërë arsyes. Njëra ishte pikëpamja filozofike greke e cila pretendonte se gjërat materiale janë të këqija në

vetvete (që këtu Kol. 2:21). Interpretimet e thjeshta dhe materiale të mësimit të Shkrimit do të ishin atëherë shumë inferiore ndaj atyre që gjithçka e lidhnin me botën jomateriale të shpirtit! Për më tepër, në librat e fesë greke kishte shumë elemente fantastike. Si rezultat, njerëzit sado pak të ndershëm e panë besimin në historicitetin e ‘miteve’ të mëdha (siç i quajmë ne sot) si të pamundur. Si pasojë, ata i ‘çmitologjizuan’, dhe i kuptuan ato më shumë në terma shpirtërorë sesa si të fjalëpërfjalshme. Kur të krishterët që rridhnin nga një kulturë e tillë filluan të studiojnë Biblën, ata sollën me vete këtë lloj metode bazë dhe disa prej këtyre presupozimeve. Ata filluan të kërkojnë më shumë kuptimet e fshehura sesa ato të hapura në Dhiatën e Re.

Shpejt, u bë një gjë e zakonshme kërkimi i disa kuptimeve të ndryshme brenda një pasazhi të caktuar të Shkrimit. Shpesh këto klasifikoheshin.

I pari ishte kuptimi *historik* apo *i fjalëpërfjalshëm* - ajo çka thoshte pasazhi kur kuptohet nga rregullat e zakonshme të gramatikës. Kjo, siç e kemi përmendur tashmë, konsiderohej si e një rëndësie të dorës së dytë.

I dyti ishte kuptimi *moral*, ngadonjëherë i quajtur edhe *tropologjik* - çfarë kishte ai për të mësuar për gjërat praktike të jetës së krishterë?

I treti vinte kuptimi *alegorik*. Alegoria është një rrëfim në të cilin detajet e historisë kanë një domethënie të ndryshme nga kuptimi i fjalëpërfjalshëm i tyre. *Rruga e Shtegtarit* është një alegori. Qyteti qiellor është qartësisht parajsa; qyteti i shkatërrimit është kjo botë; barra në kurrizin e Shtegtarit është faji për mëkatin e tij, dhe kështu me radhë. Gjëja që të habit më shumë rreth interpretimit alegorik në mënyrën sesi u përdor ai në kishën e atëhershme (dhe ende përdoret), është se ajo është e prirur që detajet e rrëfimit t’i kthejë në deklarata doktrinale. Prandaj dhe disa që kanë përqafuar një interpretim alegorik të shëmbëlltyrave (të cilat zakonisht kanë vetëm një ose dy pika krahasimi, dhe jo shumë si në rastin e alegorive) kanë patur një vështirësi të madhe në shëmbëlltyrën e djalit plangprishës, dhe kanë dashur nganjëherë të gjejnë një sistem flijimi në therjen e viçit të majmë prej babait!

Kuptimi i katërt njëhej si ai *analogjik*, që ishte i lidhur ngushtë me atë alegorik, dhe nxori domethënie të pasazhit për shtegtimin qiellor.

Duhet thënë se disa prej kuptimeve të nxjerra në mënyrë të tillë prej ndonjë pasazhi të Shkrimit mund të jenë të dobishme. Disa nga doktrinat që shtjelloheshin ishin të vërteta dhe biblike. Por efekti shkatërrimtar i gjithë kësaj skeme të të kuptuarit të Biblës ishte se shpesh

ajo nxori kuptime të cilat thjesht nuk ekzistonin në tekst. Ajo e bëri fjalën e Perëndisë të thoshte gjëra që ajo nuk thoshte (ngadonjëherë duke e bërë Biblën vetë të dukej absurde). Për më tepër, ajo deklaroi gjëra që ishin doktrina të vërteta biblike, por të cilat, fatkeqësisht, nuk ishin **nxjerrë nga** teksti nën vëzhgim. Besimi atëherë ishte në rrezik të qëndronte mbi rërën lëvizëse! Nëse ju besoni diçka në bazë të një teksti, dhe ai tekst ju tregohet se ka një kuptim plotësisht tjetër, ju liheni pa asnjë themel të fortë për bindjet apo kredon tuaj.

Ky sistem interpretimi nuk mund të kontrollohet. Kur shfaqen alegoria dhe spiritualizimi, interpretimet shumëfishohen! Në këto gjëra mishi për njërin mund të bëhet helm për tjetrin dhe kështu u provua se u bë.

Kjo pikë është kaq shumë e rëndësishme sa që ia vlen të marrim kohë për ta parë të ilustruar. Ja sesi e kuptoi teologu i madh i hershëm Origeni (185-254) shëmbëlltyrën e Samaritanit të Mirë.

Njeriu që udhëton nga Jeruzalemi për në Jeriko është Adami. Jeruzalemi (natyrisht) përfaqëson paraajsën. Jeriko (natyrisht) përfaqëson botën. Hajdutët që iu hodhën atij janë djalli dhe të dërguarit e tij. Prifti që kalon aty pranë është Ligji; leviti përfaqëson profetët. Ata nuk mund ta shpëtojnë njeriun. Por atëherë vjen Samaritani i Mirë. Ky është vetë Krishti. Ai e vë njeriun mbi kafshën e tij, duke përfaqësuar trupin e Krishtit në të cilin ai mbart mëkatet tona. Hani në të cilin strehohet njeriu është kisha; dy dinarët përfaqësojnë Atin dhe Birin. Premtimi për kthimin e tij përfaqëson ardhjen e dytë të Krishtit. Tani, kush mund të gjykojë midis këtij interpretimi dhe sugjerimeve të tjera të bëra në ato ditë dhe më vonë, se kafsha është Fryma e Shenjtë, se hanxhiu është apostulli Pal (!), dhe se dy dinarët përfaqësojnë ose dy urdhërimet për dashurinë, ose, ndoshta, sakramentet?

Shumë mendjeshkathët, po. Megjithatë mesazhi i vërtetë i shëmbëlltyrës nuk është të mësojë një sistem doktrine, por të sfidojë mënyrën e jetesës së dëgjuesit; t'ia kthejë pyetjen e tij (***Kush është i afërmi im?***) vetë atij, duke pyetur ***Cili... qe i afërmi?***, dhe duke marrë përgjigjen e drejtë, të qëllojë drejt e në shenjë me zbatimin: ***Shko dhe bëj kështu edhe ti!***

Por le t'u kthehemi dy shembujve të mëparshëm për të parë se si edhe historitë e Rahabit dhe Mefiboshethit kanë pësuar një fat të njëjtë. Pamë se mesazhet që nxirreshin prej tyre ishin një shtrembërim i kuptimit të tyre të saktë. Tani duhet të jemi në gjendje edhe të shohim arsyen për këtë. Këmbëngulja që kuptimi i qartë i pasazhit duhet t'i hapë udhë një

interpretimi 'shpirtëror' i cili përfshin gjithë mesazhin e Ungjillit në të, është e gabuar. Në thelb, ajo është një refuzim për të marrë seriozisht fjalët me të cilat hapet Letra drejtuar Hebrenjve, se Perëndia e ka shfaqur veten e tij në mënyra *të ndryshme* dhe në kohë *të ndryshme*.

Kur vetë Perëndia ka shpjeguar se ai nuk e zbuloi plotësisht veten e tij në kohët e hershme, është një gabim i madh të përpiqesh për të kërkuar një zbuluesë të tillë të plotë. Thjesht nuk është kurrë e tepërt të thuhet se çelësi për të kuptuar Shkrimin është ta kuptosh atë 'fjalë për fjalë'.

Por, ndoshta, nuk ka asnjë deklaram tjetër që të jetë më i prirur për abuzim dhe keqkuptim sesa ky! Ç'do të thotë ta interpretosh Biblën në mënyrë të drejtpërdrejtë? Në thelb, kjo do të thotë që ta lexosh Biblën me një ndjeshmëri ndaj stilit gramatik apo atij letrar, si dhe ndaj qëllimit dhe përmbajtjes së saj doktrinale.

Është shumë e rëndësishme që ne të dallojmë interpretimin e 'fjalëpërfjalshëm' të Biblës (d.m.th., marrjen e fjalëve dhe thënieve në kuptimin e tyre të zakonshëm brenda kontekstit) nga ai që ne mund ta quajmë 'literalist' (d.m.th., marrjen e fjalëve në kuptimin e tyre të zakonshëm, pavarësisht nëse ai kuptim është i përshtatshëm apo jo). Qëllimi ynë në studimin personal të Biblës, në fund të fundit, është të kuptojmë dhe të vëmë në praktikë atë që thotë me të vërtetë Bibla, dhe jo atë që ne mendojmë se duhet të kishte thënë!

Por, pohimet tona të forta se Shkrimi është fjala e shkruar e Perëndisë do të vlejné shumë pak nëse jemi të papërgatitur për t'u përpjekur që të dëgjojmë atë që thotë ai. Nganjëherë, ne e brumosim dhe e përdredhim atë për ta bërë të thotë atë që duam ne që të thotë, dhe atë që u përshtatet paragjykimëve tona (po, madje edhe sistemeve tona teologjike!). Ta kuptosh Biblën në mënyrë të drejtpërdrejtë, pra, nuk do të thotë të këmbëngulësh që në qiell ka krijesa me tipare të paimagjinueshme dhe të pamundura (si te Zbulesa), por të kuptosh qëllimin e shkruarit, llojin e literaturës që po shkruante, dhe qëllimin e përgjithshëm të librit që shkroi ai. Kështu, në rastin e Zbulesës ne kuptojmë se rasti më i ngjashëm që kemi janë ndoshta skicat dhe karikaturat vizatimore të shkëlqyera që shfaqen në gazetatat tona të përditshme. Zbulesa nuk është një hartë kartografike e qiellit, por një seri ilustrimesh më të gjera se jeta - skicash vizatimore, nëse ju pëlqen t'i mendoni kështu - që shfaqin pushtetin dhe fitoren e Perëndisë ndaj gjithë forcave të këqija. Nëse dështojmë për ta kuptuar këtë, do të dështojmë për të kuptuar gjithë librin.

Kur i afrohem Biblës ashtu siç duhet, një botë e tërë studimi ngjethës, në mos dhe energjik, hapet para nesh. Fjalën e Perëndisë nuk e

konsiderojmë më si një ‘kuti premtimesh’ duke shpresuar se ndonjë varg, ose frazë e vetme, do kërcejë prej faqes dhe do të na godasë ndër sy. Ne e konsiderojmë atë si një libër të cilin Perëndia na e ka dhënë në dashurinë e tij për ta *studiuar*. Në të ka gjëra të vështira për t’u kuptuar (2 Pjet. 3:16). Do të kemi shumë punë për t’u kapur me të. Nganjëherë, unë e mendoj studentin e Biblës si një qen që mban një kockë ndër dhëmbë derisa të ketë përtypur prej saj çdo grimë gjëje të mirë! Qëllimi i leximit tonë të përditshëm nuk është thjesht që të na ndihmojë për të reflektuar mbi gjendjen tonë shpirtërore, por për të dëgjuar atë që ka për të thënë Perëndia. Perëndia do që ne të përleshemi me të vërtetat e mëdha të Shkrimit sepse ato të ndryshojnë jetën. Qëllimi ynë është të kemi një njohje intime me mendjen e Perëndisë sikurse ai e ka zbuluar atë në urdhrat dhe premtimet e tij. Ndërsa i shohim këto të ilustruara në jetën e shenjtoreve të Biblës dhe mbi të gjitha në Jezusin, ne fillojmë të zbulojmë vullnetin e tij në çdo gjendje dhe situatë të jetës. Ky lloj përjetimi mund të arrihet vetëm nëse ne jemi të përgatitur që të punojmë për të kuptuar se çfarë është mesazhi i Biblës në të vërtetë. Sa shumë nevojë kemi që të dëgjojmë në këtë çështje qortimin e lashtë: ‘Shko te milingona, o përtac, dhe ver re mënyrën se si ajo mbledh ushqim’ (Fjalët e Urta 6:6-11)!

Leximi i Shkrimit në kontekst

Çdo fjalë duhet parë në vargun e saj, çdo varg në kontekstin e tij, çdo kontekst në kapitullin e tij, çdo kapitull në librin e tij, çdo libër në kontekstin e shkrimeve të tjetra të autorit të tij, çdo autor në Dhiatën e tij, dhe çdo Dhiatë në kontekstin e tjetrës.

Kur veprojmë kështu, shumë gjëra fillojnë të qartësohen. Për shembull, nuk na duket e vështirë për të kuptuar se përse duket të ketë një tension midis mësimi të Palit mbi besimin dhe veprat dhe mësimi të Letrës së Jakobit. Ne fillojmë të kuptojmë se këta dy shkrues po përdorin shprehje të ngjashme, por në njëfarë kuptimi të ndryshëm, dhe me qëllime fare të ndryshme. Përsëri, kuptojmë se kur Pali përdor fjalën ‘ligj’ ai nënkupton me të një llojshmëri gjërash të ndryshme. Nëse zbatojmë parimin se e njëjta fjalë në të njëjtin lloj konteksti normalisht nënkupton të njëjtën gjë, shpejt kemi për të zbuluar domethënien e përdorimeve të saj të ndryshme. Kështu, për shembull, gjejmë se Pali përdor fjalën ‘ligj’ kur ai nënkupton (a) Dhiatën e Vjetër (Rom. 3:19), (b) një pjesë të Dhiatës së Vjetër (Rom. 3:21), (c) administrimin Mozaik (Rom. 5:13, 20), (d)

vullnetin normativ të Perëndisë (Rom. 3:20; 4:15; 7:2, 5, 7, 8, 9, 12, 16, 22), (e) një parim që vepron në jetën e njerëzve (Rom. 3:27; 7:21, 23, 25). Në mënyrë të ngjashme gjejmë se fjala ‘mish’ mund të ketë kuptimin e ekzistencës së zakonshme fizike (p.sh., Efes. 2:15) ose natyrën njerëzore si të njollosur dhe të ndotur nga mëkati (Efes. 2:3). Nuk ka nevojë të vihet në dukje se dallimi midis këtyre dy kuptimeve është shumë domethënës, dhe ngatërrimi i tyre mund të na çonte lehtë në rrugë të gabuar përsa i përket të kuptuarit të mësimit biblik.

Kur marrim këtë lloj konsiderimi, një nga gjërat që zbulojmë është se konteksti në të cilin është vënë një pasazh, shpesh na ndihmon si për ta kuptuar, *ashtu e dhe* për ta zbatuar atë praktikisht. Sepse vetë Bibla është një libër për njerëzit të cilët menduan për Perëndinë, jetuan për Të dhe u munduan ta vënë fjalën e tij në praktikë. Ajo është një libër thellësisht baritor (pastoral, udhëheqës), i paracaktuar për të na udhëhequr në njohurinë e Perëndisë dhe bindjen ndaj vullnetit të tij, ***i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi*** (2 Tim. 3:16). Ne gjejmë ndihmë për mënyrën se si duhet që ajo të aplikohet pothuajse në çdo faqe.

Leximi i Shkrimit Sipas Karakterit Letrar të tij

Duhet që të kemi gjithmonë parasysh llojin e literaturës që po lexojmë. Nëse librin e Zbulesës e lexojmë sikur ai të ishte një histori e shkruar që më parë, kemi për ta keqkuptuar mesazhin e tij. Dhe ka shumë mundësi që të ndërtojmë prej tij mësim të cilat nuk janë të përputhshme me pjesën tjetër të Shkrimit. Zbulesa është një libër pikturash, jo një libër që përshkruan përmbledhtas të ardhmen e historisë botërore - sado zhgënjyese që të na duket kjo gjë!

Interpretimi i Psalmeve

Merrni Psalmet për shembull. Kur i lexojmë, ne zbulojmë se ato janë të mbushura me ato që ne i quajmë ‘paralelizma’: një frazë shpjegohet në frazën që vijon. Një vlerësim i kësaj, dhe zhvillimet që jepen nganjëherë me anë të shpjegimit, nganjëherë me anë të kontrastit, na ndihmojnë për të kapur thelbin dhe frymën e këtyre shkrimeve poetike. Dhe ato janë poetike. Kjo do të thotë se psalmisti përdor figura të ndryshme të ligjëratës. Ai nuk flet gjithmonë, si të thuash, për ‘fakte të zhveshura’. Si rrjedhojë, ne gjithmonë kemi për të pyetur veten nëse ai ka për qëllim që diçka të

kuptohet në mënyrë të fjalëpërfjalshme, apo ndoshta frymërisht, pra, poetikisht.

Shfaqja e fjalës ‘frymërisht’ në fjalinë e fundit mund t’ju habisë! Në fund të fundit, unë kam qenë duke thënë se ne nuk duhet të ‘spiritualizojmë’ kur interpretojmë Shkrimin. Kurse tani po them se psalmistët nganjëherë e bënin këtë gjë!

Por thelbi i asaj që unë kam thënë më përpara është se spiritualizimi si një parim fiks është i gabuar. Por gjithashtu, është njëlloj e gabuar të mos kuptojmë kur një shkruar po flet për një realitet shpirtëror dhe jo të fjalëpërfjalshëm. Ja një parim konstant: ne duhet të përpiqemi që të kuptojmë qëllimin e shkruarit, me qëllim që të kuptojmë mesazhin e tij. Kështu, në Psalmet, nëse tregohet ndonjë situatë historike (p.sh., konteksti i përgjithshëm i 2 Sam. 11, 12 në rastin e Psalmi 51), ai kontekst do të ndikojë në mënyrën me të cilën ne kuptojmë thëniet që janë bërë. Nëse përshkruhet një gjendje shpirtërore (për shembull si në titullin e Psalmi 102) atëherë kemi për ta marrë parasysh këtë gjatë studimit të pasazhit. Këto dhe çelësa të tjerë do të na ndihmojnë, nëpërmjet një leximi të kujdesshëm dhe plot lutje, për të vlerësuar mesazhin që po transmeton psalmisti.

Ne kemi për të vënë re, në këtë mënyrë, një gjë shumë të rëndësishme për të mbajtur mend gjatë leximit të Psalmeve. Meqenëse ato regjistrojnë përjetimin njerëzor, gjendjet mendore personale dhe subjektive, ndonëse të gjitha Psalmet janë të frymëzuara, jo gjithçka që është thënë në to është me domosdo një thënie e vërtetë.

E kuptoj se disa lexues të cilët priren ta spiritualizojnë Shkrimin, dhe që gjithashtu besojnë në pagabueshmërinë e Biblës mund të tundohen në këtë pikë për ta hedhur librin, të dëshpëruar, në shenjë mosaprovimi! Shkrimi është i pagabueshëm. Shkrimi është i frymëzuar. Por kjo nuk do të thotë se çdo thënie në Shkrim, pavarësisht nga konteksti, të jetë një e vërtetë absolute. Fjalët e gjarprit në kopshtin e Edenit na japin një shembull të qartë. Ai e siguroi Evën se, pavarësisht nga ajo që kishte thënë Perëndia, ata nuk do të vdisnin (Zan. 3:4). Nëse i kuptojmë këto fjalë (të cilat janë pjesë e fjalës së frymëzuar dhe të pagabueshme të Perëndisë) në kontekstin e tyre të vërtetë, kemi për të arritur në konkluzionin se ato janë të gënjeshtërtë. Këto fjalë ishin një mashtrim! Kjo nuk duhet që të na trondisë aspak. Nuk është Satani që është i frymëzuar, as fjalët e tij, por regjistrimi që na ka dhënë Perëndia. Ky nuk ka për të na lënë në baltë. Por ne po e lëmë në baltë atë, dhe nuk arrijmë ta kuptojmë atë, nëse mendojmë se

nga që fjalët shfaqen në Bibël, ato janë të vërteta, në çfarëdolloj konteksti që të jenë. Ky është një parim shumë i rëndësishëm në Psalmet, dhe duhet të na mjaftojnë një ose dy shembuj për ta treguar atë.

Në Psalmin 102, shkruesi është në një gjendje të brengosur shpirtërore. Ka shumë arsye për këtë. Siç duket, gjendja e kombit ishte shumë e keqe - ai flet për gurët dhe pluhurin në Jeruzalem, dhe duket se po shpreson për ditën kur ai të ndërtohet përsëri (vargjet 14, 16); ai vetë ishte në një nevojë të madhe, fizikisht dhe psikologjikisht. Por në mes të Psalmit, ai thotë: ***më ngrite dhe më hodhe larg*** (v. 10). Kjo ndjenjë është e natyrshme; ne mund ta kemi ndier atë edhe vetë në njëfarë mase. Por a ishte e vërtetë? A e bën Zoti këtë gjë? Përgjigjja duhet të jetë sigurisht 'jo'. Mendja e njeriut ishte e turbullt, perceptimi i tij për Perëndinë dhe realitetin ishte shtrembër. Nevoja e tij e madhe ishte që të kishte një vlerësim të duhur të natyrës së Perëndisë - dhe kjo është pikërisht ajo që fillon të ndodhë në Psalm (që nga vargu 12 dhe tutje). Megjithatë, vetëm kur shohim se psalmisti jep një përshkrim të shtrembëruar të Perëndisë, mund të fillojmë ta kuptojmë terapinë shpirtërore që Perëndia i dha atij.

Një situatë të ngjashme e gjejmë në Psalmin 89. Ky është Psalmi i besëlidhjes me Davidin (v. 3, 28, 34 etj.). Por ankimi i shkrimtarit është: ***Ti ke përçmuar besëlidhjen e lidhur me shërbëtorin tënd dhe ke përdhosur kurorën e tij, duke bërë që të bjerë për tokë*** (v. 39). Ja një pikë kritike në përjetimin e psalmistit. Ai po e akuzon Perëndinë për mosbesnikëri! Pyetja është: A nuk i kishte qëndruar besnik besëlidhjes Perëndia? A është ndonjëherë Perëndia jobesnik ndaj besëlidhjes? Përgjigjja jonë ndaj këtyre pyetjeve do të përcaktojë se si e interpretojmë ne gjendjen shpirtërore të shkruesit.

Do të nevojitej një libër për t'u marrë me të gjitha parimet që nevojiten për të kuptuar siç duhet mesazhin e Shkrimit. Qëllimi i këtij libri nuk është që ta bëjë këtë detyrë të duket jashtë fuqive të lexuesve të zakonshëm të Biblës! Nuk është. Në fakt, shumica prej nesh i kap këto parime gjatë leximit të Biblës, dhe jo gjatë një kursi mbi parimet e interpretimit biblik! Por ka dy zona të tjera në të cilat mund të jetë e dobishme të tregohen disa nga parimet bazë të interpretimit të Shkrimit.

Interpretimi i Profetëve

Profecia është një zonë famëkeqe për interpretime të çuditshme. Por ka një numër parimesh të qarta të cilat do të na ndihmojnë për të

lundruar në një shteg të drejtë përmes shumë prej vështirësive që mund të ndeshim.

Ka dy aspekte për idenë e profecisë në Shkrim. Njëri është, sigurisht, ideja e zakonshme e parathënies së së ardhmes. Ka shumë shembuj të kësaj në Dhiatën e Vjetër, që parashikojnë historinë e njerëzve nën Besëlidhjen e Vjetër, dhe që tregojnë drejt ardhjes së Krishtit dhe themelimit të Besëlidhjes së Re. Ka gjithashtu një numër profecish në Dhiatën e Re, nga goja e Jezusit dhe apostujve, dhe gjithashtu, edhe prej të tjerëve si p.sh., Agabi për të cilin lexojmë në Veprat e Apostujve. Por, në raport, vetëm një pjesë relativisht e vogël e gjithë profecisë biblike është një parathënie për ngjarjet e largëta të së ardhmes. Në fakt, profecia biblike ka, në përgjithësi, karakter 'përpara-thënës' sesa parathënës. Madje edhe kur është parathënës, ai zakonisht ka në pamje si situatën e ardhme ashtu dhe atë bashkëkohore.

Profecia biblike është zakonisht një shtjellim ose dhe një thirrje për t'iu kthyer, parimeve të mëdha të besimit dhe jetës që i kanë rrënjët e tyre në besëlidhjen e Perëndisë. Ajo është pa përjashtim ose një njoftim i besnikërisë së Perëndisë ndaj premtimeve, ose thirrje për një përkushtim të ri të bijve të tij ndaj tyre.

Si rrjedhojë, kur lexojmë profeci, duhet të kemi parasysh tri gjëra.

Së pari, ajo është e lidhur me ngjarjet e historisë së kohës. Për t'iu kuptuar, ajo duhet të shihet kundrejt këtij sfondi. Pyetja e parë që duhet të pyesim është: Çfarë thoshte pasazhi, dhe çfarë kishte për qëllim të bënte, për situatën në të cilën u tha apo u shkrua për herë të parë?

Së dyti, profecia është ngadonjëherë e kushtëzuar (p.sh., Jer. 26:17 e sipër; 1 Mbret. 21:17 e sipër; Jona 3:4). Në disa raste ajo është një thirrje për t'iu kthyer fjalës së Perëndisë, që nëse injorohet, do të lëshojë gjykimin e premtuar të Perëndisë, por nëse i bindemi mund të hapë dritaret e qiellit dhe të sjellë bekim të madh për popullin e Perëndisë (krah. Mal. 3:10-12).

Së treti, profetët, në mënyrë të pashmangshme, e veshën mesimin e tyre me format e mendimit dhe ideve të kohës së tyre. Përndryshe, ajo që thanë ata do të kishte qenë plotësisht e pakuptueshme. Përshkrimi i tyre për atë që Perëndia do të sillte në të ardhmen u shpreh në mënyrë të pashmangshme në termat e traditave kulturore dhe fetare nën të cilat jetuan. Për këtë arsye është si legjitime ashtu edhe e domosdoshme që t'i kuptojmë shumë prej thënieve të tyre në termat e mënyrave me të cilat vetë Dhiata e Re i shikon si të plotësuar. Një shembull i qartë i kësaj është Amosi 9:11, 12, i cili flet për qëllimin e ardhshëm të Perëndisë:

*'Atë ditë do të ngre përsëri
tabernakullin e Davidit që ka rënë,
do të ndreq të çarat e tij
dhe do të ngre rrënojat e tij,
dhe do ta rindërtoj si në ditët e lashta,
me qëllim që të zotërojnë kusurin e Edomit
dhe tërë kombet ku i bëjnë thirrje emrit tim,'
thotë Zoti që do ta bëjë këtë.*

Në pamje të parë këto fjalë kanë një kuptim të qartë. Ato duken t'i referohen restaurimit kombëtar, madje fizik të Jeruzalemit, dhe një programi të një zgjerimi dhe begatie kombëtare. Shumë të krishterë besojnë se Perëndia ka ende një qëllim të ardhshëm për popullin çifut, dhe për tokën e Izraelit. Është e natyrshme për ta që këto fjalë t'i kuptojnë në lidhje me atë periudhë të ardhme. Por nëse kjo është mënyra me të cilën ne i interpretojmë fjalët e Amosit, kemi humbur një hallkë jetike në procesin e interpretimit. Ne kemi harruar të kuptuarit e këtij pasazhi prej Dhiatës së Re.

Kur u mblodh këshilli i Jeruzalemit, në Vep. 15, dhe u dëgjua kërkesa e Pjetrit për ungjillizimin e johebrenjve, ky pasazh u citua si një faktor vendimtar në vendimin që u arrit. Jakobi deklaroi se ungjillizimi i johebrenjve ishte në përputhje me fjalët e profecisë së vjetër. Mënyra e të kuptuarit apostolike të këtyre vargjeve ishte se ato nuk i referoheshin ndonjë mbledhjeje sëbashku të ardhshëm të çifutëve, por mbledhjes pas-Pentakostale të johebrenjve!

Kjo nuk është të themi se Perëndia nuk mund të ketë ende një qëllim për popullin çifut apo për tokën. Kjo është vetëm për të thënë se një bindje e tillë duhet të gjejë një mbështetje diku tjetër në Shkrim nëse duhet mbajtur. Në këtë pasazh të veçantë nuk flitet për këtë. Ajo që ishte e qartë në përdorimin e Amosit prej Jakobit ishte se ai ia aplikoi thënien e profetit kishës, dhe begatisë së dukshme të mbretërisë shpirtërore të Perëndisë - jo kombit të jashtëm, fizik të Izraelit. Meqë në kohën e Amosit kombi dhe kisha ishin, teorikisht, dy anët e së njëjtës medaljeje, profeti në mënyrë të pashmangshme u shpreh në një gjuhë që mund t'i aplikohet ose kombit fizik ose mbretërisë shpirtërore. Kurdoherë, pra, që kemi për të parë Dhiatën e Re duke përdorur profecinë e Dhiatës së Vjetër, kemi për të qenë të aftë për ta interpretuar Biblën me ndjeshmëri vetëm nëse i kushtojmë kujdes mënyrës me të cilën kuptohet profecia e Dhiatës së Vjetër.

Interpretimi i shëmbëlltyrave

Interpretimi i shëmbëlltyrave, të cilat formojnë një pjesë mjaft të madhe të shërbimit të folur të Jezusit, është gjithashtu një vend gjuetie shumë i prirur për keqkuptime. Rreziku i madh është se **ne** japim kaq shumë energji për të interpretuar detajet e shëmbëlltyrës saqë dështojmë për të marrë seriozisht ‘pikën e thumbit’ me të cilën shumë prej tyre arrijnë pikën kulmore.

Qëllimi i shëmbëlltyrave nuk është që ato të lexohen sikur të ishin alegori në të cilat çdo tipar i historisë ka një paralel një-për-një me botën e shpirtit. Shumica e detajeve janë caktuar për ‘të vënë skenën’, për të përçuar atmosferën e përgjithshme në të cilën mesazhi i shëmbëlltyrës do ta godasë dëgjuesin në shenjë me një fuqi bindëse. Nëse e ngatërrojmë çështjen duke vlarë mendjen mbi kuptimin e detajeve, kemi për ta gjetur veten mes atyre që ***duke parë nuk shohin, dhe duke dëgjuar nuk dëgjojnë*** (Mat. 13:13).

Mund të pranojmë si rregull të përgjithshme se çdo shëmbëlltyrë ka një pikë kryesore. Në disa prej tyre, ajo mund të bëhet në mënyra të ndryshme, kështu që e njëjta pikë e përgjithshme u aplikohet klasave të ndryshme dëgjuesish. Por normalisht, në një shëmbëlltyrë do të ketë një mesazh karakteristik.

Me këtë në mendje, në leximin e tyre ka dy gjëra që duhet të kërkojmë.

E para, qëllimi i shëmbëlltyrës. Çfarë po thotë ajo në përgjithësi? Ne mund të ndihmohemi në mënyra të ndryshme për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje. Ngadonjëherë përmendet situata në të cilën u tha shëmbëlltyra. Samaritani i Mirë është një shembull i përkryer për këtë rast. Te Lluca 10, Jezusi po diskuton me një mësues të ligjit për rrugën drejt jetës së përjetshme. Jezusi filloi ta godasë në shenjë ndërgjegjen e tij me fjalën e Perëndisë, ***Por ai, duke dashur të justifikonte veten, i tha Jezusit: “Po kush është i afërmi im?”*** Shmangja e tij prej grushtit në ndërgjegje solli historinë e njeriut që udhëtoi nga Jeruzalemi për në Jeriko.

Historia e Jezusit i foli ndërgjegjes së tij. Ajo nuk ishte vetëm ‘një histori tokësore me kuptim qiellor’. Në fakt, ajo kishte një kuptim me të vërtetë shumë tokësor. Por kuptimi nuk ishte ‘bëji të mirë të afërmit tënd’. Në gojën e Jezusit ajo ishte një shfaqje e zemrës së njeriut, një heqje e vetëshfajësimit të tij, një akuzë kundër jashtëmërisë së besimit fetar të kohës. Mbi të gjitha shëmbëlltyra ishte një e flakur tutje e mekanizmave

mbrojtëse të doktorit të ligjit. Pyetja e tij kishte qenë ***Kush është i afërmim?*** Përgjigjja e Jezusit, në thelb, ishte: ‘Nuk është kjo pyetja. Pyetja është “Kujt do t’i jesh i afërm?” Nuk mund të thuash, “Ka disa njerëz të cilët jam i detyruar t’i ndihmoj ngaqë i kam të afërm.” Ti mund të thuash vetëm, “Prej hirit të Perëndisë unë jam një i afërm, dhe do ta provoj që jam i tillë kudo që ka nevojë.”’ Në vend që t’i kufizojmë detyrimet tona ndaj disa njerëzve në nevojë, shëmbëlltyra na parashtrojnë një detyrim i cili është i pakufizuar në natyrën e tij.

Në disa raste të tjera, qëllimi i shëmbëlltyrës bëhet i qartë: ***Pastaj u tha atyre edhe një shëmbëlltyrë, për të treguar se duhet të lutemi vazhdimisht pa u lodhur*** (Lluka 18:1). Këtu na nevojitet vetëm të lexojmë çfarë thuhet për të ditur se cila ka për të qenë thelbin e përgjithshme e shëmbëlltyrës.

Ka raste kur thelbi i shëmbëlltyrës shprehet në fjalët mbyllëse. Jezusi e mbyll historinë e Mikut në Mesnatë me këto fjalë, duke treguar thelbin e shëmbëlltyrës: ***Prandaj po ju them: Lypni dhe do t’ju jepet; kërkoni dhe do të gjeni; trokitni dhe do t’ju hapet*** (Lluka 11:9). Në mënyrë të ngjashme, mesazhi i Pasanikut të Pamend tejçohet në këta terma solemnë: ***Kështu i ndodh atij që grumbullon thesare për vete dhe nuk është i pasur ndaj Perëndisë*** (Lluka 12:21). Kur vërejmë një ose më shumë prej këtyre aluzioneve gjatë leximit të një shëmbëlltyre, jemi në rrugën e mbarë për të vlerësuar pikën që po bëhet përgjatë saj. Kjo do të na ndihmojë për së mbari për të vlerësuar gjithë historinë.

Gjëja e dytë që duhet të vërehet në një shëmbëlltyrë është pika e krahasimit. Shumë shëmbëlltyra janë përshkruar qartësisht si ‘shëmbëlltyrat e mbretërisë’. Ato fillojnë me fjalët, ***Mbretëria e Perëndisë është si....*** Gjatë leximit të tyre duhet të bëjmë pyetjen: Çfarë është pikërisht pika e krahasimit? Ajo mund të jetë mënyra në të cilën themelohet mbretëria. Mund të jetë një ilustrim i parimeve që duhet të ndiqen në jetën e mbretërisë - përkushtimi, këmbëngulja në lutje, durimi, guximi, urtësia, ose ndonjë cilësi tjetër etike ose shpirtërore. Ajo mund të jetë çështja e vendimit personal që na parashtrohet prej tregimit.

Shumë shpesh, thelbi i shëmbëlltyrës është diçka e tillë: mbretëria e Perëndisë vepron në *këtë* mënyrë - siç është ilustruar në shëmbëlltyrë - tani, cila do të jetë përgjigjja jote? A do të jetë ajo si njeriu i shëmbëlltyrës? A ka për të qenë si njeriu i parë i shëmbëlltyrës, apo si i dyti? (Kur bëhet ndonjë krahasim.) Kjo është ilustruar shkoqur në shëmbëlltyrën që ne e quajmë zakonisht Djali Plangprishës. Kohët e fundit ajo është bërë e

njohur, ndoshta në mënyrë më të saktë, si Dy Bijtë ose Ati në Pritje. Nëse atë nuk e lexojmë deri në fund dhe nuk e marrim parasysh situatën e vëllait të madh, kemi për të humbur thelbin e historisë. Zoti ynë e tregoi këtë dhe dy shëmbëlltyra të tjera si pasojë e ankesave të farisenjve që ai po i mirëpriste mëkatarët (Lluka 15:1 e sipër). Rimëkëmbja e vëllait të vogël prej hirit të atit, dhe refuzimi i vëllait të madh për të marrë pjesë në festë kanë për qëllim që t'i bëjnë dëgjuesit (dhe lexuesit) të pyesin veten: 'Kush jam unë? A jam unë si mëkatari plangprishës i falur? Apo mos jam në të vërtetë si vëllai i madh, zemra e të cilit është e ftohtë kundrejt djalit plangprishës, dhe si pasojë edhe ndaj dashurisë së Perëndisë?' Shëmbëlltyrat nuk janë vetëm për të dëshmuar për punën e mbretërisë së Perëndisë, por ato kërkojnë një përgjigje ndaj kësaj force dinamike, dhe na tregojnë se cila është përgjigja jonë e tanishme.

Parimi doktrinal

Ka gjithashtu edhe një logjikë të rëndësishme që duhet të vihet re në Shkrim, e cila përsëri na ndihmon për të parë formën e mësimit biblik.

Perëndia punon mëshirshëm për njerëzit, dhe mbi këtë bazë, ai i thërret ata në besim dhe bindje. Ky kornizë bëhet veçanërisht i rëndësishëm, dhe i qartë, në Dhiatën e Re. Puna e Perëndisë gjithmonë i paraprin punës së njerëzve. Hiri i paraprin gjithnjë mirënjohjes. Gjithashtu, si rrjedhim i drejtpërdrejtë, doktrina i paraprin zbatimit në mësimin e apostujve.

Prandaj dhe, kur i kthehemi një Letre të tillë si ajo drejtuar Romakëve, apo Efesianëve, zbulojmë se pjesët 'praktike' janë thjesht lulëzimi i pjesëve doktrinale prej të cilave kanë dalë. Mësimi i thellë doktrinal kërkon zbatimin etik dhe shpirtëror. Po ashtu është mësimi doktrinal ai që i jep formën mësimi etik. Theksimi është: meqë Perëndia bëri këtë gjë (e ndjekur nga shpjegimi i disa të vërtetave), ti duhet të sillësh kështu (e ndjekur nga shtjellimi i mënyrës sesi duhet të sillen të krishterët). Kuptimi i gjithë këtyre modeleve të përgjithshme, të pasurit në mendjen tonë e një skice të drejtimit të përgjithshëm në të cilin po drejtohet shkruesi, dhe se si po e ndan ai materialin - e gjithë kjo na ndihmon për ta trajtuar fjalën e Perëndisë me kujdesin dhe nderimin që meriton.

5 Për Shembull

Një nga teknikat e të mësuarit që ka siguruar përparimi i shpejtë në teknologjinë e komunikimit është video-replay (kthimi i mesazhit të regjistruar në video). Kjo i lejon pjesëmarrësit në ngjarjet e sportit të 'flasin përmes' vetë ngjarjes në të cilën morën pjesë ata. Kështu, për shembull, një futbollist mund të përshkruajë mendimet që kishte në mendje kur u kthye dhe shënoi gol; një lojtar golfi mund të përshkruajë goditjen të cilën ai e konsideroi si pikën e kthesës në raundin e tij; një boksier mund të kujtojë momentin kur ai e kuptoi se grushtat e tij e kishin dobësuar kundërshtarin.

Ka shumë gjëra që mund të mësohen prej të tjerëve nga ky lloj ndarjeje eksperience, metodash, planesh e kështu me radhë. Kjo është e vërtetë edhe për studimin tonë të Biblës. Ne mund ta ndihmojmë shumë thjesht njëri-tjetrin duke diskutuar mënyrën se si të rrokim një pasazh apo libër. Kur i dëgjojmë të tjerët duke predikuar ose mësuar, ne mund të marrim mësim për vetë studimin tonë të Biblës duke vërejtur mënyrën se si e trajton një pasazh dikush tjetër; mënyrën se si ai ia nxjerr mësimin kryesor; dhe mënyrën sesi ai e aplikon atë. Kur dëgjojmë predikime, për shembull, ne nuk po mësojmë vetëm mësim të menjëhershme prej një pasazhi apo teksti, por shpesh në mënyrë të pavetëdijshme ne mësojmë se si (apo se si të mos!) e kryejmë vetë studimin tonë të Biblës. Në fakt, shumica prej nesh mësojnë ta studiojnë Biblën pak a shumë në të njëjtën mënyrë që i dëgjojmë të tjerët ta shtjellojnë atë.

Në këtë kapitull, unë dua të 'flas përmes' një studimi Bible me ju. Për këtë qëllim kam zgjedhur librin e Ruthit, pasi ai përmban një shembull të mirë për shumë prej parimeve të studimit brenda hapësirës së katër kapitujve të rëfimit.

Cila është rruga më e mirë që duhet të ndjekim gjatë studimit? Është gjithmonë një gjë e mirë përpjekja për të kapur shtrirjen e përgjithshme të tokës përpara se të merremi me ndonjë detaj. Kur jemi duke studiuar ndonjë libër relativisht të shkurtër, si Ruthi, këtë mund ta

bëjmë duke e lexuar atë shpejt, duke kapur atmosferën e përgjithshme, dhe duke vlerësuar drejtimin qendror në të cilin shpaloset libri. Kështu ne mund të kuptojmë rëndësinë e disa episodeve të cilat mund të na dukeshin përndryshe relativisht të pakuptimta. Pasi kemi vepruar kështu, ne jemi gati të punojmë më ngadalë përmes kapitujve.

Kapitulli Një

Cila është skena? Shpesh, për ne ky do të jetë çelësi i parë për pjesën tjetër të librit. Këtu, si në shumë libra të tjerë, fjalët hapëse japin përgjigjen: *Në kohën kur qeverisnin gjyqtarët*. Çfarë rëndësie ka kjo? Ajo na tregon se historia vendoset brenda periudhës së përshkruar në librin e mëparshëm, Gjyqtarët. Kur i kthehemi prapa atij, zbulojmë se ishte një periudhë paqëndrueshmërie të madhe. Faqja e mëparshme e Biblës na tregon se *Në atë kohë nuk kishte asnjë mbret në Izrael; secili bënte atë që i dukej e drejtë në sytë e tij* (Gjyqtarët 21:25). Gjatë gjithë librit të Gjyqtarëve ka shumë fakte të tjera të krizave që po përballonte populli i Perëndisë, dhe sa shpesh Perëndisë i është dashur t'i shpëtonte (p.sh., Gjyq. 2:16-19).

Në këtë pikë mund të mendojmë nëse ka ndonjë paralel ndërmjet atyre ditëve dhe ditëve në të cilat jetojmë ne. Me sa duket, disa libra të Shkrimit mund të duken në shikim të parë se kanë një rëndësi të veçantë për kohën dhe vendin ku jetojmë. Përveç kësaj, mund të na bëjë përshtypje se ajo që kemi në librin e Ruthit është shumë e ndryshme nga libri i Gjyqtarëve. Atje historia zhvillohet në nivel kombëtar; kurse këtu, në nivel personal dhe individual. Kjo na jep neve një çelës tjetër të mesazhit të përgjithshëm të librit. Perëndia që është i preokupuar për të themeluar popullin e tij në Gjyqtarët, është i njëjti Perëndi që është thellësisht i preokupuar për individët. Asnjë lloj peshe nevojë kombëtare nuk ia largon kurrë mendjen Perëndisë prej situatave të fëmijëve të tij, sado të parëndësishme që të duken ata, madje edhe në sytë e vetë atyre.

Këto mendime të përgjithshme do të na udhëheqin për të shqyrtuar pjesën tjetër të kapitullit të parë. Çfarë shohim këtu? Zbulojmë se megjithëse libri është quajtur Ruth, kapitulli i parë flet kryesisht për Naomin. Me qëllim që të kuptojmë jetën besimtare të Ruthit, shkruesi duket të thotë se së pari duhet të shohim jetën e Naomit. Vetëm atëherë kemi për të parë domethënien e plotë të planit të Perëndisë. Ky është një mësim si në studimin tonë të Biblës ashtu dhe në jetë!

Çfarë zbulojmë rreth Naomit? Ka disa veçori interesante për këtë, megjithëse mund të na duhet pak ndihmë përpara se t'i kemi zgjidhur të gjitha! Ajo na prezantohet në mes të një katalogu tragjedie dhe dhimbjesh (1:1-5). Vini re emrat e renditur në vargjet hapëse. Është shpeshherë një gjë e mençur përpjekja për të zbuluar kuptimin e emrave të Dhiatës së Vjetër, sepse shpesh ata kanë domethënie. Naomi do të thotë e Këndshme; Elimelek do të thotë Perëndia im është Mbret; Mahlon dhe Kilion sugjerojnë emra si I Dobët dhe I Tretur. Ja historia e një familjeje e cila, në një kohë krize ekonomike, la tokën e premtuar (duke tradhtuar kështu emrin e burrit); e një nëne me barrën e dy djemve shëndeti i të cilëve me sa duket ishte shpesh një ankth. Tragjedia ndoqi tragjedinë në vdekjen e babait, martesën e djemve, dhe vdekjen e tyre të parakohshme.

Këtu, siç shihet, përballemi me një problem serioz, edhe sikur të mos mundemi t'i japim një përgjigje përfundimtare. A ishin këto ngjarje një gjykim hyjnor mbi këtë familje? Kur këmbëngulim në dhënien e pyetjeve si kjo, shpesh, kemi për të zbuluar se pyetjet tona janë pikërisht ato që do prodhojnë përgjigje prej pasazhit; por ka për të patur gjithashtu raste kur do të zbulojmë se Perëndia nuk ka për qëllim që të na japë përgjigje. Ka për ta patur gjithashtu raste kur nuk kemi për ta kuptuar përgjigjen, dhe mund të na duhet të presim për më shumë njohuri dhe ndriçim përpara se të na qartësohet ndonjë zgjidhje. Por ky lloj metode pyetjeje shpesh ka për të na udhëhequr drejt zemrës së çështjes.

Gjatë vazhdimit të historisë zbulojmë një zhvillim të ri në jetën e Naomit. Ajo përgatitet të kthehet në tokën e premtuar (v.6). Pa dyshim që kjo është shumë domethënëse. Kthimi në tokën e premtuar është një temë që shfaqet shpesh në Dhiatën e Vjetër, pasi toka është e lidhur me premtimin e Perëndisë në besëlidhjen e tij. Është atje, dhe vetëm atje, që ai ka premtuar ta bekojë popullin e tij. Për më tepër, siç na thotë ky pasazh, ishte pikërisht atje që Perëndia po bekonte popullin e tij (v.6). Ajo që kemi këtu, pra, është një pikturë e njërës prej fëmijëve të Perëndisë që ka qenë e ndarë prej të gjitha mjeteve të zakonshme të hirit, e cila kthehet tek ai. Pavarësisht nëse tragjeditë në jetën e Naomit duhet të lexohen si gjykim apo jo, ne mund të shohim tani se Perëndia i përdori ato për ta kthyer atë në bashkësi me veten e tij dhe popullin e tij.

Ky është një mësim i rëndësishëm në karakterin dhe strategjinë e Perëndisë. Ai është lloji i fushës së studimit të Biblës ku mund të dëshirojmë të ndalojmë dhe ta ndjekim temën më me rrënjë. Do të duam patjetër të ndalojmë për t'u soditur mbi sjelljen e Perëndisë në vetë jetët

tona, dhe për të bërë pyetjet me vend: A po sillet kështu Perëndia me mua? A e kam njohur unë dorën e tij mbi jetën time në këtë mënyrë? A hedh dritë kjo mbi eksperiencën timë, ose a më ndihmon mua për të pranuar ndonjë situatë në të cilën e kam gjetur veten? Ajo sigurisht më mëson se Perëndia është i përgatitur të lejojë shumë gjëra misterioze me qëllim që t'ua tërheqë fëmijët krahëve të tij. Mund të vërejmë se në fund të kapitullit Naomi është shumë e ndergjëgjshme për dorën përlulëse të Perëndisë mbi të (v.20 - *I Plotfuqishmi më ka mbushur me hidhërim*), por ajo gjithashtu shikon në të qëllimin hyjnor (v.21 - *Unë u nisa me bollëk dhe Zoti më ktheu në shtëpi të zhveshur nga çdo gjë*).

Pjesa qendrore e kapitullit (1:16-18) na paraqet një skenë mjaft të ndryshme. Këtu Naomi qëndron në udhëkryqin midis Moabit dhe Betlehemit, bashkë me dy nuset e saj. Gjëja e parë që vëmë re është se restaurimi i saj shpirtëror dhe dëshira e saj e re për të qenë me popullin e Perëndisë e kanë inkurajuar për të qenë dëshmuere për të tjerët. Ajo nuk qëndron më e heshtur për nënkuptimet e anëtarësisë në popullin e Perëndisë! Çmimi i një dishepullimi të tillë del si i tepërt për Orpahun. Është e pamundur që të mos vëmë re se cila ishte pikërisht çështja në rrezik; Naomi e nënvizon atë në vargjet 11-14. Është çështja e martesës. Ajo përbën një problem të madh për shumë të krishterë. A jemi të gatshëm për të shkuar me popullin e Krishtit me një çmim kaq të lartë? Përsëri, këtu, do të duam të pushojmë pak për më shumë reflektim, shqyrtim të vetvetes dhe lutje.

A do të kishte qenë përgjigjja jonë si ajo e Ruthit? E saja është dhënë me fjalët më të famshme të të gjithë librit. Por, shpesh ne kemi për të parë në studimin tonë se fjalët e famshme duhet të konsiderohen me kujdes. Nëse reflektojmë mbi Shkrimin, dhe mbi llojin e gjuhës së fjalëve të Ruthit, kemi për të filluar të kuptojmë se në to ka më shumë sesa një shprehje të përkryer të miqësisë dhe besnikërisë personale. Deklarimi i saj merret shpesh në këtë nivel. Por ajo duhet të tingëllojë ndryshe në mendjen e atyre që studiojnë Biblën. Sepse fjalët e saj janë kujtuese të fuqishme të premtimeve të besëlidhjes së Perëndisë (p.sh., Eksodi 6:7) në të cilat ai premtonte të jetë Perëndia i njerëzve të tij dhe i lidh ata me veten. Ajo që po bën këtu Ruthi është dorëzimi i saj në një besëlidhje personale me Perëndinë. Në thelb, ajo po i përgjigjet premtimit të ungjillit të Dhiatës së Vjetër, dhe po e beson gjithë jetën e saj në duart e Perëndisë. Shkurt, ajo u kthye besimtare.

Përsëri do të duam të pushojmë për një meditim praktik. Vini re se vetëm tani është përdorur dëshmia e Naomit për ta sjellë Ruthin në popullin

e besëlidhjes së Perëndisë, pavarësisht nga afria e marrëdhënieve të tyre për një kohë kaq të gjatë. Vetëm tani është hequr pengesa, dhe hiri i Perëndisë ka filluar të rrjedhë lirisht në të tjerët. Këtu, sigurisht, ka disa pyetje hetuese personale që duhet t'i bëjmë vetes. Pastaj do të duam të konsiderojmë këtë çështje: Këtë kuptim ka besimi im në Krishtin? A kam filluar unë të vlerësoj se Perëndia është Perëndia im dhe se unë i përkas popullit të tij? Ç'kuptim mund të ketë kjo për mua?

Kështu Ruthi kthehet me Naomin në Betlehem (vargjet 19-22). I gjithë qyteti trazohet. A nuk duhet që reagimi të jetë gjithmonë i tillë kur fëmijët e Perëndisë dalin si po aq besnikë atij sa edhe Ruthi dhe Naomi? Sa larg duhet të shkojmë ne për të ngjallur këtë reagim! Kështu, ndërsa mbylлим këtë studim të parë tonin, e gjejmë veten të përlur përpara fjalës së Perëndisë, duke u lutur që ai t'i përdorë njerëzit e tij për të lënë të tilla përshtypje në botën përreth tyre. Duhet të lutemi që jeta jonë të jetë një dëshmie i tillë.

Kapitulli Dy

Kapitulli i dytë fillon me një thënie që vendos tonin për vargjet që vijojnë. Prezantohet Boazi. Ashtu si historia e Ruthit e ka zanafillën në mënyrat me të cilat dora e Zotit erdhi në fillim mbi vjehrrën e saj, redaktori i librit të Ruthit na thotë tani se Perëndia kishte një dimension tjetër për planin e tij. Komente të tilla redaktori në Shkrim kanë për qëllim të jenë tabela rrugore. Ato na ndihmojnë më plotësisht për të vlerësuar domethënien e asaj që vijon. Këtu mësimi është i qartë. Qëllimi i Perëndisë në jetën tonë përfshin mbledhjen së bashku të shumë fijeve të punës së tij në jetët e të tjerëve. Ky mësim duhet të na udhëheqë në habi dhe adhurim. A mund ta përdorim atë në jetën tonë, ndërsa zbulojmë përmes tyre shembujt e Perëndisë?

Nëse redaktori na vë në gatishmëri kundrejt faktit se duhet t'i mbajmë sytë hapur për providencën e Perëndisë në jetën tonë, nuk kemi nevojë të shkojmë larg për të zbuluar se nganjëherë ajo mund të duket shumë e rëndë për t'u duruar. Ruthi dhe Naomi ishin me të vërtetë të këputura. Përkushtimi ndaj Perëndisë, mësojmë se nuk është një garanci se jeta do të jetë pa vështirësi dhe vuajtje (a menduan ato për një moment se jeta mund të kishte qenë fare mirë më e rehatshme në Moab?). Pse ky parim është kaq i rëndësishëm për t'u mësuar? Sepse ai mund të na shpëtojë prej një pikëpamjeje për jetën shpirtërore që do të na çonte në një zhgënjim

të patreguar. Shpesh mësimi biblik na jepet jo vetëm për t'u marrë me situatën tonë të tanishme, por për të siguruar atë lloj njohurie për rrugët e Perëndisë e cila do ta mbështesë jetën tonë në ditët e errësirës dhe vështirësisë. Njeriu i lajmëruar, gjysmë i shpëtuar!

A mund ta imagjinojmë tani veten në pozitën e këtyre grave? Si do të reagonim ne? Si kemi reaguar ne në vështirësi të ngjashme? Këto janë pyetje që mund të na ndihmojnë për të parë në një dritë të re punën plot hir të Perëndisë në jetën tonë. A jemi ndonjëherë të hidhëruar? Apo ndoshta të paralizuar në pasivitet? Mund të mendojmë për të tjerë në Shkrim që ishin - si Jeremia (Jer. 20:7) ose Psalmisti (Ps. 102:10). Por këto gra duken të shfaqin një shpirt kënaqësie pavarësisht nga gjendja e tyre. Shembulli i tyre më vë të mendohem gjatë studimit tim të Biblës për mënyrën se si ta zhvilloj këtë gjë në vetë jetën time. Kjo më çon në pasazhe të tilla si Psalmi 131 dhe Filipianët 4:11,12.

Ruthi shkoi për të mbledhur kallëza (v.2). Cila është rëndësia e vërtetë e të mbledhurit të kallëzave? Ndoshta për këtë mund të na nevojitet ndihma e një renditjeje alfabetike fjalësh [zakonisht një listë e tillë e pjesshme gjendet në fund të Biblave në gjuhën angleze] ose të një fjalori biblik, për të zbuluar se Perëndia kishte siguruar për mbledhjen e kallinjve në Ligjin e tij (Eks. 19 dhe 23; LiP 24:19). Këtu ka një mësim tjetër shumë praktik për mua. Kur Ruthi dhe Naomi ishin në vështirësi ato e gjetën përgjigjen për nevojat e tyre duke jetuar brenda kufijve dhe furnizimeve në Ligjin e Perëndisë. Gjatë leximit në vazhdim të historisë zbulojmë se kjo ishte rruga që i çoi ato jo vetëm në plotësimin e nevojave të tyre të atypëratyshme, por në plotësimin e qëllimit të tij përfundimtar për jetën e tyre. Ai qëllim, siç e zbulojnë vargjet mbyllëse të librit, ndikoi në gjithë pjesën tjetër të planit shpëtues të Perëndisë përgjatë gjithë historisë!

Historia fillon të shpaloset. Boazi i ndihmon gratë, dhe ua plotëson nevojat (v.5,16,17). Jeta e tij ia vlen për një studim më vete. Kush ishte ai? Çfarë cilësish shfaq ai për të cilat ne duhet t'i kërkojmë Perëndisë për të na ndihmuar që t'i imitojmë? Ne e dimë nga leximi fillestar që i kemi bërë librit se ai do të martohet me Ruthin. Por cilat karakteristika të jetës së tij e bënë atë një partner të përshtatshëm për këtë vejtje të re e cila i ishte kushtuar kaq qartë shërbimit ndaj mbretërisë së Perëndisë dhe popullit të tij? Nëse kontrollojmë në pemën gjenealogjike të tij gjejmë se ai nuk ishte aspak një çifut 'puro'. Ai, në fakt, ishte siç e tregon Dhiata e Re, një pasardhës i prostitutës Rahab (Mat. 1:5). A i shkonin sfondi familjar dhe

përvoja personale e tij përtë patur një interes të veçantë dhe përtë zhvilluar një ndjenjë të veçantë për këtë Moabite? Asnjë detaj qoftë dhe i jetës sonë familjare nuk është aksidental apo i rastësishëm për Perëndinë!

Hera-herës gjatë studimeve të tilla mund të jetë një gjë e dobishme të bëjmë një hap pas prej veprimit të momentit në mënyrë që të përpiqemi për të ndier planin që po ndjek Perëndia në këtë rrëfim historik. Sikur këto dy gra të mos i kishin humbur burrat e tyre, ndoshta, nuk kishin për t'u kthyer kurrë në Betlehem. Sikur të ishin kthyer plot, Ruthi mund të mos i kishte treguar kurrë ato cilësi plot hir që tregoi. Sikur të mos kishte mbledhur ndonjëherë kallëza, historia nuk do të kishte filluar të merrte kthesën e habitshme që mori. Asgjë prej kësaj nuk mund të parashikohet gjatë leximit të rreshtave të parë të librit. Providencat (furnizimet, sigurimet) e Perëndisë, tha një njeri i urtë, janë si fjalët hebraishte - ato mund të lexohen siç duhet vetëm mbrapsht! Do të kujtojmë fjalët që Jezusi u tha dishepujve: *Do ta kuptosh mbas kësaj* (Gjoni 13:7). Nëse e kemi mësuar këtë mësim nga Ruthi 2, kemi mësuar shumë. Dhe do të jemi të aftë të themi me Naomin: *Zoti... nuk e ka hequr mirësinë e tij* (2.20).

Kapitulli Tre

Bibla na vjen nga një botë shumë e ndryshme prej tonës. Ne jetojmë në një mjedis tërësisht të ndryshëm, gjeografikisht, intelektualisht, historikisht dhe nga ana kulturore. Pak veçori të jetës kanë mbetur relativisht të pandryshuar që nga koha që u shkrua Libri i Ruthit. Ne e dimë se zemra e njeriut është e njëjtë; e dimë se Perëndia dhe rrugët e tij me njerëzit janë të njëjta. Pyetja, në të vërtetë problemi, me të cilin përballemi nganjëherë në studimin tonë, pra, është: Si e përkthej unë atë që bëri Perëndia në botën e atëhershme në atë që po bën ai në botën e sotme?

Hera-herës, interpretimi i fjalës së Perëndisë për vetë jetën dhe kohën tonë kërkon që ne të familjarizohemi me botën kulturore të Biblës. Këtë na u desh ta bënim në kapitullin dy të Ruthit, me qëllim që të kuptonim domethënien e mbledhjes së kallëzave. Në kapitullin tre shtrihet pas historisë një tjetër parim i Dhiatës së Vjetër. Këtu përmendet njeriu që ka *të drejtën e shpengimit* (v.12; gjithashtu 2:20; 3:2).

Përsëri, në këtë pikë, mund të kemi ndoshta nevojë ose për një fjalor a komentar biblik ose për disa kryq-referime shumë të mira në anë të Biblës [në gjuhën angleze]. Duke përdorur këtë ndihmë mund të

zbulojmë se në botën izraelite, mbi jetën familjare vihej një theks shumë më i madh sesa në botën tonë. Bekimet dhe stabiliteti që solli kjo, balancoheshin nga përgjegjësi përkatëse për të ndihmuar një anëtar të familjes që ishte në nevojë. Për shembull, dikush mund të detyrohet të shesë tokën për të paguar borxhet. Në këtë rast, një pjesëtar i familjes (njeriu që ka të drejtën e shpengimit) pritej që të çonte çmimin e blerjes, kështu që prona të mund të mbahej brenda familjes, dhe mundësisht të riblihej në një kohë të mëvonshme nëse do ta lejonin rrethanat. Ne shohim një pasqyrim të kësaj në mënyrën se si e trajton Boazi Ruthin në kapitullin dy (krah. 2:20).

Por në jetën e familjes çifute kishte dhe një institucion tjetër të vendosur nga Ligji i Perëndisë. Ai është i njohur si martesë levirate. Nëse një burrë vdiste pa bërë fëmijë, vëllai i tij duhej të martohej me vejushën e tij dhe biri i tyre i parë do të numërohej si biri i burrit të vdekur. Ndoshta për shkak të rrethanave të ndërlikuara të asaj kohe, kjo përgjegjësi me sa duket është përhapur përtej kushërinjve të afërm dhe i është kaluar edhe atij që ka të drejtën e shpengimit. Me sa duket është dija e saj se Boazi ishte një nga ata që kishte të drejtën e shpengimit që ia rriti shpresat Naomit në 2:20 se Perëndia mund të kishte një qëllim të veçantë në këtë takim, në pamje të parë rastësor, midis atij dhe Ruthit.

Kapitulli tre tregon sesi Naomi i tha Ruthit që të reagoonte ndaj situatës së krijuar. Ruthi duhet të lahet dhe të parfumohet, të veshë rrobat e saj më të mira, dhe, pas festimeve të darkës, të shkojë në vendin ku është shtrirë Boazi. Atje, ajo duhet t'ia zbulojë këmbët atij dhe të shtrihet qetësisht. Kur Boazi zgjohet, Ruthi e fton atë ta shtrijë skajin e mantelit të tij mbi të (v.9). Kjo me sa duket ka qenë e barazvlershme me propozimin! (Shih Ezek. 16:8.) Boazi vë në dukje se ajo në fakt ka një të afërm tjetër më afër se ai, por premtun se, nëse ai refuzon të martohet me Ruthin, atëherë ai (Boazi) do ta bënte.

Në pamje të parë, ky kapitull duket të jetë një zonë më pak pjellore për studim biblik sesa kapitujt një dhe dy. Por ne duhet të hetojmë disa rrugë shumë praktike mendimi në lidhje me këtë. Këtu, mbi të gjitha, gjendet historia e shquar e njohjes dhe martesës në Dhiatën e Vjetër. Çfarë mund të na mësojë neve ajo rreth më së çmuarës së gjithë marrëdhënieve njerëzore? A ka këtu, parime të cilat na pajisin me udhëzime?

Është interesante të kujtojmë se si Naomi foli për domethënien e martesës në 3:1. Fjala që ajo përdori ishte 'shtëpi' apo *vend paqeje*. Kjo na kthen pas në shprehjen e ngjashme të 1:9. Kjo ide mban me vete, siç shihet, stabilitetin, qëllimin, sigurinë dhe fuqinë që jep një familje.

Kjo nuk do të thotë se pikëpamja e Biblës për jetën e gruas është se ajo duhet të jetë përherë në shtëpi në kuzhinë. Shih Fjalët e Urta 31:16 për 'gruan ideale' e cila merret edhe me pasurinë e patundshme, por edhe me vreshtin, pra, vitikulturën! Jo vetëm kaq, por ajo është edhe një tregtare e suksesshme (v.18). Por ajo na mëson diçka për njërën prej nevojave themelore të mëdha të një gruaje të re, dhe të cilën burri, apo burri i ardhshëm, duhet ta konsiderojë si një prej përgjegjësisë të tyre më të mëdha për hyrjen në një besëlidhje martesore. Kjo shprehet shumë bukur në ftesën piktoreske të Ruthit që i thotë Boazit 'të shtrijë krahët e tij' mbi të. Kjo mund të na çojë për t'iu drejtuar Efes. 5:25, që të meditojmë mbi këshillat e Dhiatës së Re ndaj burrave që t'i duan dhe të kujdesen për gratë e tyre.

Një çështje e mëtejshme që del në këto vargje është dashuria reciproke dhe respekti i ndërsjellë që kishte filluar në mënyrë të qartë të ekzistonte midis Ruthit dhe Boazit. Këtu përsëri na kujtohet Efes. 5:33. Kemi për të vënë re dëlirësinë e Boazit (v.13,14); ndershmërinë e tij ndaj të njohurve të tij (v.12); mirësinë e tij ndaj Naomit, vjehrrës së tij të ardhshme! (v.17); kuptimi i tij për Perëndinë (v.13, ndoshta edhe në lutjen e tij në v.14). Boazi e përmbledh këtë në vargun 10. Dashuria e tij është më shumë sesa një joshje kalimtare.

Këtu ka pa dyshim një sasi të madhe udhëzimi për moshat dhe statet e ndryshme në kishën. Sot ka një nevojë të ngutshme që ne të mësojmë këto standarde biblike përsëri. Kështu pra, ne zbulojmë se, me gjithë hendekun e dukshëm kulturor midis nesh dhe ditëve të Gjyqtarëve, fjala e Perëndisë flet ende për njërën prej çështjeve më themelore në shoqërinë e sotme.

Një vijë e dytë mendimi që mund të dëshirojmë të ndjekim në këtë kontekst është rruga në të cilën ky kapitull na tregon diçka rreth rëndësisë së karakterit dhe ndershmërisë së vërtetë në gjithë marrëdhëniet tona. Ne nuk u shtojmë asgjë qëllimeve të Perëndisë duke rrëmbyer atë që mund të dëshirojmë me gjithë zemër. Pa dyshim, Boazi e kupton se ai ka ndjenja kundrejt Ruthit. Ai e thotë kaq gjë në vargun 10. Por ai e kupton, gjithashtu, detyrën e besnikërisë ndaj Perëndisë, ligjit të tij, dhe njerëzve të tjerë. Boazi, në dallim nga shumë prej nesh, e kuptoi se rruga e bekimit duhet të jetë gjithmonë një rrugë bindjeje parimore ndaj fjalës dhe ligjit të Perëndisë - çfarëdo që të fitojmë apo humbim në këtë proces. Nëse e dimë librin e Predikuesit, kanë për të na u kujtuar fjalët: *Vlen me tepër një grusht me pushim sesa dy grushte, me mundim, duke u përpjekur të kapësh erën.* (Predikuesi 4:6)

Është interesante të shihet se Ruthi përshkruhet si *një grua e virtytshme* (3:11). Këtu, ne mund të duam të marrim pak kohë për të ristudiuar shembullin e jetës së saj dhe për të zbuluar çfarë cilësish duhen për të krijuar një fisnikëri të tillë shpirtërore. A nuk shohim ne nevojën për një fisnikëri të vërtetë të krishterë që të ndriçojë përmes jetës sonë në shoqërinë bashkëkohore? E njëjta e vërtetë pasqyrohet në komentin që Naomi bën për Boazin: *Ai burrë nuk do të rrijë deri sa ta ketë sistemuar sot çështjen* (3:18). Këtu, angazhimi dhe përkujdesja janë shkrirë në një. Ndoshta, kjo është një dëshmi e hirit të Perëndisë në zemër që neve na mungon. Studimi i Ruthit kapitulli tre, do të na bëjë, pra, të lutemi që Perëndia të përpunojë një karakter fisnik dhe një hir të vërtetë në jetën tonë dhe në gjithë marrëdhëniet tona, veçanërisht në ato që ne i konsiderojmë si më të rëndësishmet.

Kapitulli Katër

Vijmë kështu te pjesa e fundit e studimit tonë mbi Ruthin. Deri tani kemi arritur të zbulojmë karakterin e Perëndisë dhe udhëheqjen providenciale të fëmijëve të tij përmes përjetimesh të errëta. Kemi njohur gjithashtu edhe tiparet e karakterit të një dishepulli të vërtetë në secilin prej tri karaktereve kryesore të librit. Tani zbulojmë në kapitullin katër se fillimi i trishtueshëm i historisë çon faktikisht në një fund të lumtur të papritur. Përsëri pjesa më e madhe e interesit përqendrohet mbi Boazin. Ndoshta ne kemi supozuar se Ruthi është një histori me rëndësi praktike vetëm për gratë! Në këtë shkallë të studimeve tona kemi për të njohur më mirë. Në kapitullin katër, disa tipare të tjera të jetës së tij na bëjnë përshtypje disa mësimet të rëndësishme shpirtërore.

Boazi shfaq një besim të fortë në mirësinë e Perëndisë. Në kapitullin tre pamë disa aluzione të kësaj, por tani ato vijnë shumë qartë në sipërfaqe. Nuk ka dyshim se ai dëshiron të martohet me Ruthin (3:13). Por vargjet hapëse theksojnë se ai beson se nëse ecën në detyrat e tij ndaj Perëndisë, të vendosura në Ligj, fundi ka për të qenë vetëm e mira dhe bekimi i tij përfundimtar. Ai nuk kishte asnjë garanci se kjo kishte për të qenë e njëjtë me aspiratat e tij natyrore. Por, ndoshta ai kishte aq eksperiencë me marrëdhëniet e Perëndisë me të sa t'i thoshte vetes:

A nuk ke parë ti

Se si kanë qenë dëshirat e zemrës sate

Të plotësuara në atë që ka urdhëruar ai?

Gjatë reflektimit të mëtejshëm mbi Boazin arrijmë në konkluzionin se ai shfaq një kombinim të aktivitetit me durimin, gjë që mund të prodhohet në ne vetëm nga bindja kundrejt ligjit të Perëndisë. Ai vepron; por meqë ai vepron në përputhje me udhëzimet që Perëndia ka vendosur në fjalën e tij dhe nuk i shkel ato, atij i përmbahet t'i marrë çështjet në dorën e tij. Zbatimet praktike të këtij parimi janë të shumta. Në studimin tonë personal, kemi për ta parë veten tonë pashmangshmërisht, duke shqyrtuar ato situata të shumta në jetën tonë kur kemi dështuar. Ndoshta ne tashmë ndodhemi në një situatë në të cilën ky parim i madh hedh dritë në rrugën ku ne duhet të hedhim hapin tjetër.

Gjatë reflektimit mbi përjetimin e Ruthit dhe Naomit të regjistruar në këtë kapitull zbulojmë se ai ilustron premtimin e madh të Jezusit. Asnjë dishepull i cili bën sakrifica për t'i shërbyer Perëndisë nuk ka për të qenë ndonjëherë më i varfër (Lluka 18:29). Ruthi kishte lënë shtëpinë dhe familjen për hir të Perëndisë dhe të hirit të tij në besëlidhje; ajo mori *në këtë botë*, shtëpi dhe familje, gëzime dhe plotësim që përndryshe nuk kishte për t'i njohur kurrë. Këtu ka një vijë mendimi e cila na udhëheq me siguri drejt një shqyrtimi të vetes sonë, por në të njëjtën kohë duhet të na inkurajojë në falënderim dhe lavdërim.

Reagimi i pleqve kundrejt gjithë kësaj - e regjistruar në 4:11,12 - është shumë interesant. Këtu kemi një pikturë të komunitetit të popullit të Perëndisë që kërkojnë të njohin vullnetin e tij së bashku. Kjo aludon për shumë mësim në jetën tonë si anëtarë të bashkësive të krishtera, mbi kujdesin e ndërsjellë, respektin, dashurinë dhe lutjen që ajo përfaqëson. Ajo që është veçanërisht mahnitëse është mënyra me të cilën përkujdesja dhe lutja e këtyre njerëzve është kredhur në format e mendimit të vetë Shkrimit. Në të vërtetë ata po bëjnë pikërisht atë që bëjmë dhe ne në studimin tonë të Biblës: ata reflektojnë mbi hirin dhe mirësinë që Zoti ka treguar ndaj fëmijëve të tij në të kaluarën. Ata i besojnë atij si Atit besnik të popullit të tij i cili nuk ndryshon, që ai të shfaqë të njëjtën fuqi dhe dashuri në jetën e Boazit dhe Ruthit. Ç'mësim për lutjen tonë të përbashkët!

Konkluzioni i librit jep mësimin më të spikatshëm të të gjithë mësimëve. Boazi bëhet baba, Ruthi një nënë e lumtur, dhe Naomi një gjyshe e gëzuar! Ky është një fund 'rruan dhe u trashëguan'. Në të vërtetë, kjo është thellësisht më e vërtetë sesa mund ta mendojmë ne. Sepse libri përfundon me një gjenealogji. Por çfarë gjenealogjie se! Ajo na tregon se ***Salmonit i lindi Boazi; Boazit i lindi Obedi; Obedit i lindi Isai dhe Isait i lindi Davidi.*** Pemët e gjenealogjisë familjare në Mat. 1 dhe Llukën 3

nënvizojnë faktin se kjo gjenealogji e shkurtër më në fund çon në lindjen e Jezusit, Shpëtimtarit. Privilegji më i madh për tri karakteret në Librin e Ruthit është se ata u bënë hallka thelbësore të zinxhirit i cili do të çonte përfundimisht në plotësimin e premtimit të besëlidhjes së Perëndisë ndaj Abrahamit, dhe ardhjen e mbretërisë së Perëndisë. Plotësimi i planit të përjetshëm të Perëndisë varej nga plotësimi i detajeve të tij në jetën e këtyre njerëzve në dukje të parëndësishëm. Gjithashtu, bindja e tyre në atë kohë ndaj vullnetit të tij ishte porta përmes së cilës do të vinte një bekim më i madh. Perëndia punon në jetën tonë jo vetëm për kohën tonë, por edhe për brezat që ende nuk kanë lindur. Ky është mësimi i madh. Sfida është e qartë. A e kemi ne ndjesinë e privilegjit të jashtëzakonshëm që na ka dhënë Perëndia duke na bërë të zëmë vend në qëllimet e tij? A jemi të gatshëm ne që t'ia dorëzojmë veten tonë plotësisht vullnetit të tij?

Kështu, studimit tonë mbi Ruthin, të paktën për momentin, i erdhi fundi. Do të duam të kalojmë te ndonjë libër tjetër për t'u marrë me metalet e pasura që Perëndia do të na ndihmojë të rrëmojmë prej tij. Akoma nuk kemi mësuar gjithçka që është për t'u mësuar prej këtij libri të vogël. Por kemi mësuar diçka. Kjo do të na ndihmojë që të ndiejmë se Perëndia ka më shumë dritë akoma për të shpërthyer prej fjalës së tij.

TRE

Të Jetojmë me anë të Biblës

6 Cila është Dobia?

Në kapitullin tre vërejtëm se njëra prej gjërave që na bind se Bibla është fjala e Perëndisë është efekti që prodhon ajo. Gjatë leximit të faqeve të saj ne ndërgjegjësohemi se Perëndia i gjallë po na flet përmes saj. Në të gjejmë Krishtin. Në të vërtetë, prandaj dhe e lexojmë. Ne shkojmë tek Bibla ashtu siç shkuan barinj të grazhdi, siç i pëlqente Martin Luterit të thoshte - për të gjetur Krishtin. Kurdoherë që e lexojmë atë, dëshira jonë është që ta ndiejmë edhe ne zemrën që na digjet ashtu si dhe dishepujt në rrugën për në Emaus kur filluan të shihnin se si fjala e Perëndisë dëshmon në mënyrë konsistente për Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin tonë.

Por, nëse Bibla na tregon Krishtin, ajo duhet të ketë efekte shumë rrënjësore dhe të qëndrueshme në jetën tonë të përditshme. Në veçanti, mësimi i saj dhe ndikimi i përgjithshëm i saj, pashmangshmërisht, ka për ta formuar dhe brumosur karakterin tonë. Gjatë gjurmimit tonë më në thellësi në mësimin e saj, kemi për të filluar të kuptojmë se ky është një nga qëllimet më të mëdha për të cilat Perëndia na ka dhënë fjalën e tij. Ky fakt nxirret qartë në një nga deklaratat më madhështore të Dhiatës së Re rreth natyrës dhe funksionit të Biblës në jetën e të krishterit:

Por ti qëndro në ato që mësove dhe u binde plotësisht, duke e ditur prej kujt i mësove, dhe se që nga fëmijëria i njej Shkrimet e Shenjta, të cilat mund të të bëjnë të ditur për shpëtimin me anë të besimit që është në Krishtin Jezus. I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë.

(2 Timoteu 3:14-17)

Kjo është një pjesë shumë e rëndësishme dhe e spikatur e Shkrimit, për shumë arsye. Ajo përmban fjalët e fundit të regjistruara të apostullit Pal, dhe si rrjedhojë, ka shumë të ngjarë të jetë një shprehje e disa prej shqetësimeve të tij më të thella. Ajo i është shkruar Timoteut, një të riu

(ndoshta rreth të njëzetave të fundit ose tridhjetave të herëta) i cili kishte arritur të ketë rëndësi për Palin më shumë se çdokush tjetër (Fil. 2:19-22). Ai, mbi gjithë të tjerët jashtë grupit të apostujve, duhej të vazhdonte punët e apostullit të fuqishëm. I vendosur në qytetin gëlues të Efesit (1 Tim. 1:3), ai përballonte shumë vështirësi dhe probleme, nga jashtë në paganizmin që e rrethonte, nga brenda në problemet në kishë, dhe me sa duket edhe në jetën e tij. Ai kishte nevojë për këshillimin më të urtë pastoral të Palit.

Pali i tha atij këtë: ‘Besoje fjalën e Perëndisë, sepse ajo ka ardhur prej tij dhe mban autoritetin e tij. Ti e di se ajo të solli te Krishti dhe të mësoi për rrugën e shpëtimit. Ti e ke parë efektin e saj në jetën e të tjerëve - gjyshes sate Loide dhe nënës sate Eunike (2 Tim. 1:5), të cilat të mësuan të vërtetën e saj që kur ishte fëmijë. Ti e ke parë se si ajo ma ka brumosur jetën dhe më ka mbajtur përkundër mundësive më të pashpresa. Të jesh i sigurt se ajo mund të bëjë të njëjtën gjë edhe për ty!’

Zhan Kalvini shkroi njëherë se ‘Shkrimet marrin autoritet të plotë ndërmjet besimtarëve vetëm kur njerëzit i konsiderojnë ato si të buruara nga qielli, si të dëgjoheshin në to fjalët e gjalla të Perëndisë’ (*Institutet*, I.vii.1). Timoteu që i bindur për këtë. Ai kishte faktet në jetën e të tjerëve për ta provuar atë. Por Pali donte ta nxiste edhe me efektin që do të kishin edhe në jetën e tij studimi dhe bindja e tij ndaj fjalës së Perëndisë. Kështu që ai i shtoi thënies së tij për karakterin e frymëzuar prej Perëndisë të Shkrimit një shpjegim së pari të qëllimit dhe së dyti të efektit të Biblës në jetën e të krishterit.

Qëllimi i Biblës

Përshkrimi më i gjallë që dha Pali ndonjëherë për Biblën ishte se ajo është ‘shpata e Frymës’ (Efes. 6:17). Ai e përfytyron Biblën si një mjet, apo armë në dorën e Frymës, si dhe në dorën e të krishterit. Fryma e përdor Biblën për të fituar terren në personalitetin dhe karakterin e besimtarit; për të prerë karakteristikat fyese në jetën tonë; për të vrarë kundërshtimin ndaj mbretërisë së Perëndisë. Në një pasazh tjetër na thuhet se:

Sepse fjala e Perëndisë është e gjallë dhe vepruese, më e mprehtë se çdo shpatë me dy tehe dhe depërton deri në ndarjen e shpirtit dhe të frymës, të nyjeve dhe të palcave, dhe është në gjendje të gjykojë mendimet dhe dëshirat e zemrës. Dhe nuk ka asnjë krijesë

që të jetë e fshehur para tij, por të gjitha janë lakuriq dhe të zbuluara para syve të atij, të cilit ne do t'i japim llogari.

(Heb. 4:12-13)

Perëndia përshkruhet në Dhiatën e Re si kardiologu i madh - specialisti suprem i zemrës, si të thuash. Në të vërtetë, fjala që përdor Dhiata e Vjetër shkon më tej; ajo e përshkruan atë jo thjesht si dikë që studion zemrën, por si një që njeh zemrat e njerëzve. Ai nuk është vetëm një kardiolog frymëror, por edhe një kardiagnostik [njohës zemre] frymëror! (Shih Vep. 1:24; 15:8.) Ai e përdor fjalën e tij për të nxjerrë në shesh skutat më të thella të jetës dhe personalitetit tonë (*deri në ndarjen e shpirtit dhe të frymës, të nyjeve dhe të palcave*), dhe fillon t'i rindërtojë jetët tona sipas Krishtit - nga brenda. Ky shndërrim çuditës fillon të ndodhë kur ne vijmë për ta njohur Perëndinë në fjalën dhe të vërtetën e tij. Përsëri, Pali e përshkruan këtë punë në dy pasazhe të gjalla:

Por kur Izraeli të kthehet te Zoti, veli do të hiqet. Sepse Zoti është Fryma, dhe atje ku është Fryma e Zotit, atje është liria. Dhe ne të gjithë, duke soditur fytyrëzbuluar lavdinë e Zotit si në pasqyrë, transformohemi në të njëjtën shëmbëllim nga lavdia në lavdi, posi prej Frymës së Zotit.

(2 Kor. 3:16-18)

Pali po bën këtu një kontrast midis verbërisë shpirtërore të bashkëkohësve të tij dhe shndërrimit që fillon të ndodhë në jetët e atyre të cilët janë bërë *të ditur për shpëtimin me anë të besimit që është në Krishtin Jezu* (2 Tim. 3:15). Ata shohin Krishtin në Shkrim, dhe me anë të punës së Frymës së Shenjtë jetët e tyre fillojnë të marrin shëmbëllimin e Krishtit - në mënyrë madhështore.

[U mësuar] që të zhvisheni, për sa i takon sjelljes së mëparshme, nga njeriu i vjetër që korruptohet me anë të lakmive të gënjeshtërs, dhe të përtëriteni në frymën e mendjes suaj dhe të visheni me njeriun e ri, të krijuar sipas Perëndisë në drejtësinë dhe shenjtërinë e së vërtetës.

(Efesianët 4:22-24)

Por si 'u mësuan' ata për këtë? Si 'u përtëritën' ata në qëndrimin e mendjes së tyre? Me anë të doktrinës dhe mësimi të apostujve! Me anë të

atij udhëzimi që na është dorëzuar tani në Dhiatën e Re. Kur merret në dorë nga Fryma e Shenjtë, kjo është ajo që çon në shndërrimin e karakterit të krishterë!

Nëse u kthehemi tani fjalëve inkurajuese të Palit për Timoteun, do të shohim qartë mënyrat me të cilat Perëndia përmbush këtë qëllimin e tij të madh në jetët tona. Ai thotë se fjala e Perëndisë është e dobishme për katër gjëra.

Për Mësim

Është gabim të mendohet se krishterimi 'kapet, më tepër sesa mësohet'. Vërtet, ne nuk bëhemi të krishterë thjesht duke u mësuar për Ungjillin. Por, është e sigurt që ne bëhemi të krishterë kur mësohemi nga brenda prej Frymës së Shenjtë, dhe kur 'mësojmë Krishtin' siç do të thoshin etërit tanë. Ne bëhemi dishepuj të Krishtit nëpërmjet këtij mësimi të brendshëm, apo 'vajosjeje' (1 Gjoni 2:20). Ajo është e lidhur ngushtë me mësimin tonë të mesazhit të Biblës. Kur bëhemi të krishterë, ne bëhemi edhe dishepuj, apo nxënës. Jetët tona i vendosim në duart e Krishtit dhe ai na mëson përmes fjalës së tij. Ne nuk bëhemi vetvetiu apo me intuitë njohës të gjithçkaje që ka të bëjë me të qenët i krishterë. Ka shumë gjëra për Ungjillin që nuk mund t'i mësojmë vetëm nëpërmjet eksperiencës. Ne kemi nevojë që fjala e Perëndisë të na mësojë.

Kjo është një arsye se përse, kur lexojmë për Zotin Jezus në Ungjijtë, ai shpesh gjendet duke *mësuar të tjerët*. Kur njerëzit i adresoheshin atij, ata i drejtoheshin si 'Mësues', jo thjesht nga respekti për të, por sepse ai i mësonte rregullisht për Perëndinë dhe njeriun, dhe e bënte këtë (ndryshe nga mësuesit e tyre të zakonshëm) *si një që ka autoritet* (Mat. 7:29). Shpëtimtari Jezus është gjithashtu edhe Mësuesi Jezus. Ai erdhi për të qenë Prifti dhe Mbreti i popullit të tij, për t'u flijuar për ta dhe për të mbretëruar mbi ta; por ai erdhi gjithashtu edhe si Profeti i tyre, dhe për t'u folur dhe mësuar atyre fjalën dhe të vërtetën e Perëndisë. Prandaj, për këtë arsye një pjesë e madhe e regjistrimit të Ungjillit për jetën e tij merret me atë që ai tha. Ai bëri predikime, tha shëmbëlltyra dhe ua tregoi mënyrën e zbatimit. Ne lexojmë për të se *ai hapi gojën dhe i MËSOI...* (Mat. 5:2, përkthim i fjalëpërfjalshëm).

Kur lexojmë për suksesin e kishës së hershme dhe ungjillizimin e saj, ne zbulojmë të njëjtin theksim. Apostujt shkuan kudo duke mësuar dhe predikuar. Pali ua përshkruan shërbimin e tij në Efes pleqve të kishës

së atjeshme, në lidhje me *mësimin* e tij publik dhe privat (Vep. 20:20). Në Letrat gjendet vazhdimisht i njëjti theksim (Kol. 1:28). Populli i Perëndisë ka nevojë të mësohet, dhe burimi i mësimit të tyre është Shkrimi i Shenjtë.

Po mirë, do të themi ne, pse është kaq i rëndësishëm ky mësim? Pse kjo thirrje e vazhdueshme drejtuar mendjes së të krishterit? Për këto pyetje ka të paktën tri përgjigje të rëndësishme.

Së pari, Dhiata e Re na thotë, se nga natyra, mendjet tona janë të errësuar dhe është e nevojshme që t'i ndriçojë drita e ungjillit (Gjoni 12:35; Rom. 1:21; Efes. 4:18, 5:8). Kur bëhemi të krishterë, ne hyjmë në dritë dhe fillojmë të ecim në të (Efes. 5:8 e sipër; 1 Gjoni 1:7). Por, sigurisht që dritës së ungjillit i duhet kohë për të depërtuar në jetët tona dhe për të larguar gjithë errësirën. Si të krishterë ne vazhdojmë të kemi mendime për të cilat na vjen turp nga vetja. Ne kemi edhe qëndrime të cilat janë të keqinformuara, të shtrembëruara dhe nganjëherë edhe të mëkatshme. Nganjëherë, fatkeqësisht, e shohim veten në pozitën e hebrenjve të cilët kishin nevojë që t'u mësoheshin përsëri parimet kryesore të fjalës së Perëndisë (Heb. 5:12).

Së dyti, ka kohë kur mendjet tona *mashtrohen*. Mund të kemi mendime të gabuara për Krishtin, për shembull. Mund të besojmë se disa veprime janë të mëkatshme, kur në fakt, Bibla i cilëson ato si të ligjshme. Mund ta lidhim ndërgjegjen tonë me një lloj veprimi dhe vetëm më vonë të zbulojmë se kryerja e tij tregon një mospërputhje me rrëfimin tonë të Krishtit. Prandaj dhe Dhiata e Re na paralajmëron vazhdimisht për rrezikun e të qenit i mashtruar. Ne mund të mashtrohemi nga pasuritë (Marku 4:19), nga njerëzit (2 Thes. 2:3), nga vetja jonë (1 Kor. 3:18; Jakobi 1:22), nga mëkati (Rom. 7:11; Heb. 3:13), dhe nga Satani (Zbulesa 12:9, 20:3,8,10). Prandaj shkrepet paralajmërimi: mos u mashtroni (Mat. 24:4; 1 Kor. 6:9, 15:33; Efes. 5:6; Gal. 6:7).

Ky paralajmërim është i rëndësishëm. Mëkati nuk do të mund të kishte një hyrje kaq të gatshme në jetën tonë nëse nuk mund të shfaqej i maskuar! Në fund të fundit, ishin kënaqësitë e mëkatit ato, të cilave iu ktheu kurrizin Moisiu (Heb. 11:25), dhe ai ishte i aftë ta bënte këtë sepse e dinte mirë se sa do të zgjasnin ato. Perëndia i kishte mësuar atij se ato ishin kalimtare.

Xhon Ouen, shkrimet masive të të cilit shfaqin një njohuri të psikologjisë së mëkatit e cila nuk është arritur ndoshta kurrë deri tani, e përshkroi aftësinë mashtroese të mëkatit në një mënyrë të pazakonshme por të vërtetë:

Tani mëkati, kur ushtron trysni mbi shpirtin... përdor një mijë e një kurthe për t'ia fshehur atij tmerrin e Zotit, fatin e shkeljeve, dhe veçanërisht të asaj marrëzie të veçantë së cilës ai ia fton mendjen. Për fshehjen e tij kanë për t'u përdorur *shpresat e faljes, pendimi i ardhshëm, këmbëngulja e tanishme* e epshit, *rastet dhe mundësitë, befasia, përligjja* e mëkatit, *drejtpeshimi i përgjegjësive, vendime të dëshpëruara* për të rrezikuar jashtëzakonisht duke hyrë në shijimin e epshit në kënaqësitë dhe përfitimet e tij. Ka një mijë e një kurthe që nuk mund të rrëfihen.

(Veprat VI:249)

Kur jemi nën një presion të tillë (dhe ne të gjithë vihemi në disa prej këtyre presioneve), nuk mund të na mbrojë vetëm thjesht njohuria e Biblës. Por, pa atë njohuri nuk ka për të patur fare mbrojtje. Nëse nuk e përdorim shpatën e Frymës e cila na aftëson për ta demaskuar mashtrueshmërinë e mëkatit, atëherë beteja për t'i shërbyer Krishtit do të humbet pa goditur as dhe një grusht në mbrojtjen tonë. Por nëse kemi mësuar nga mësimi i Shkrimit për t'u ruajtur, për të dalluar të vërtetën nga e rremja, të drejtën nga e gabuara, të mirën nga e keqja, Perëndinë nga Satani, atëherë ne do të mundim të qëndrojmë ***në dütën e mbrapshtë***, dhe në fund të saj të jemi ende në këmbë (Efes. 6:13).

Së treti, mendja është çelësi i jetës së krishterë. Nëse mendjet tona janë të plogështa dhe pa jetë, atëherë jeta jonë si të krishterë ka për të pasqyruar këtë gjë. Nëse mendjet tona janë plot me mendime për Krishtin, atëherë, përkatësisht, jeta jonë do të tregojë se ai është në qendër të vëmendjes sonë dhe se ne jetojmë për të. Por ka vetëm një burim në dispozicionin tonë prej të cilit të mund të marrim informacion për Jezusin. Ka vetëm një libër i cili na mëson në mënyrë të autoritetshme për Jezusin; një libër përmes të cilit ai ka premtuar të flasë me një zë të gjallë. Nëse mendja është 'çelësi' i cili hap jetën e krishterë, ai duhet të futet në 'kyçin' e Shkrimit. Ai duhet të 'pritet' sipas kësaj forme. Ne ngutemi që të kemi të njëjtën mendje që ishte në Krishtin Jezus (Fil. 2:5). Vetëm në Shkrim udhëzohemi për llojin e këtij qëndrimi.

Bindje

Disa të krishterë duket ta përdorin shumë Biblën për bindje [në origjinalin greqisht, fjala ka kuptimin qortim për bindje] - zakonisht për të

qortuar të tjerët! Por, nuk është kjo ajo që Pali ka ndër mend të thotë këtu. Ai po i shpjegon Timoteut se nëpërmjet Shkrimit Perëndia na qorton, ose na gjykon kur kemi nevojë për qortimet e tij!

Bibla jo vetëm që na e udhëzon mendjen; ajo prek ndërgjegjen tonë. Fjala 'qortim për bindje' është e njëjta fjalë e cila përshkruan shërbimin e Frymës së Shenjtë në Gjonin 16:8-11. Ai e fajëson, apo e bind botën për mëkatin, për drejtësi dhe gjykim, me qëllim që t'i bëjë njerëzit të ndërgjegjshëm për nevojën e tyre për Krishtin, dhe për Krishtin si plotësimin e nevojës të tyre. Kjo është mënyra sesi Bibla është e aftë të të bëjë *të ditur për shpëtimin me anë të besimit që është në Krishtin Jezus* (2 Tim. 3:15).

Është një gjë e mrekullueshme të qortohesh prej Perëndisë. Ne e dimë se ai nuk e bën këtë për qejfin e tij. Ai nuk është inatçi, por i shenjtë. Ne e dimë gjithashtu se fjala e tij është e vërtetë, dhe për të mirën tonë. Qortimin tonë në mënyrë publike ai e përdor vetëm si mjetin e fundit. Ai preferon të punojë në mënyrë të fshehtë dhe të qetë, dhe gjithmonë thellë dhe me rrënjë. Prandaj është një privilegj i madh që kemi një Bibël të hapur dhe liri për t'u lutur pa ngacmim. Ne mund t'ia ekspozojmë veten dhimbjes së butë të Qortuesit Hyjnor i cili është gjithashtu edhe Dashuruesi Hyjnor.

Në studimin tonë personal të Biblës, dhe në mënyrën që ne dëgjojmë mësimin e fjalës së Perëndisë, normalisht duhet që të kemi në mendje pyetjen: A ka ndonjë fjalë qortimi për mua në këtë pasazh të Shkrimit? A po prek Perëndia ndonjë zonë të ndjeshme (apo të desensibilizuar) të ndërgjegjes sime, me qëllim që të më kthejë në atë lloj miqësie që kam njohur më parë me të? Prandaj dhe Çarlz Uezli i mësoi Metodistët (dhe të gjithë ndjekësit e Zotit) të luteshin kështu:

Ndërsa lexojmë orakujt e tu tani
Me lutje t'sinqertë e të fortë dëshir'
Fryma jote e Shenjtë le të punojë
Shpirtrat të na i zgjojë e frymëzojë
Hiqe errësirën, dobësinë tonë ndihmo
Dhe në dritë të hirit ti na udhëzo!

Kurdo që të endemi në rrugët e mëkatit
E Zotin e gjallë nga mëkati të harrojmë
Me Fjalën tënde zgjo ndërgjegjen tonë

Bindi dhe ktheji endacakët pas
Të plagosur thellë nga shpata e Frymës
Dhe të shëruar nga balsami i Gileadit më pas.

Ndreqje

Për shumicën e njerëzve idetë që përçojnë fjalët ‘qortoj’ dhe ‘ndreq’ janë shumë të ngjashme. Shpesh ne i përdorim këto fjalë si sinonime. Por shprehjet që përdor Pali përçojnë ide të ndryshme.

Kemi vërejtur se ‘qortoj’ do të thotë bind (për mëkatin), dhe është përdorur në këtë kuptim edhe në pjesët e tjera të Dhiatës së Re. Por fjala ‘ndreq’ është ajo që studiuesit e gramatikës quajnë *hapaks legomenon* (‘e thënë vetëm një herë’, siç e kishte zakon të thoshte mësuesi im i klasikëve në shkollë): nuk ka shembull tjetër të përdorimit të saj në Dhiatën e Re.

Fjala e Palit është shumë interesante. Ajo është përdorur në versionin greqisht të Shkrimeve të Dhiatës së Vjetër në kuptimin e riparimit të diçkaje që ka nevojë të ndreqet apo rindërtohet. Është e njëjta rrënjë greke prej së cilës marrim shprehjet tona ‘ortodontia’ (që ndreq parregullsitë e dhëmbëve), ‘ortopedika’ (që ndreq apo kuron deformimet te fëmijët). Fjala greke është *orthos*, që do thotë drejt. Kështu, kur flasim për ‘ortodoksinë’ e dikujt ne kuptojmë se pikëpamjet e tij (*doksa*, një opinion, pikëpamje) janë të rregullta, të drejta. Ndoshta do të bënim mirë të kujtonim përdorimin mjekësor kur mendojmë se Shkrimi na bën ‘ortodoksë’ në këtë kuptim origjinal. Kjo nuk do të thotë se ne jetojmë një jetë e cila lë një shije të keqe në gojën e të tjerëve! Mjerë ne dhe ata nëse është kështu. Por, ajo do të thotë se mendjet tona janë shëruar nga e vërteta e Perëndisë, se doktrina jonë është e ‘qëndrueshme’, pra: *e shëndetshme* (1Tim. 1:10; 2 Tim. 1:13; Tit. 1:9,13; 2:1,2).

Me fjalë të tjera, vlera e Shkrimit është se ai shëron dhe pastron ndjenjat dhe emocionet tona. Ai e restauron jetën tonë të thyer në një gjendje të shëndetshme shpirtërore dhe vitaliteti. Bibla na fut në formë! Prandaj dhe qëllimi i katërt i saj është ‘edukimi’.

Edukim në Drejtësi

Në jetën e zakonshme ne e sjellim veten në formë duke bërë ushtrime stërvitore; ne duhet të futemi në stërvitje.

Dhe tani, në momentin e shkrimit të këtij libri, unë po përpiqem (përsëri!) ta sjell veten në një formë më të mirë fizike. Pranë meje kam librin e famshëm të Keneth Kuperit (Kenneth Cooper) *Aerobia* (Kapaku thotë 'Dy milionë kopje të shtypura!'). Po bëj të pamundurën për të kuptuar se *përse* trupi im ka nevojë për ushtrime, dhe pastaj me kujdes të vë në praktikë këshillën që jep ai. Ai më tregon se sa i shëndetshëm do të jem - dhe më paralajmëron se sa jo i shëndetshëm mund të jem tani. Ai shpjegon se sa më të forta kanë për të qenë mushkëritë, zemra dhe nervat e mia nëse i nënshtrohem programit të stërvitjes. Dhe tek po bëj këtë, dhe siç më paralajmëroi dhe ai, po shoh se sa jashtë formës jam. Gjatë ndjekjes së ushtrimeve, unë kam ndier më shumë djersitje dhe dhimbje në muskuj sesa e prisja! Por, programi vazhdon, dhe unë e vazhdoj me ngulm. Ushtrimi bëhet më i lehtë, dhe 'pengesa e dhimbjes' me sa duket po zhduket. Unë filloj të përpiqem më me lehtësi, dhe t'ia dal të kapërcej pengesa të tjera. Kështu shpresoj se po përfiton e gjithë qenia ime! Motoja është '*Ushtrohu*, në do të jesh i shëndetshëm!'.

Tani, kjo nuk është më pak e vërtetë për jetën në Frymë. Fryma e Perëndisë dëshiron të na sjellë 'në formë' nga ana shpirtërore. Më saktë, ai dëshiron të na sjellë ne 'në formën' që kishte Krishti. Të gjitha urdhërimet e Perëndisë thonë: ji si Jezusi! E gjithë puna e Perëndisë ka këtë qëllim: të na bëjë si Jezusi. Fjala e Perëndisë është palestra në të cilën ne fillojmë të vihem në një formë të vërtetë shpirtërore për të shijuar një jetë të plotë si të krishterë. Në 1 Tim. 4:6-8 nënkuptohet kjo gjë. Pali i thotë mikut të tij në moshë të re se ushtrimi trupor ka pak vlerë, por ushtrimi shpirtëror ka përfitime të përhershme. Kështu, thotë ai, ***ushtrohu në perëndishmëri***. Folja që ai përdor ka rreth saj një tingëllim të njohur. Ajo është *gymnazo* - 'hyr në gjimnazin e Biblës' po thotë ai: 'zhvishu pak për të vepruar'. Futju një programi edukimi!

Ky është një premtim i jashtëzakonshëm, dhe një inkurajim për ne që t'i përkushtohemi studimit të Biblës. Sapo të kuptojmë bekimin që ajo na sjell dhe ndikimin që ajo ka për të patur në karakterin dhe jetesën tonë, ne duhet të entuziazmohemi. A nuk duhet të turpërohemi ne kur shohim atletë të të gjitha niveleve të cilët kushtojnë qaq shumë kohë dhe energji për ta sjellë veten në formë për të fituar kurora të prishshme lavdie? Le të edukohemi dhe të stërvitemi për çmimin e paprishshëm. Dhe, 'Fillo të stërvitesh në fjalë *tani*,' i thotë shokut të tij në moshë të re, Timoteut, Pali, 'përpara se ta humbasësh formën shpirtërore, dhe të mos kesh fuqi të fillosh!'

Qëllimi i fjalës së Perëndisë është të na mësojë, bindë, ndreqë dhe edukojë në rrugën e jetës. Por çfarë efekti ka ajo?

Efekti i Biblës

Para pak vitesh u botua një libër që përmbante mesazhe prej udhëheqësit të madh të krishterë nga Kina Ni To-Sheng (ose siç njihet më shumë Uoçmen Ni). Ai kishte titullin tërheqës *Punëtori Normal i Krishterë*. Me një fjalë kjo është mënyra që Pali shpjegon studimin e Biblës. Ajo i bën burrat dhe gratë e Perëndisë ‘normalë’. Kjo është në të vërtetë dhe kuptimi i fjalëve **tërësisht i pajisur**.

Shprehja që përdor Pali vjen nga fjala për plotësi dhe normalitet, ‘gjërat ashtu siç duhet të jenë’. E njëjta rrënjë rishfaqet në Markun 1:19, për të përshkruar dishepujt duke ndrequr apo ‘përgatitur’ rrjetat e tyre - duke qepur vrimat, duke i pastruar dhe palosur për t’i përdorur të nesërmen natën. Përsëri kjo rrënjë përdoret në thënien e Palit që shërbimet e fjalës që Krishti i kishte dhënë kishës kanë synimin e madh të përgatitjes së njerëzve të Perëndisë për punë shërbimi (Efes. 4:12).

Pali do të thotë këtë. Ne vëmë re disa të krishterë, dhe themi me vete: Ç’shembull i përkryer që është filani! Ai është pikërisht ai lloj i krishterë që duhet të jem dhe unë. Por kur shohim Jezusin, ne e kuptojmë se ai është njeriu i vetëm i cili ka qenë me të vërtetë ‘normal’. Në krahasim me të, ne jemi të gjithë jonormalë. Megjithatë Perëndia ka një plan për të na kthyer në normalitetin shpirtëror të Krishtit. Ai na merr ne, me anë të fjalës që na ka dhënë (dhe shërbimeve të saj të ndryshme që ai i ka dhuruar kishës), dhe ashtu si dishepujt e ulur në breg të Galileës, ai fillon me durim të riparojë dhe rregullojë jetët tona, derisa të bëhemi të përshtatshëm, ‘tërësisht të pajisur’, ‘me të gjitha pajisjet e duhura’ për shërbimin e mbretërisë së tij.

Nuk është kurrë e tepërt të theksohet se, edhe kur Perëndia mund të punojë me rrënjë dhe papritmas në jetën tonë nëpërmjet çdo lloji krizash (dhe nëse ai vepron kështu ne duhet t’i përulemi urrejtësitë së tij), kjo nuk është kënaqësia e tij më e madhe. Puna e tij është zakonisht më e fortë në jetën tonë kur ai ka marrë kohë për të punuar thellë dhe plotësisht. Ai punon në këtë mënyrë në ne nëpërmjet Shkrimit.

Për mua nuk ka vizion më të qartë për ta patur parasysh gjatë punës sime për studimin e fjalës së Perëndisë sesa historia e cila e tregon Perëndinë si Rafinuesin e popullit të tij:

Dikush po vëzhgonte një herë një rafinues argjendi i cili po nxehte dhe po rafinonte me durim metalin e çmuar që kishte përpara. Pasi e vëzhgoi punën e tij plot durim për një kohë të gjatë, vëzhguesi e pyeti: 'Sa ke për të punuar dhe pritur me durim për ta rafinuar këtë metal të çmuar?' Rafinuesi iu përgjigj: 'Derisa të mund të shoh në të pasqyrimin tim.'

Ky duhet të jetë vizioni ynë për atë që Perëndia po bën në ne nëpërmjet leximit dhe bindjes ndaj fjalës së tij, kështu që lutja jonë të jetë: 'Vazhdo të punosh, o Rafinues i Madh, derisa të shihet në mua shëmbëllimi i fjalës sate të gjallë, ndërsa unë lexoj fjalën tënde të shkruar.'

Mësimet e shenjta të hirit tënd

Që Fjala jote transmeton, përsërisin

Dhe në gjithë rrugët e tua na stërvisin

Për të plotësuar në ne vullnetin tënd;

Planin shpengues të dashurisë sate plotëso

Dhe njerëz të përkryer na bëj.

Të furnizuar me thesarin tënd

Qëndrofshim gjithmonë gati

Për të ndihmuar shpirtrat që ti ke shpenguar

Siç kërkojnë situatat e tyre të ndryshme

Për të bindur, ndrequr, qortuar dhe mësuar

Dhe në më të shenjtën dashuri për t'i ndërtuar!

(Çarlz Uezli)

7 Fara ka Nevojë për Tokë

Në një rast, Jezusi u lëshoi një fjalë shumë domethënëse paralajmëruese atyre që dëgjonin mësimin dhe predikimin e tij. Ai tha: ***Tregoni kujdes se si dëgjoni*** (Lluka 8:18).

Shumë prej nesh kanë të ndërtuara instinkte të forta në jetën e tyre si të krishterë nga një thënie e ngjashme që ka thënë Jezusi. Sepse ai paralajmëroi gjithashtu që të jemi të kujdesshëm se *çfarë* dëgjojmë (Marku 4:24). Këto dy thënie të ndryshme ia vlen të krahasohen. E dyta na inkurajon për të ushtruar një aftësi dalluese në lidhje me vërtetësinë apo falsitetin e mësimin që na jepet. Ajo na ngarkon që ta shqyrtojmë atë që thonë të tjerët. Por thënia e parë ka një rol tjetër në eksperiencën e të krishterit. Ajo i thotë atij të shqyrtojë vetveten; ta pyesë veten nëse është ai apo jo në rregull me Perëndinë dhe vullnetin e tij nëpërmjet zbulësës që ai i bën vetes në fjalën e tij.

Kapitujt e kaluar janë marrë me këtë pyetje të të qenit të kujdesshëm se si e dëgjojmë fjalën e Perëndisë - për veten tonë në studimin personal të Biblës, dhe për të tjerët që ne mund të mësojmë. Ka disa mënyra të studimit të Biblës të cilat janë, më shumë se të tjerat, në përputhje me atë se çfarë është Bibla dhe mesazhi që ajo përmban. Të qenët të kujdesshëm se *si* dëgjojmë na detyron që t'i mendojmë thellë këto probleme. Por ka, pa dyshim, edhe një nivel tjetër në të cilin duhet të shqyrtojmë se ç' do të thotë ta dëgjosh fjalën e Perëndisë. Sepse leximi i Biblës nuk është thjesht një çështje mendore. Si mund të jetë i tillë, kur Bibla është një libër i frymëzuar nga Fryma dhe i caktuar për të prekur jetët tona me praninë e Perëndisë? A mos është vallë qëllimi ynë të ndryshohemi dhe të bëhemi më shumë si Krishti nëpërmjet leximit të fjalës së Perëndisë? Atëherë ne duhet të përpiqemi gjithashtu për të zhvilluar në jetën tonë ato lloje cilësish shpirtërore të cilat na aftësojnë për të dëgjuar zërin e Perëndisë me një qartësi gjithnjë e më të madhe dhe për të jetuar në bindje ndaj saj.

Për ta ilustruar këtë pikë, Jezusi tha një shembëlltyrë. Në fakt, ai tha atë që mund të quhet *shembëlltyra* në këtë kontekst. Herët në shërbimin

e tij, ai tregoi se ata që dëgjojnë fjalën e Perëndisë mund të ndahen në një numër kategorish të ndryshme ‘dëgjuesish’. Ai përshkroi karakteristikat e secilës kategori dhe shpjegoi ato gjëra në jetën dhe zemrën e njerëzve që i fuste ata në këto kategori.

Nga të katër llojet e ‘dëgjuesve’ të fjalës së Perëndisë vetëm një lloj e mirëpret në mënyrë të qëndrueshme hirin e Perëndisë dhe ngulmon në të - edhe kur predikuesi është vetë Zoti Jezu Krisht! Ky do të kishte qenë një mendim mjaft solemn nëse Jezusi do ta kishte shprehur nga fundi i shërbimit të tij kur shumicat e njerëzve kishin filluar të largoheshin prej tij. Por në fakt fjalët e Zotit tonë, të thëna kaq shpejt në shërbimin e tij, parashikuan qartë se në këtë mënyrë do të ndodhnin gjërat.

Shumë të krishterë janë më të mirë për të patur kujdes se *çfarë* dëgjojnë sesa se *si* dëgjojnë. Por dallimi i mësimit të rremë nuk është aspak e njëjta gjë me dëgjimin e bindur dhe të frytshëm të së vërtetës. Ne duhet ta pyesim shumë veten se ku qëndrojmë ne në këtë çështje. Këtë mund ta bëjmë tani me ndihmën e mësimit të Zotit tonë në shëmbëlltyrën e mbjellësit dhe tokërave. Pyetja me të cilën përballohem i është: Ç’lloj toke është jeta jote për farën e fjalës së Perëndisë?

Kur fermeri izraelit dilte për të mbjellë drithërat e tij, skena ishte tërësisht e ndryshme nga ajo që rrethon fermerin e sotshëm të botës perëndimore. Ky fermer nuk ishte ekspert në makinerinë bujqësore, shkencën e bujqësisë, llogarimbajtje dhe një mijë e një gjëra të tjera. Ai ishte një fermer i thjeshtë. Makinaria e tij ishte një çantë e vogël, dhe lëvizshmëria e tij varej plotësisht nga dy këmbët e tij! Ai ecte përgjatë fushës dhe e hidhte farën në formë rripash. Por ai *dinte* diçka për ekonominë praktike. Ai e dinte se jo e gjithë fara kishte për të gjetur vend në tokë të mirë. Një pjesë e saj do të binte përgjatë rrugës; një pjesë tjetër do të binte pa dyshim në tokën e cekët e cila e mbulonte fare pak gurin gëlqeror poshtë saj - në të vërtetë ai mund ta shihte gurin gëlqeror të dalë aty-këtu; dhe një pjesë tjetër do të binte nëpër farat e ferrave të cilat do të rriteshin dhe do ta mbytnin grurin.

Tërë këtë ai e dinte. Por, e dinte gjithashtu se ishte praktikisht e pamundur ta shmange atë. Nëse do të shkonte për të shpërndarë farën, ai e dinte se një pjesë e saj, e farës së tij të mirë, nuk kishte për t’i dhënë kurrë rendimentin që priste. Inkurajimi i tij më i madh ishte se shumë fara mund të binin në tokë të mirë dhe do të prodhonin të korra, ndoshta të dhjetëfishta, të cilat do ta kënaqnin.

Por edhe gjatë qarkullimit të këtyre mendimeve në mendje, fermeri do të shikonte zogjtë që lëshoheshin në rrugë për të marrë farën e rënë

atje pak çaste më parë. Gjatë rrugës për në shtëpi - për t'u kthyer më vonë me plugun e tij të vogël (sepse mbjellja bëhej përpara plugimit në Izrael) - ndoshta ai mendonte se fara e rënë në tokë të cekët do të fillonte të rritej për një kohë të shkurtër. Ai as nuk do ta plugonte atë tokë. Sa ndryshe kishte për të qenë jeta sikur fara e mirë të prodhohej po aq shpejt sa dhe në tokën e cekët! Ai mund ta bënte llogarinë me gishta: 'Nëse një farë do të jepte një fryt të dhjetëfishtë, dhe sikur të mundja të prodhoja drithëra sa dyfishi i atyre që kam tani, sa përqind rritje do ta kisha nga fitimi? Sa do të rritej tatimi? Do ta ndërtonim dot një shtëpi të re për pesë vjet?' Pastaj ai do të zgjohej nga ëndrra e tij me sy të hapur. Ai e dinte nga eksperiencia e tij e gjatë se sa jetëshkurtër kishte për të qenë fara e mbjellë në tokën gëlqerore. Kjo gjë mund ta bënte të mendohej nëse mund të bënte gjë rreth tokës me gjemba që do ta aftësonte t'i rriste fitimet. Me këto mendime në kokë pluguesi morri rrugën për në shtëpi.

Çdokush prej dëgjuesve të Jezusit në atë ditë e njihte mirë situatën që përshkroi ai. Shumë prej tyre e dinin nga vetë eksperiencia e tyre. Si dëgjuesit e predikimeve sot, ata ndoshta u larguan kohë pas kohe me mendje, duke përfytyruar fushat e tyre, dhe duke buzëqeshur në përgjigje të përshkrimit të Jezusit ndërsa kujtonin një incident që shkonte në mënyrë të përkryer me atë që po thoshte ai. Disa prej tyre u kthyen ndoshta në shtëpi për të ndarë kujtime 'kohët e shkuara' kur edhe ata kishin shpërndarë farë dhe pluguar tokën. Disa u larguan, pa dyshim, duke u menduar se çfarë ishte pikërisht ajo që ishte përpjekur të thoshte Jezusi. Do të kishte disa të tjerë të cilët lëviznin rreth e rrotull në turmë ndërsa ajo shpërndahej, duke u thënë shokëve të tyre me gjallëri se shih se ç'njeri i mrekullueshëm është Jezusi, dhe ç'predikues fantastik! Gjithashtu, disa, dukeshin të jetonin një jetë krejt të ndryshme kur shkuan në shtëpi, dhe këtë e vunë re edhe fqinjët. Por ajo zgjati vetëm disa muaj, derisa gjërat filluan të ndryshonin, dhe ndjekja e Jezusit u bë një mënyrë jetese tepër kërkuese. Shpejt, entuziazmi i tyre filloi të dobësohet. Por pati disa, dhe ata dolën se ishin shumë, që panë se ajo që kishte thënë Jezusi filloi t'ua ndryshojë gjithë jetën. Ata nuk mund të ishin më të njëjtit burra dhe gra - dhe nuk u bënë më!

Nuk mund t'i shpëtohet faktit se njëra prej çështjeve më vendimtare në studimin e Biblës është prirja, fryma, zemra me të cilën ne vijmë për ta lexuar apo dëgjuar atë. Pra, pyetja e gjithërendësishme bëhet: **Ç' lloj dëgjuesi i fjalës së Zotit jam unë? Cili lloj toke në shëmbëlltyrën e Zotit tonë e ilustron më mirë jetën time? A mos jam unë si rruga, apo toka gëlqerore, apo ndoshta si toka me ferrishte? Ose a është zemra ime një tokë e mirë për Mbajllësin që ai të mbjellë farën e fjalës së jetës?**

Fara e Mbjellë Përgjatë Rrugës

Llojet e ndryshme të tokës në shëmbëlltyrën e Jezusit në mënyrë të qartë kanë për qëllim të përfaqësojnë llojet e ndryshme të dëgjuesve të fjalës së Perëndisë. Por zbulojmë se gjatë eksperiencës sonë në kohë të ndryshme ne u përshtatemi kategorive të ndryshme. Nuk është e pamundur që fara e varfër të pastrohet nga barërat e këqija, apo që fara e mirë të mbushet me barëra të këqija. Çështja e vërtetë është: Cila është gjendja ime e tanishme e zemrës ndërsa unë i afrohem mesazhit të Biblës?

Disa prej nesh janë si rruga. Fjala e Perëndisë në zemrat tona është si fara që shtrihet mbi sipërfaqen e fortë të rrugës së shkelur mirë. Ka vetëm pak mundësi që asaj t'i jepet ndonjëherë mundësia që të depërtojë në mënyrë që të krijojë një karakter të fortë dhe të qëndrueshëm të krishterë. Nga fortësia e rrugës është e lehtë për zogjtë që të lëshohen dhe ta marrin farën. Kështu, në jetën e frymës, Jezusi shpjegon se djalli turret dhe vjedh farën e çmuar të fjalës prej mendjeve të njerëzve, dhe ajo nuk ka efekte të hirit në jetën e tyre. Martin Luteri tha njëherë se megjithëse ne nuk mund t'i ndalim zogjtë që të mos fluturojnë rreth nesh, ne duhet të jemi të aftë për t'i ndaluar që të mos i bëjnë foletë mbi kokat tona! Nëse e kuptojmë se të qenët fëmijë i Perëndisë do të thotë të jesh edhe ushtar në një luftë shpirtërore, ne kemi nevojë të mësojmë ta mbajmë larg djallin. Ne kemi nevojë të njohim se cilat janë ato dobësi të veçanta të cilat na e shkatërrojnë mbrojtjen ndaj tij. Jezusi është Mësuesi ynë për këtë, dhe ai e vendos gishtin në dy gjëra të veçanta.

Padituria

Arsyeja që fjala e Perëndisë mund të lërë kaq pak përshtypje në jetën tonë mund të jetë ngaqë ne nuk e kuptojmë (Mat. 13:19). Nganjëherë, në Bibël mund të gjejmë gjëra që e kemi të vështirë për t'i kuptuar: Simon Pjetri e pranoi këtë (2 Pjetrit. 3:16). Nganjëherë, mund ta kemi të vështirë të ndjekim atë që u tha në një studim biblik, apo fjalim a predikim. Por ky mund të jetë jo faji ynë, por i folësit! Por Jezusi nuk po flet për këtë lloj mos të kuptuari. Padituria për të cilën ai flet shtrihet së pari në zemër, jo në mendje.

Shëmbëlltyra e tij është një ilustrim i kësaj gjëje. Nuk do shumë mend për ta kuptuar. Por, megjithëse dishepujt nuk ishin aspak njerëz të trashë ata rrëfyen se nuk mund ta kuptonin atë! Kjo mosaftësi nuk ishte

nga mungesa e arsimimit të tyre, por nga mungesa e ndjeshmërisë dhe të kuptuarit shpirtëror. Dhiata e Re e quan këtë skleroza e zemrës (*sklerokardia*, Marku 10:5, 16:14), një ngurtësim të zemrës që prodhon një mosinteresim, dhe një paaftësi për të kuptuar mesazhin e ungjillit.

Kjo ishte një ndër karakteristikat më të dukshme në jetën e kaluar të Palit. Perëndia pati mëshirë për të, megjithëse ai e kishte persekutuar kishën, sepse ai e kishte bërë këtë gjë nga padija (1 Tim. 1:13). Ai e njihte mirë mesazhin e Biblës. Njohuria e tij e përmbajtjes së saj ia kalonte shumë çdo çifuti të zakonshëm të asaj kohe. Megjithatë, në zemrën e tij kishte një lloj perdeje kurdoherë që ai lexonte Dhiatën e Vjetër (krah. 2 Cor. 3:15). Ai nuk e kuptonte se ajo u tregonte njerëzve mëkatshmërinë dhe nevojën e tyre për një Shpëtimtar! Vetëm nëpërmjet punës së Frymës së Shenjtë në zemrën e tij (Rom. 7:7-13) ai zbuloi më në fund të vërtetën për veten e tij, për Perëndinë, dhe për Krishtin. Historia e tij mund të shumëfishohej në raste të panumërta.

Kjo sklerozë e zemrës është një gjendje prej së cilës asnjë prej nesh nuk është i imunizuar në mënyrë të përhershme. Biografite e të krishterëve të mëdhenj përgjatë shekujve dëshmojnë për faktin se sa më shumë që rritemi në hir aq më shumë bëhemi më të ndërgjegjshëm se ende mbetet një cilësi e llojit të rrugës në mënyrën se si ne e lexojmë dhe dëgjojmë fjalën e Perëndisë.

Sot, kur lexojmë një pjesë nga fjala e Perëndisë, dhe nesër, kur dëgjojmë mësimin e saj, ajo mund të sjellë pak fryte pasi zemrat tona janë ftohur dhe ngurtësuar. Ne nuk po i lejojmë vendin e nevojshëm që ajo të punojë për të na ndryshuar jetën. Ne duhet të vijmë te Perëndia me lutje, të rrëfejmë nevojën tonë, ta falënderojmë Atë që ka filluar të na bëjë të ndërgjegjshëm për të, dhe t'i lutemi Atij që të na aftësojë për t'iu përgjigjur më me gëzim dhe më plotësisht asaj që lexojmë dhe dëgjojmë. Është sigurisht një ndër gabimet më të mëdha të pretendojmë se zemra jonë është përherë në një gjendje të tillë përpara Perëndisë që e bën atë tokë të përshtatshme për farën e fjalës së tij. Këtë pretendim e përgënjeshtrojnë pafuqishmëria jonë e vajtueshme shpirtërore. Ne kemi nevojë për hirin e tij *kurdoherë* që ne vijmë te fjala e tij.

Mendësia e botës

Kjo është gjëja e dytë të cilës i referohet Jezusi. Pse është rruga një mbajtëse kaq e papëlqyer për farën? Ngaqë fara shtrihet mbi rrugë, këmba

pas këmbë ajo shkelet. Problemi, pjesërisht, është se ajo shkatërrohet nga trafiku i botës së përditshme që shkel mbi të; **u shkel** (Lluka 8:5) thotë Jezusi.

A po lexojmë më shumë se ç'është thënë në këto fjalë kur krahasojmë rrugën me gjendjen në zemrat e shumë njerëzve? Presionet e zakonshme, legjitime të shoqërisë në të cilën jetojmë, bashkë me nxitimin dhe ngutën e saj, mund ta shtypin kaq lehtë fjalën e Perëndisë gjithnjë e më në periferi të preokupimeve tona, derisa ndikimi i saj në jetën tonë të shuhet pothuaj plotësisht.

Ka disa njerëz për të cilët këmbët që shkelin përgjatë rrugës janë ato që i përkasin botës së veprimtarisë së përditshme të krishterë. Sa prej nesh, për shembull, janë kaq të zënë me punën e krishterë sa që fjala e Perëndisë është katandisur në një qoshe të rutinës sonë? Nuk do të mendonim kurrë ta quanim atë 'mendësi e botës', por ajo është pikërisht e tillë. Por paradoksi është se edhe të lexuarit e Biblës pa bërë asgjë tjetër mund të jetë gjithashtu mendësi e botës, që i ka rrënjët në një refuzim për t'ia konformuar jetën tonë mësimi të Shkrimit i cili na dërgon përherë nga leximi i Biblës që të jemi kripë dhe dritë në shoqëri! Mendësia e botës është një kameleon në zemër, dhe mund ta fshehë veten kundër shumë mjediseve.

Por, çfarë është në të vërtetë kjo mendësi? Ajo është, sigurisht, konformimi i mënyrës së të menduarit dhe jetesës sonë me normat e kësaj bote, në vend të normave të botës në të cilën jeton Perëndia. Ajo është bërja e diçkaje tjetër përveç Biblës rregullën e jetës sonë. Është zhvillimi i një mënyre të jetuari i cili në thellësi ka parime të ndryshme nga mënyra e jetesës së një dishepulli të Jezusit. Rezultati është se kur ne vijmë për të lexuar Biblën nuk harmonizohemi fare me të. Ne sjellim para saj idetë tona paraprake, dhe bëhemi kështu të paafte për të dëgjuar atë që ka për të na thënë me të vërtetë.

Kur vijmë për të lexuar Biblën, pra, ne duhet t'ia rrëfejmë këtë Perëndisë me një frymë të përlur dhe me një qëllim serioz. Ai ka premtuar të na i shndërrojë zemrat tona të ngurta në zemra mishi.

Gurishtet

Në pamje të parë, gurishtet mund të mendohen nga banorët e qytetit sikur përfaqësojnë zemrën hipokrite: ajo premtun shumë (rritje të shpejtë) por në fund jep pak. Por fjalët e Zotit tonë i referohen më shumë cektësisë

sesa hipokrizisë. Është më shumë çështje e cektësisë së marrjes [së fjalës së Perëndisë] sesa e mashtrimit me dashje. Simon Kistemeiker e përshkruan saktësisht skenën:

Në fillim duket sikur fara e mbjellë në gurishte merr një fillim të hershëm. Nxehtësia e verës, e zënë në tabanin poshtë tokës, tani çlirohet gradualisht gjatë muajve të Nëntorit dhe Dhjetorit. Reshjet janë të bollshme, kështu që ngrohtësia dhe lagështira e nevojshme bëjnë të mundur mbirjen e hershme. Këta filiza të blertë bulëzojnë shumë shpejt, dhe ndërsa pjesa tjetër e fushës është akoma pa fryt, ata bëjnë një shfaqje mjaft mbresëlënëse. Syri i stërvitur i bujkut e kupton ndryshimin. Ai e di se shfaqja e kallinjve të gjelbër të grurit në gurishte është mashtruese; kur shirat pushojnë, dhe dielli në pranverën e vitit çohet me një nxehtësi në rritje, bimët fishken. Ato nuk kanë rrënjë që të futen thellë në tokë për t'i furnizuar bimët me ujë. Bimët fishken plotësisht dhe vdesin.

(*Shëmbëlltyrat e Jezusit* fq.26)

‘Ato nuk kanë rrënjë që të futen thellë në tokë’. Vëzhguesi jo i stërvitur dhe pa përvojë mund të mos e vërë re, por syri i stërvitur i bujkut e vë. Atij nuk i bën aq lehtë përshtypje. Përvoja e gjatë e ka bërë dyshues për rezultate të tilla të habitshme!

Cili është paraleli i kësaj në përgjigjen që i kthejmë fjalës së Perëndisë? Interpretimi i Zotit tonë për shëmbëlltyrën e tij (i dhënë te Mat. 13:18-23; Lluca 3:11-15; Marku 4:13-20) shihet të nënvizojë dy karakteristika të zemrës të cilat nganjëherë prodhojnë përgjigje të habitshme ndaj fjalës së Perëndisë.

Një përgjigje e paprovuar

Ne e pranojmë fjalën *me gëzim*. Reagimi është i menjëhershëm, dhe ndjenja e lumturisë është e menjëhershme. Ku është gabimi këtu? Përgjigjja duhet të jetë, s’ka asnjë gabim! Po të mendonim ndryshe do të ishim tepër shpirtvegjël. Krishti erdhi për të sjellë dritë dhe jetë, gëzim dhe paqe në jetën tonë. Ne duhet të gëzohemi që Ungjilli i bën njerëzit të gëzuar! Për më tepër, në Dhiatën e Re ka plot fakte që tregojnë se ai bëri pikërisht këtë gjë. Jezusi u tha dishepujve se prodhimi i gëzimit të tij në

jetën e tyre ishte një nga qëllimet e mëdha të shërbimit të tij ndaj tyre (Gjoni 15:11). Gëzimi ishte një reagim karakteristik ndaj predikimit të fjalës në vitet e hershme të kishës (Vep. 8:8; 1 Thes. 1:6).

Por fjala me vend e Jezusit është se rritja e menjëhershme mund të jetë mashtruese, dhe ajo mund të dalë fare mirë si e përkohshme. Shenja treguese është kur gëzimi dhe lumturia përbëjnë gjithë reagimin ndaj fjalës së Perëndisë. Ne mund ta krahasojmë këtë me përvojën e Thesalonikasve: ***duke e pranuar fjalën në mes të një pikëllimi të madh, me gëzimin e Frymës së Shenjtë*** (1 Thes. 1:6). Kjo ishte arsyeja që Pali mund të ishte kaq i patundur në besimin e tij se Perëndia vetë i kishte zgjedhur ata (1 Thes. 1:4). Reagimi i tyre ishte provuar tashmë në zjarret e pikëllimit dhe persekutimit.

Por kjo nuk do të thotë se një reagim i menjëhershëm, apo një reagim i gëzueshëm do të dalë patjetër si i rremë. Por nëse ai s'është më shumë se kaq, atëherë bima e re është në rrezik të madh. Kjo është e vërtetë edhe në botën e natyrës: nëse fara që mbjellim lulëzon me një shpejtësi të mrekullueshme, duhet të kemi kujdes për jetëgjatësinë e saj. Bimës i duhet të përballojë shumë prova më të vështira përpara se të ketë fuqi që të qëndrojë. Shumë varet nga thellësia dhe fuqia e rrënjëve. Kështu, thotë Jezusi, kur dikush që ka reaguar në këtë mënyrë bie menjëherë në pikëllim dhe persekutim, ka për të dalë në pah mungesa e punës së thellë të hirit në të. Përvëlimi i fortë i kundërshtimit mund ta fishkë dhe vdesë atë. Provat dhe vështirësitë në jetën e të krishterit kanë përherë këtë efekt. Ato vrasin entuziazmin që s'ka rrënjë dhe si pasojë as hir; por ato forcojnë hirit e Frymës që kanë filluar të lëshojnë rrënjë të forta dhe të qëndrueshme në dashurinë e Perëndisë.

Përqëndrimi në afatin e shkurtër

Mania e sotme për rezultate të shpejta është një sëmundje prej së cilës të krishterët nuk janë të imunizuar. Sa dritë-shkurtër që jemi, dhe sa shpesh rrotullohen jetët tona rreth afatit të shkurtër në vend të afatit të gjatë! Por efekti i fjalës së Perëndisë ka për qëllim afatin e gjatë. Ne kemi një Perëndi i cili ka për qëllim të marrë kohë nga jeta jonë për të punuar thellë e me rrënjë. Në fakt, Perëndia është shumë më i interesuar për thellësimin e rrënjëve të hirit në karakterin tonë sesa për përshtypjet mahnitëse të një entuziazmi afat-shkurtër për mbretërinë e tij.

Ç'rëndësi ka kjo për mënyrën se si ne i afrohem fjalës së Perëndisë?

Kjo do të thotë se studimi ynë do të fillojë të prodhojë efektin e dëshiruar vetëm kur ne të jemi të gatshëm për të punuar me durim për ta kuptuar dhe për ta zbatuar atë praktikisht në përvojën tonë të përditshme. Është e nevojshme që ne t'i forcojmë dhe zhvillojmë hirit e krishtera për një periudhë kohore. Prandaj dhe në Dhiatën e Re theksohet kaq shumë të qenët i rrënjosur siç duhet (Kol. 2:6,7; Efes. 3:17-19; Gjoni 15:4,5,7,8).

Rrugë për t'i rënë shkurt nuk ka. Asgjë nuk e zëvendëson punën e përkushtuar për t'u bërë plotësisht i njohur me mendjen dhe vullnetin e Perëndisë siç na i shpjegon ai në Bibël. Dhiata e Re nuk shikon ndonjë zëvendësues në jetë as për ato vështirësi të cilat do ta vënë në provë zhvillimin tonë shpirtëror, duke shkatërruar atë që është e pavërtetë dhe duke forcuar të vërtetën. Ne hyjmë në mbretërinë e Perëndisë me anë të vështirësive (Vep. 14:22). Për të marrë frytë të qëndrueshme duhet një krasitje hyjnore (Gjoni 15:2).

Ky duhet të jetë një paralajmërim për disa nga ne dhe një inkurajim për të tjerët. Sepse jeta shpirtërore nuk duhet matur vetëm me anë të shkallës së zhvillimit në dukje. Shpesh, ajo duhet matur në bazë të masës së kundërshtimit që duhet të kapërcejë për të mbijetuar. Të kërkohej më shumë trysni në përballimin e një burri 130 kile sesa kur mund një djalë të peshës së lehtë! Suksemi në jetën e krishterë duhet të matet në mënyrë të ngjashme - jo me domosdo nga shkalla e gëzimit që përjeton, por nga cilësia e tij. Sepse gëzimi në shtrëngim (Rom. 5:3) është një rritje e vërtetë, dhe një reagim i drejtpeshuar ndaj hirit të Perëndisë në Ungjill. Edhe autori i Psalmit 119 e rrëfeu këtë gjë:

*Fjala jote është një llambë në këmbën time
dhe një dritë në shtegun tim.
Unë jam betuar dhe do ta mbaj betimin
që të respektoj dekretet e tua të drejta.
Unë jam shumë i pikëlluar,
gjallëromë, o Zot, sipas fjalës sate.
O Zot, prano ofertat spontane të gojës sime
dhe mësoni dekretet e tua.
Ndonëse e kam gjithnjë shpirtin në pëllëmbë të dorës,
nuk e harroj ligjin tënd.
Të pabesët më kanë ngritur kurthe,
por unë nuk jam larguar nga urdhërimet e tua.
Porositë e tua janë trashëgimia ime përjetë;*

*ato janë gëzimi i zemrës sime.
Jam zotuar me gjithë zemër për t'i zbatuar në praktikë statutet e
tua përjetë, deri në fund.*

(Psalmi 119:105-112)

Kur bindja ndaj fjalës së Zotit bëhet më e rëndësishme për ne sesa përjetimi i gëzimit, jetët tona fillojnë të lëshojnë rrënjë të forta.

Toka me ferra

Dy kategoritë e para që përshkroi Jezusi kishin të bënin me reagime afat-shkurtëra ndaj fjalës së Perëndisë. Në rastin e rrugës, refuzimi ishte faktikisht i menjëhershëm; në rastin e gurishteve, pak më i ngadaltë. Por ky lloj reagimi kërkon kalimin e kohës përpara se të shfaqet natyra e tij e vërtetë. Duket sikur ai ka një rritje të vërtetë. Madje, mund të ketë edhe një masë rezistence ndaj kundërshtimeve, tundimeve dhe persekutimeve.

Por do të kishim qenë studiues të dobët të natyrës njerëzore dhe Shkrimit nëse do të kishim pohuar se ka vetëm dy rrugë për ta shkatërruar farën e fjalës së Perëndisë kur ajo mbillet. Do të ishte një gabim i madh të mendonim se djalli zhduket nga skena pasi ka vjedhur farën nga dëgjuesi 'rrugë'! Në të kundërtën, ai ka dorë edhe në gëzimin e gënjeshtërt të gurishteve. Dhe ç'është më domethënësja, nëse ai dështon këtu, gjen mënyra të tjera për t'u afruar.

Shumë të krishterë që nuk janë tronditur fare nga ashpërsia e vështirësive janë zënë në rrjetën e shkujdesjes dhe bollëkut. Mbreti David është një shembull (2 Sam. 11:11), dhe Mbreti Uzia një tjetër (2 Kron. 26:15,16). Ne mund ta zotërojmë situatën më mirë kur jemi në nevojë sesa kur jemi në bollëk dhe nuk mësojmë kurrë sekretin e përballimit me të dyjat pa u kthyer kështu prej mëkatit me anë të fjalës së Perëndisë (Fil. 4:12,13). Kështu Jezusi na paralajmëron se është e mundur që të kemi një zemër si ferrat - një që mbytet nga kujdesjet dhe interesat e kësaj bote. Ankthet e të paturit dhe ankthet e të mos paturit mund t'i japin njësoj grushte vdekjeprurëse jetës së atij që thotë se është i krishterë.

Çfarë ka ndodhur në jetën e një personi të tillë? Ata kanë lënë pas dore punën e domosdoshme të heqjes së barërave të këqija. Kur u mboll në zemër, fara u lejua të qëndrojë atje pa bërë ndonjë përpjekje për t'u marrë me dëshirat, ambicjet dhe dështimet personale. Këto, nëse u jepet

rasti, do të zhvillohen dhe, në fund të fundit, kanë për ta mbytur atë që është arritur nga fjala. Elementi dinak në gjithë këtë është se në situata të tilla ne priremi të mendojmë se çfarë bëjnë gabim. Përgjigjja, me aq sa mund ta shohim ne, është asgjë. Dhe ky është pikërisht gabimi: ne s'bëjnë asgjë. Ne nuk i hoqëm barërat e këqija të cilat nuk i përkisnin Krishtit. Si pasojë ne paguajmë dënimin kur zemrat tona harrohen pas një llojllojshmërie gjërash dhe lëmë pas dore fjalën e Perëndisë.

Kjo ka një rëndësi të pazakontë në klimën e sotme shpirtërore tonën. Jetojmë në një kohë kur të krishterët, të ndërgjegjshëm për imazhin viktorian që ata kanë gjerësisht në shoqëri, preokupohen për të qenë më pozitivë në gjithë konsiderimin e tyre të jetës. Ne nuk duam të themi më se i krishteri është një person që 'nuk bën' këtë apo atë gjë. Ne duam ta shprehim më pozitivisht jetën e Krishtit në kishë.

Kjo gjë është shumë e natyrshme dhe e shëndetshme. Por jo kur ne zhvillojmë një theksim jobiblik dhe të padrejtpeshuar i cili lë mënjanë gjithçka për të cilën Shkrimi na flet negativisht. Nëse duam të zhvillojmë huret e mëdha pozitive të Frymës në jetën tonë, kjo do të na kushtojë largimin tonë prej të këqijave në zemrat tona. Për t'i thënë 'po' gjithë asaj që na ka dhënë Krishti, është e nevojshme që ne të bëjmë një punë të madhe për të spastruar çdo gjë që qëndron kundër fjalës dhe vullnetit të tij. Lënia pas dore këtu, do të thotë halle më të mëdha më vonë. Ajo dinakëri që duhet të kemi parasysh mirë është se e keqja nuk ka nevojë të mbillet: ajo tashmë është aty, dhe në mënyrë të pashmangshme do ta shfaqë praninë e saj. Përgjegjësia jonë është të sigurohemi që ajo të mos ketë kurrë rast për ta bërë këtë.

Tri lloje toke: lloji i rrugës, lloji i gurishteve, lloji i ferrave. Secila prej tyre ilustron se midis leximit dhe dëgjimit tonë të fjalës së Perëndisë dhe gjendjes morale dhe shpirtërore të jetës sonë ka një marrëdhënie të veçantë. Nga ky sfond, Jezusi na fton që të bëjmë dhe t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje sa herë që e hapim Biblën për ta lexuar dhe studiuar: Ç' lloj toke jam unë?

Toka e mirë

Si mund të jemi ne tokë e mirë për fjalën e Perëndisë? Si mund të dëgjojmë, të marrim dhe të japim frytë?

Pjesa tjetër e shëmbëlltyrës e bën të qartë atë që është e nevojshme. Do të ketë nevojë për *plugim*, që të krijohet një zemër e ndershme

dhe e mirë për fjalën e Perëndisë. Si dhe Jeremia, ne do të na duhet të dëgjojmë fjalën e cila na thërret për ta thyer tokën që nuk është pluguar kurrë (Jer. 4:3). Kjo do të thotë se ne kemi për t'u bërë së pari thellësisht të ndërgjegjshëm për zemrat tona skleroze, dhe kemi për t'i kërkuar Perëndisë që të na i bëjë ato të freskëta dhe të buta në duart e tij.

Do të nevojitet *rrënjësja*, me qëllim që të mund ta 'ruajmë' dhe 'mbajmë' (Lluka 8:15) fjalën. Është e nevojshme që ne ta bëjmë bindjen ndaj fjalës së Perëndisë një çështje ndërgjegjeje: që të mos e marrim atë sipas modës merre-ose-lere, por ta lexojmë fjalën e Perëndisë si në praninë e tij, duke i folur atij për nevojat dhe dështimet tona nën dritën e së vërtetës së tij, dhe me një qëllim serioz duke e parë mosbindjen ndaj urdhrave të tij si mëkat.

Do të ketë nevojë për *spastrim të barërave të këqija*. Ç'ngushëllim është fjala e Jezusit *japin fryt me qëndrueshëni* (Lluka 8:15). Këmbëngulja është në vetvete një hir i madh. Ne duhet të ngulmojmë për të vazhduar, duke besuar se Perëndia do ta mbajë premtimin për ta përdorur fjalën e tij që të na ndryshojë, gradualisht, në shëmbëllimin e Birit të tij Jezu Krisht.

Kush ka veshë për të dëgjuar, le të dëgjojë.

8 Nga Përvoja Ime

‘Por si bëhet faktikisht kjo gjë?’ Kjo është gjithmonë pyetja që bëhet. ‘Si mund ta studioj Biblën në mënyrë që të përfitoj maksimumin prej saj, dhe të kuptoj se ajo me të vërtetë më ndihmon për t’u rritur në përvojën time shpirtërore dhe në njohurinë e Perëndisë?’

Dua që në faqet e fundit të studimit tonë së bashku, të ndaj me ju disa këshilla praktike, të bazuara gjerësisht mbi përvojën dhe vëzhgimin tim personal. Personalisht, kam zbuluar gjithmonë se komentet e të krishterëve të tjerë mbi studimin e Biblës janë sa interesante aq dhe të dobishme. Nganjëherë ne stimulohemi nga aftësitë e tyre, dhe herë të tjera mësojmë prej gabimeve të tyre. Është mirë që të shkëmbesh eksperiencë në çdo fushë të jetës. Ky kapitull është thjesht një gjë e tillë. Ndoshta mund ta gjeni më të dobishme bërjen e studimit të Biblës ndryshe nga ç’sugjeroj unë. E rëndësishme është që të filloni të mendoni për një studim biblik tuajin, dhe të gjeni një mënyrë për ta bërë atë që është shpirtërisht e dobishme.

Disiplina

E vumë re tashmë kalimthi gjënë e parë të domosdoshme për studimin e vërtetë të Biblës. Pali i tha Timoteut se ai duhej të punonte fort në të (2 Tim. 2:15). Duhet disiplinë. Përndryshe studimi i fjalës së Perëndisë dot të shtyhet jashtë jetës sonë, dhe do të bëhet më shumë ‘shtesë’ sesa nevojë. Ne duhet t’i japim studimit të Biblës rëndësinë kryesore. Kjo mund të mos jetë e lehtë; në të vërtetë, shumë rrallë në jetën tonë ka për të qenë e lehtë. Nuk është më e lehtë për amvisën sesa për burrin që punon nga ora nëntë në pesë. Zakonisht, është më e lehtë kur jemi të rinj, dhe kemi më pak përgjegjësi për të harxhuar kohën. Por edhe atëherë, duhet ‘të krijojmë’ kohë. Sipas gjuhës biblike ne duhet ta ‘shfrytëzojmë’ kohën. Duhet ta blejmë atë duke sakrifikuar disa gjëra të tjera të cilave mund t’u

kishim kushtuar kohë. Ju dhe unë nuk kemi për të bërë asnjëherë progres derisa kjo gjë të bëhet një parim i vendosur në jetën tonë.

Çfarë do të thotë kjo në praktikë? Është e rëndësishme të thuhet se nuk duhet ta ngarkojmë veten me një barrë ndjenje të pashëndetshme për këtë. Gjëja më e rëndësishme është që ne njihemi me Biblën, *sido që ta bëjmë këtë*. Nuk është me domosdo më e përfutueshme ta studiosh Biblën në orën 5 të mëngjesit sesa në orën 5 të mbrëmjes! Nuk ka asgjë domosdoshmërisht shpirtërore rreth orëve të ditës, herët a vonë. Por ka shumë avantazhe të dukshme në bërjen e studimit në një orë të caktuar, atje ku është e mundur. Shumica prej nesh kanë nevojë për rutina të këtij lloji nëse duam që të zbatojmë një projekt afatgjatë. Mjafton të lexosh manualët e trajnimeve për të kuptuar se ky nuk është aspak një rregull vetëm shpirtëror. Kjo është përsëri, për shumicën prej nesh, mënyra më e mirë për të marrë maksimumin e jetës, dhe për t'i dhënë asaj maksimumin.

Robert Marri Mëkshejn (Robert Murray M'Cheyne) e kishte zakon të përpiquej që të linte për studim orët e tij më të mira të ditës. Ndoshta mund të mësojmë diçka prej kësaj. Por disa prej nesh janë kushtuar tashmë, zakonisht ndaj punës së përditshme, gjatë orëve tona më të mira të ditës. A mund ndoshta të përdorim atë kohë që priret t'i kushtohet shumë mosbërjes asgjë? A kemi ndopak kohë para pune, ose a mund të bëjmë kohë atëherë? A kemi kohë pasi kemi larë pjatat e vaktit të mbrëmjes? Po gjatë pushimit të drekës? Ata që bëjnë punë që i izolojnë prej të tjerëve, në atë kohë të ditës mund të gjejnë kënaqësi të madhe në studimin e Biblës gjatë ngrënies së sanduiçit. Po sikur të shfrytëzosh atë gjysmë orë që ti priresh ta harxhosh duke parë televizionin? Programi që doje të shihje me domosdo mbaroi, dhe programi pasardhës është vetëm i një interesi skajor. Megjithatë, natë pas nate ju shikoni programe shitesë. Pse nuk e mbyll televizorin për të nxjerrë Biblën?

Ne jemi të gjithë të ndryshëm. Familjet dhe rutinat tona janë të ndryshme. Nuk ka ligje që mund të zbatojmë në çdo situatë, vetëm një domosdoshmëri: sigurohuni që t'i jepni një kohë të caktuar studimit të fjalës së Perëndisë.

Po një metodë?

Sot ka shumë lloje metodash për studimin biblik: *Kallinji Nga Duajt e Korrur*, *Çdo Ditë Me Perëndinë*, *Bukën Tonë të Përditshme*, apo ndonjëmetodë tjetër periodike të botuar për besimtarët shqiptarë.

Çfarëdolloj metodash dhe shënimesh që të përdorësh, përpiku të konsiderosh pikat e mëposhtme.

Së pari, lexo je të gjithë Biblën. Është e mundur që pa shumë sforcim të lexohet e tërë Bibla brenda një viti.

Së dyti, lexo një libër të tërë të Biblës në një të ulur. Nuk ka asgjë si leximi i një Letre apo Ungjilli në këtë mënyrë - njësoj sikur të mos e kishe lexuar kurrë më parë. Ke për të parë se shumë gjëra do të të dalin përpara gjatë këtij leximi - zbulesa të cilat nuk të kishin shkuar në mendje më parë. Shpesh është e dobishme që të lexosh në një përkthim të ndryshëm nga ai që përdor zakonisht.

Nuk kam për ta harruar kurrë, kur isha adoleshent, që harxhova të gjitha paratë e xhepit për një botim me kapak letre të përkthimit të ri të Librit të Zbulesës prej J. B. Philips. M'u desh të shkoja në shtëpi me këmbë prej qytetit, pasi i kisha shpenzuar të gjitha paratë! Por mund ta ndiej ende gjallërinë e jashtëzakonshme që më mbërtheu ndërsa u tulata në një karrige pranë zjarrit. Atë pasdite fillova të kuptoja për herë të parë se për çfarë fliste Libri i Zbulesës. Më dukej sikur e shikoja atë të gjithin përpara syve të mendjes sime; sikur isha atje, duke vështruar kalimin e triumfit dhe fitores së Krishtit. Pata një shkëndijë, sado të vogël, të asaj se ç'kuptim ka patur ky libër për të krishterët e rrethuar përgjatë shekujve. Fillova të shikoj me sy të rinj se Zoti Perëndi i gjithëpushtetshëm mbretëron!

Përjetime të tilla kanë për të qenë ndoshta të rralla. Shpesh ato do të shoqërohen me nevoja të veçanta në jetën tonë. Por megjithatë, ne kemi për të përfituar gjithmonë nga leximi ynë në këtë mënyrë. Kjo është mënyra me të cilën u lexuan për shembull, edhe Letrat e Dhiatës së Re, dhe kjo na bën të aftë të kapim forcën e madhe të mësimi të tyre.

Së treti, vëre re se disa libra janë më domethënës se të tjerët. Ka një kuptim në të cilin disa libra të Biblës janë më të rëndësishëm se të tjerët, megjithëse janë të frymëzuar njëllë nga Perëndia. Ai i ka dhënë këta libra në një renditje shumë të caktuar. Disa prej tyre e paraqesin mesazhin e ungjillit më qartë se të tjerët. Është pra shumë e kuptueshme që të rrokim mesazhin e librave qendrorë të Shkrimit më në thellësi, që të kemi kështu një aftësi depërtuese për kuptimin e gjithë të tjerëve. Mund të dalë kështu se është një investim i mrekullueshëm kohe për të shpenzuar një vit, apo një periudhë më të gjatë kohore, për të kuptuar mesazhin e një libri në mënyrë më të qartë. Libra të tillë si Zanafilla, Psalmet, Isaia,

Ungjilli sipas Gjonit, Veprat e Apostujve, Romakët, Galatasit dhe Hebrejët ftojnë natyrshëm një studim të tillë. Nga përvoja ime, unë i jam mirënjohës Perëndisë që kjo gjë m'u qartësua në një kohë të jetës sime kur ishte e mundur që t'i kushtoja kohë një studimi serioz, që libra si këta, kur kuptohen ashtu siç duhet, të udhëheqin drejt e në zemrën dhe mendjen e Perëndisë.

Ndoshta keni për ta gjetur të dobishme mbajtjen e shënimeve. Ka për të qenë me siguri i domosdoshëm kalimi i një kohe lutjeje për atë që ke mësuar nga fjala e Perëndisë. Lutja e bën tokën e zemrës pjellore për farën e fjalës së Perëndisë. Ajo është rruga për të mposhtur ato periudha thatësire që i kalojmë herë pas here të gjithë ne që studiojmë Biblën. Vërtet jemi të krishterë, por ne kemi ende nevojë për ndihmën e palodhshme të Frymës së Shenjtë për të ndier pushtetin e fjalës së Perëndisë. Kemi nevojë të lutemi që ai të vijë gjithnjë për të na hapur sytë, që ne të gjejmë copëza minerale të vërtetash të çmuara, të një këshille, paralajmërimi dhe urtësie praktike për jetën tonë, në Shkrimet që lexojmë.

Bibla është një libër i madh. Ajo është *Libri*. Por ajo duhet trajtuar me kujdes. Nëse veprojmë kështu, atëherë kemi për të zbuluar se ç' donte të thoshte psalmisti kur tha:

Oh, sa shumë e dua ligjin tënd!

Ai është përsiatja ime gjithë ditën.

*Urdhërimet e tua më bëjnë më të urtë se armiqtë e mi,
sepse janë gjithnjë me mua.*

*Kuptoj më shumë se të gjithë mësuesit e mi,
sepse urdhërimet e tua janë përsiatja ime.*

*Kam më tepër zgjuarësi se pleqtë,
sepse respektoj urdhërimet e tua.*

*Kam përmbajtur hapat e mi nga çdo shteg i keq,
për të respektuar fjalën tënde.*

*Nuk jam larguar nga dekretet e tua,
sepse ti vetë më ke mësuar.*

Sa të ëmbla janë fjalët e tua në gojën time!

Janë më të ëmbla se mjalti në gojën time.

*Me anë të urdhërimeve të tua unë përfitoj zgjuarësinë;
prandaj urrej çdo shteg falsiteti.*

*Fjala jote është një llambë në këmbën time
dhe një dritë në shtegun tim.*

Psalmi 119:97 - 105